









**LIBRI I LIGJEVE DHE I
RREGULLOREVE TË BANKËS SË
SHQIPËRISË**

PËRMBAJTJA

| | | |
|---|--|---------------------|
|  | LIGJ NR.8269, DATË 23.12.1997, PËR BANKËN E SHQIPËRISË | FAQE 5-30 |
|  | STATUT I BANKËS SË SHQIPËRISË | FAQE 31-40 |
|  | RREGULLORE MBI RREGULLAT PROCEDURIALE TË BANKËS SË SHQIPËRISË | FAQE 41-48 |
|  | LIGJ NR.8365, DATË 2.7.1998 PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË | FAQE 49-79 |
|  | RREGULLORE PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË | FAQE 80-127 |
|  | RREGULLORE PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI FINANCIARE NGA SUBJEKTET JOBANKA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË | FAQE 128-141 |
|  | RREGULLORE PER LICENCIMIN E ZYRAVE TE KEMBIMIT VALUTOR | FAQE 142-144 |
|  | KUSHTET E PËRGJITHËSHME TË PUNËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË | FAQE 145-159 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

L I G J

PËR BANKËN E SHQIPËRISË

Nr.8269, datë 23.12.1997, ndryshuar me ligjin Nr.8384 datë 29.07.1998 dhe me ligjin nr. 8893 datë 25.07.2002 " Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr . 8269 datë 23.12.1997 " Për Bankën e Shqipërisë " .

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1, dhe 161 të Kushtetutë së Republikës së Shqipërisë, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. Banka e Shqipërisë është person juridik publik me qendër në Tiranë.
3. Banka e Shqipërisë, brenda kompetencave të përcaktuara në këtë ligj, është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj, si dhe në ushtrimin e detyrave të ngarkuara. Çdo subjekt është i detyruar të respektojë pavarësinë e Bankës së Shqipërisë, të mos kërkojë të influencojë te ndonjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për të cënuar detyrimet e tij ndaj Bankës së Shqipërisë, si dhe të mos ndërhyjë në veprimtaritë e Bankës së Shqipërisë.
4. Banka e Shqipërisë gëzon të drejtën:
 - a) të lidhë kontrata;
 - b) të nxjerrë akte normative;
 - c) të posedojë, të gëzojë, të disponojë, si dhe të blejë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që i shërbejnë veprimtarisë së saj;
 - ç) të tregtojë letra me vlerë, të shpërndajë letra me vlerë për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe të emetojë letra me vlerë për llogari të vet.
5. Sa herë që përdoren në këtë ligj, termat e mëposhtëme nënkuptojnë:
 - a) "Bankë" nënkupton personin juridik që kryen veprimtari bankare sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë.
 - b) "Veprimtari bankare" nënkupton veprimtarinë tregtare, në Republikën e Shqipërisë, të grumbullimit të depozitave nga publiku dhe të përdorimit të të gjitha ose të një pjese të këtyre fondeve për kredi ose hua apo investim për llogari dhe në ngarkim të subjektit që kryen këtë veprimtari, si dhe veprimtari të tjera tregtare të përcaktuara me rregullore nga Banka e Shqipërisë.
 - c) "Poseduesi i llogarisë bankare" nënkupton çdo bankë që posedon një llogari në librat e Bankës së Shqipërisë.

- ç) “Letra me vlerë të detyrimeve” nënkupton instrumentet e negociueshme të detyrimeve dhe çdo instrument tjetër të barasvlefshëm me këto instrumente të detyrimeve, pavarësisht nëse janë të formës fizike (me certifikatë) ose të formës së regjistruar (*book-entry*).
- d) “Shteti” nënkupton Republikën e Shqipërisë.

ENI 2

1. Banka e Shqipërisë përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
2. Jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe në intervale gjashtëmujore pas kësaj, Banka e Shqipërisë i dorëzon Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë një deklaratë, e cila përmban:
 - a) vlerësimin mbi arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve për periudhën e mëparshme gjashtëmujore, si dhe parashikimin për gjashtë muajt e ardhshëm;
 - b) vlerësimin e politikës monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore të zbatuar nga Banka e Shqipërisë për periudhën e mëparshme gjashtëmujore;
 - c) përshkrimin dhe vlerësimin e politikave monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore që do të ndiqen nga Banka e Shqipërisë gjatë gjashtë muajve të ardhshëm;
 - ç) përshkrimin e parimeve që do të ndiqen nga Banka e Shqipërisë për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore gjatë dy viteve të ardhshëm ose për një periudhë kohe që e cakton Banka e Shqipërisë.

ENI 3

1. Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve.
2. Banka e Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe mbi bazën e tregut të brendshëm bankar, nxit dhe mbështet zhvillimin e regjimit dhe të sistemit të këmbimeve valutore, tregun e brendshëm financiar, sistemin e pagesave, si dhe ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit.
3. Objektivat e tjerë të Bankës së Shqipërisë, të kushtëzuar nga objektivi kryesor i saj, duhet të nxisin ruajtjen e likuiditetit, aftësinë paguese dhe funksionimin normal të sistemit bankar të bazuar në parimet e tregut.
4. Detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë janë si më poshtë:
 - a) të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë në mënyrë të pavarur politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor;
 - b) të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë regjimin e këmbimit valutor, si dhe politikën e kursit të këmbimit të valutave në Republikën e Shqipërisë;
 - c) të licencojë ose të revokojë këtë licencë bankave dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre bankare, me qëllim që të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar;
 - ç) të disponojë dhe të administrojë rezervat e saj valutore;
 - d) të veprojë me cilësinë e bankierit, këshilltarit dhe të agjentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
 - dh) të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave.
 - e) Të përdorë, në mënyrë të pavarur, instrumentet e politikës monetare për realizimin e objektivit kryesor dhe të objektivave të politikës monetare.
5. Çdo objektiv dhe detyrë tjetër që i caktohet Bankës së Shqipërisë kushtëzohet me arritjen e objektivit të saj kryesor.

ENI 4

1. Përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj, Banka e Shqipërisë:
 - a) nuk jep ndihmë financiare në formë kredie, huaje të drejtpërdrejtë ose donacioni; nuk jep kredi ose hua të kushtëzuar, nuk blen kredi ose hua, nuk merr pjesë si kreditore solidare ose në instrumentet e tjera të detyrimeve, si dhe nuk subvencionon borxhet ose detyrimet e kushtëzuara të çfarëdolloj forme që të jenë;

- b) nuk merret me veprimtari tregtare, nuk blen aksione të shoqërive tregtare ose të subjekteve të ndryshme, duke përfshirë edhe aksionet e institucioneve financiare, si dhe nuk mund të jetë bashkëpronare në veprimtari financiare, tregtare, bujqësore, industriale ose veprimtari tjetër;
 - c) nuk fiton nëpërmjet blerjes ose me ndonjë formë tjetër të drejta reale, për pasuri të paluajtshme, me përjashtim të rasteve kur ajo e gjykon të nevojshme ose të përshtatshme për sigurimin e administrimit dhe të aspektit operacional, si dhe për banesa të punonjësve të saj ose për kërkesa të tjera të ngjashme, në zbatim të funksioneve që i njeh ky ligj.
- 2.** Pavarësisht nga dispozitat e pikës 1 të këtij neni, Bankës së Shqipërisë i lejohet:
- a) të krijojë fondet e pensionit për personelin, të bëjë marrëveshje të ngjashme në përfitim ose në mbrojtje të punonjësve të saj, si dhe të kontribuojë në koston e barazvlefshme të këtyre marrëveshjeve;
 - b) t'i japë kredi çdo punonjësi të saj për përmirësimin e kushteve të jetesës në shumat dhe kriteret e përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

ENI 5

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të marrë pjesë, të bashkëpunojë dhe të nënshkruajë marrëveshje bankare me institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe me institucionet financiare dhe bankare, publike dhe private në vendet e tjera.

KREU II

FONDI THEMELOR DHE PËRDORIMI I FITIMIT

ENI 6

1. Fondi i themelimit të Bankës së Shqipërisë është 750 milionë lekë.
2. Fondi i themelimit mund të rritet me propozimin e Bankës së Shqipërisë dhe me miratimin e Ministrisë së Financave.
3. I tërë fondi i themelimit akordohet dhe është në pronësi ekskluzive të Shtetit Shqiptar. Ky fond nuk mund të transferohet ose të hipotekohet.

ENI 7

Kur në bilancin e Bankës së Shqipërisë vlera e mjeteve të saj bie nën shumën e detyrimeve dhe atë të fondit të themelimit, Ministri i Financave, për të mbuluar mungesën e mjeteve, transferon në Bankën e Shqipërisë letra me vlerë shtetërore të tregtueshme, duke zbatuar përqindjet e interesit të tregut.

ENI 8

Për çdo vit financiar, fitimi neto i Bankës së Shqipërisë llogaritet pasi të zbriten nga të ardhurat shpenzimet e bëra për vitin financiar në fjalë dhe pas veçimeve për :

- a) borxhe të dyshimta e pa shpresë arkëtimi, masën e zhvlerësimit të mjeteve në bilancin e Bankës së Shqipërisë, si dhe kontributin për fondet e pensionit të personelit;
- b) shpenzimet e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës për qëllime të tjera që konsiderohen si të nevojshme për Bankën e Shqipërisë.

ENI 9

Banka e Shqipërisë krijon një fond të rezervës së përgjithshme. Në fund të çdo viti financiar ky fond shtohet me një shumë prej 25 për qind të fitimit neto të Bankës së Shqipërisë, derisa fondi i rezervës së përgjithshme të arrijë në 500 për qind të fondit të themelimit të Bankës së Shqipërisë.

ENI 10

1. Pas kalimit të shumës prej 25 për qind të fitimit neto në fondin e rezervës së përgjithshme sipas nenit 9, mbetja nga fitimi neto për vitin financiar do të përdoret për të kompensuar letrat me vlerë që i janë dhënë Bankës së Shqipërisë në përputhje me nenin 7 të këtij ligji.
2. Fitimi neto për vitin financiar, që mbetet pasi bëhen zbritje sipas neneve 8, 9 dhe paragrafit të parë të nenit 10 të këtij ligji, kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda katër muajsh pas mbylljes së vitit financiar.

ENI 11

Kur mjetet e Bankës së Shqipërisë do të jenë më pak se shumta e detyrimeve të saj dhe e fondit të themelimit, nuk do të bëhet asnjë transferim, shlyerje ose pagesë sipas neneve 8, 9 e 10 të këtij ligji.

KREU III

MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKAVE TË TJERA NË SHQIPËRI

ENI 12

Banka e Shqipërisë është ekskluzivisht përgjegjëse për dhënien e licencave dhe për mbikëqyrjen e të gjitha bankave në Republikën e Shqipërisë. Për këtë, Banka e Shqipërisë:

- a) nxjerr akte normative dhe jonormative për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit bankar bazuar në ligj dhe për zbatim të tij;
- b) kontrollon çdo zyre bankare dhe këmbimi valutor, llogari bankare dhe dokumente të bankave, si dhe të subjekteve të tjera që kryejnë veprimtari bankare me licencë. Ajo merr informacionet e nevojshme në formën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

ENI 13

Banka e Shqipërisë mbikëqyr pagesat ndërkombëtare që rrjedhin nga veprimet tregtare dhe jotregtare me jashtë, si dhe angazhimet e bankave të licencuara në Shqipëri, që kanë lidhur kontrata me shtete, banka apo shoqëri të huaja.

ENI 14

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të hapë në regjistrat e saj llogari nga bankat që kanë licencë dhe të pranojë prej tyre depozita, me afate dhe me kushte që përcaktohen prej saj.

ENI 15

1. Veprimet e skontimit dhe të riskontimit nga Banka e Shqipërisë janë të vlefshme vetëm për bankat që mbajnë llogari në regjistrat e Bankës së Shqipërisë, si dhe për letrat me vlerë të mëposhtme:
 - a) kambiale dhe tituj pagese të emetuara për qëllime tregtare, industriale apo bujqësore, që mbajnë dy ose më shumë nënshkrime të rregullta, nga të cilat, së paku njëri prej tyre, duhet të jetë i një banke me licencë të depozituar. Kambialet bëhen të vlefshme brenda 182 ditësh nga data e blerjes së tyre në Bankën e Shqipërisë;
 - b) letrat me vlerë të emetuara nga organe shtetërore të caktuara dhe letrat e tjera me vlerë të nxjerra publikisht ose të garantuara nga shteti, që formojnë pjesë të një emetimi publik dhe që maturohen brenda një viti nga data e paraqitjes së tyre pranë Bankës së Shqipërisë;
 - c) letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.
2. Veprimet e skontimit e të riskontimit të Bankës së Shqipërisë i nënshtrohen afateve dhe kushteve të tjera që përcaktohen në rregullore të Bankës së Shqipërisë.

ENI 16

1. Banka e Shqipërisë u jep bankave që kanë llogari në regjistrat e saj, kredi me afate dhe kushte që përcaktohen prej saj, por me afat kohor jo më të gjatë se 92 ditë si vijon: Kredi që janë të garantuara nga:
 - i) instrumentet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 15 të këtij ligji;
 - ii) depozitat në Bankën e Shqipërisë ose një depozitë e pranueshme nga Banka e Shqipërisë për çdo pasuri që ajo lejohet të blejë, të shesë a të trajtojë sipas këtij ligji.Dhënia e kredisë së parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni mund të trajtohet si kredi me afate fikse dhe si marrëveshje riblerjeje. Llogaritë e zbuluara nuk do të lejohen.

2. Për bankat nën kujdestari, mbështetur në ligjin "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë mund të japë kredi që janë të pagarantuara ose që mund të garantohen me mjete të tjera, me kushte dhe afate të paracaktuara nga Banka e Shqipërisë, por vetëm kur, sipas gjykimit të kësaj të fundit, dhënia e kredisë është e nevojshme për rastet e veçanta, me qëllim që të ruajë integritetin e sistemit bankar.

NENI 17

Kredia nga Banka e Shqipërisë për bankat e tjera u jepet vetëm drejtorive të përgjithshme në Shqipëri të këtyre bankave.

NENI 18

Afatet dhe përqindjet që zbatohen nga Banka e Shqipërisë për skontime, riskontime, kredi ose hua, si dhe përqindjet e diferencuara dhe nivelet maksimale për kategori të ndryshme veprimesh bankare caktohen nga Banka e Shqipërisë dhe shpallen në njoftimin e saj zyrtar.

NENI 19

1. Banka e Shqipërisë kërkon nga këto banka të mbajnë depozitat pranë saj në nivele minimale të përcaktuara (rezerva të detyrueshme) që lidhen me madhësinë e fondeve ose me kategoritë specifike të pasivit.
2. Rezervat e detyrueshme të çdo banke mbahen si depozitë monetare në Bankën e Shqipërisë në raporte të tilla që përcaktohen nga Banka e Shqipërisë, me kusht që bankat të mos mbajnë rezerva të detyrueshme në Bankën e Shqipërisë më shumë se 20 për qind të shumës së përgjithshme të depozitave monetare të çdo banke ose të pasivit të secilës prej këtyre bankave.
3. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të vendosë për të paguar interes për rezervat e detyrueshme të bankave.

NENI 20

1. Kur bankat nuk mbajnë rezervat e detyrueshme të përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë vendos një gjobë deri në plotësimin e rezervës së detyruar. Masa e gjobës nuk duhet të jetë më e lartë se dyfishi i përqindjes aktuale të skontos së Bankës të Shqipërisë.
2. Rregullat për rritjen e niveleve të rezervave të detyrueshme përcaktojnë edhe datën kur bankat duhet të arrijnë nivelet e reja të rezervës.

NENI 21

1. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me bankat e tjera, ka të drejtë të caktojë rregulla dhe procedura për kryerjen e pagesave me instrumente që përdoren si mjete pagese, si dhe për shërbimet mbi transfertat elektronike dhe telegrafike.
2. Banka e Shqipërisë organizon dhe kryen shlyerjen e pagesave me instrumente që përdoren si mjete pagese.
3. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të organizojë shërbimin e kleringut të pagesave dhe të letrave me vlerë.
4. Banka e Shqipërisë mbikëqyr sistemin e pagesave në Republikën e Shqipërisë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet subjekteve apo njësive ndërbankare të krijuara nga ajo për këtë qëllim. Banka e Shqipërisë lehtëson kryerjen e pagesave dhe të likuidimeve efektive ndërmjet bankave dhe shërbimet në pagesa.

NENI 22

Banka e Shqipërisë krijon dhe mban rrjet informacioni për sistemin bankar.

ENI 23

1. Mbi bazën e reciprocitetit, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritetet respektive të huaja të mbikëqyrjes bankare, për të mbikëqyrur dhe për të inspektuar bankat që veprojnë drejtpërsëdrejti në juridiksionet e tyre përkatëse.
2. Banka e Shqipërisë shkëmben me autoritetet mbikëqyrëse bankare të huaja informacione për çdo bankë që vepron në juridiksionin e tyre përkatës, me kusht që autoritetet të marrin përsipër besueshmërinë e informacionit të marrë.

KREU IV

MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKES SË SHQIPËRISË DHE SHTETIT SHQIPTAR

NENI 24

1. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me organet legjislativë dhe ekzekutive të Republikës së Shqipërisë për të përmbushur objektivat e saj dhe, në bazë të ligjit, kur e konsideron të nevojshme, ndërmer veprime për të nxitur këtë bashkëpunim në kryerjen e funksioneve të saj.
2. Bankës së Shqipërisë i jepet për mendim çdo akt normativ që i dërgohet për miratim Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave, me karakter ekonomik dhe me pasoja në fushën e politikës financiare, monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore.
3. Banka e Shqipërisë përgatit analiza periodike ekonomike e monetare, publikon rezultatet dhe i paraqet propozime dhe masa Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.
4. Banka e Shqipërisë jep informacionin e kërkuar nga ministratë dhe organet e tjera qendrore të Qeverisë në lidhje me çështjet monetare e financiare dhe, anasjelltas, këto organe japin informacionin e kërkuar nga Banka e Shqipërisë në lidhje me çështjet makroekonomike, monetare dhe financiare.
5. Banka e Shqipërisë përcakton llojin, mënyrën e dhënies, personat e ngarkuar për dhënien e informacionit të kërkuar, si dhe sekretin zyrtar që zbatohet për dhënien e këtij informacioni.

NENI 25

1. Banka e Shqipërisë përfaqëson Shtetin Shqiptar në të gjitha marrëdhëniet dhe veprimtaritë bankare me shtetet, me bankat dhe me institucionet e huaja.
2. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të veprojë si agjente fiskale për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, sipas kushteve dhe mënyrave të parashikuara në marrëveshje me Ministrin e Financave.
3. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet sistemit bankar, kryen funksionet e arkës së buxhetit të shtetit.

NENI 26

Banka e Shqipërisë, në marrëveshje me Ministrinë e Financave, regjistron dhe evidenton borxhin e jashtëm publik dhe privat të Republikës së Shqipërisë, nëse e sheh të nevojshme ose të mundshme.

NENI 27

Banka e Shqipërisë harton bilancin e pagesave të Shtetit Shqiptar, si dhe organizon dhe drejton sistemin e statistikave të këtij bilanci pagesash.

Bankat, institucionet dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë detyrohen të dërgojnë të dhënat statistikore të kërkuara në përputhje me sistemin raportues të miratuar nga Banka e Shqipërisë dhe të përdorin kriteret e vlerësimit, të evidencimit dhe emërtimet e klasifikimit e paraqitura në të.

NENI 28

Banka e Shqipërisë mund të pranojë depozita nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe kryen veprime pagesash deri në kufijtë e këtyre depozitave. Banka e Shqipërisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshje, mund të autorizojë një bankë sipas gjykimit të saj ku të kalojnë këto depozita.

NENI 29

Banka e Shqipërisë në marrëveshje me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministri i Financave, mund të veprojë si agjente për këto veprime:

- a) tregtimin e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria;
- b) pagesën e vlerës, të interesit dhe të shpenzimeve të tjera për letrat me vlerë të parashikuara në pikën "a";
- c) kryerjen e veprimeve me para lidhur me llogaritë e Shtetit në Bankën e Shqipërisë.

NENI 30

1. Banka e Shqipërisë nuk i jep kredi ose hua apo ndonjë kontribut financiar tjetër Qeverisë së Republikës të Shqipërisë ose ndonjë prej subjekteve të saj shtetërore, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, përveç kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë ligj.
2. Banka e Shqipërisë, brenda kufijve të parashikuar në këtë nen, mund t'i japë kredi ose hua Qeverisë së Republikës të Shqipërisë me maturime, të cilat nuk kalojnë gjashtë muaj.
3. Kreditë ose huatë e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë disbursohen, përcaktohen dhe janë të pagueshme vetëm në lekë. Të gjitha kreditë ose huatë e tilla do të sigurohen (kolateralizohen) me letra me vlerë të borxhit tek prurësi me norma interesi sipas përqindjeve të tregut, me maturitete korresponduese me kreditë ose huatë, që ato sigurojnë dhe që janë emtuar e livruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë për Bankën e Shqipërisë. Për çdo kredi ose hua duhet të përfundohet marrëveshja me shkrim e kredisë ose e huasë midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Bankës së Shqipërisë. Marrëveshja duhet të përcaktojë qartë shumën kryesore të kredisë ose të huasë, maturimin e saj, normat e aplikuara të interesit dhe kushte e shpenzime të tjera të mundshme.
4. Në asnjë rast shuma kryesore e kredisë ose huasë së disbursuar dhe pjesa e padisbursuar e kredisë ose e huasë së Bankës të Shqipërisë dhënë Qeverisë të Republikës së Shqipërisë nuk duhet të kalojë vlerën pesë për qind të mesatares vjetore të të ardhurave të buxhetit të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për tre vitet e fundit financiare paraardhës; me kusht që, në kuptim të këtij neni, "të ardhurat" nuk do të përfshijnë kreditë ose huatë, donacionet dhe forma të tjera të kontributeve financiare.
5. Pavarësisht nga sa më sipër, Banka e Shqipërisë mundet që në rrethana të jashtëzakonshme, me akt të veçantë të tejkalojë përkohësisht kufijtë e parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni, por vetëm nëse ky tejkalim nuk bie ndesh me objektivin kryesor të politikës monetare për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si dhe vetëm nëse ky tejkalim nuk sjell si pasojë që shuma kryesore e kredisë ose huasë së disbursuar dhe pjesa e padisbursuar e kredisë ose e huasë së Bankës të Shqipërisë dhënë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të kalojë vlerën prej tetë për qind të mesatares vjetore të të ardhurave të buxhetit të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për tre vitet e fundit financiare paraardhës.
6. Nëse, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, kufijtë e parashikuar në paragrafin 4 ose 7, sipas rastit, rrezikohen të tejkalohen, Banka e Shqipërisë duhet të paraqesë në Kuvendin Popullor një raport mbi disbursimet e Bankës së Shqipërisë dhe mbi pjesët e padisbursuara të kredisë ose huasë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, si dhe shkaqet që çojnë në një tejkalim të tillë, së bashku me rekomandimet që ajo i quan të përshtatshme për të parandaluar ose në të kundërt për të rregulluar situatën. Nëse kufiri i dhënë në paragrafin 4 ose 7, sipas rastit mund të jetë tejkaluar në përputhje me paragrafin 5 ose me nenin 32 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë duhet të përgatisë raporte dhe rekomandime të tjera që i gjykon të përshtatshme, me qëllim që të rregullohet situata dhe të evitohet përsëritja e tyre në vitin e ardhshëm financiar.
7. Kufijtë e financimit për vitin 1998 do të jenë si më poshtë: sipas paragrafit 4 do të jetë 30 për qind; sipas paragrafit 5 do të jetë 40 për qind.
Kufijtë e financimit për vitin 1999 do të jenë në të njëjtat nivele me kufijtë e financimit të vitit 1998, duke marrë në konsideratë mundësinë e rritjes në ligjin për buxhetin e shtetit të vitit përkatës dhe pas konsultimeve të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë me Bankën e Shqipërisë. Në të tilla kushte, Banka e Shqipërisë duhet të raportojë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë,

duke parashtruar qëndrimin e saj mbi rritjen e kufijve të financimit, si dhe të pasojave të pritshme mbi objektivat e Bankës së Shqipërisë.

Kuvendi Popullor merr vendimet përkatëse. Në vazhdim, do të aplikohen kufijtë sipas paragrafëve 4 dhe 5.

8. Banka e Shqipërisë mund të ristrukturojë letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në marrëveshje me Ministrinë e Financave, por me periudhë maturimi të njëjtë ose më të vogël se sa detyrimi origjinal.

NENI 31

Pavarësisht nga dispozitat e nenit 30 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë mund t'i japë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë kredi ose hua, me afate dhe kushte sipas marrëveshjes ndërmjet palëve, mbi kufirin e caktuar për pagesat që rrjedhin nga anëtarësia e Shtetit në një organizatë ndërkombëtare. Çdo dhënie kredie ose huaje sipas këtij neni, do të kushtëzohet nga emetimi i letrave me vlerë të Qeverisë për Bankën e Shqipërisë, sipas kushteve dhe mënyrave të parashikuara me marrëveshje të përbashkët.

NENI 32

Banka e Shqipërisë mund të blejë dhe të shesë letra me vlerë të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë. Megjithatë, blerja nga ana e Bankës së Shqipërisë për llogari të saj të letrave me vlerë të borxhit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në treg të hapur ose në tregun sekondar, duhet të trajtohet si kredi ose hua e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe në këtë mënyrë do të jetë subjekt i kufijve të parashikuar në nenin 30, përveç kur dhe deri në atë masë që blerje të tilla të përputhen me objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë, parashikuar në nenin 3(1) ose të jenë kërkuar për investimin e mjeteve të fondit të pensionit të personelit të Bankës së Shqipërisë dhe vetëm nëse blerje të tilla të jenë kryer në tregun sekondar.

KREU V

EMETIMI I MONEDHËS

NENI 33

- 1.** Njësia monetare në Republikën e Shqipërisë është "Lek-u".
- 2.** Banka e Shqipërisë ka të drejtë ekskluzive dhe është emetuesja e vetme e kartëmonedhës dhe monedhës kombëtare që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 3.** Banka e Shqipërisë përcakton format, masat, peshat, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare, të cilat kanë kurs ligjor, si dhe të monedhave e kartëmonedhave që do të shtypen për qëllime numizmatike.

NENI 34

Sasia dhe procedurat për eksport-importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.

NENI 35

Kartëmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara nga Banka e Shqipërisë dhe që nuk janë tërhequr nga qarkullimi, do të kenë kurs ligjor dhe do të pranohen për të gjitha pagesat e detyrimeve publike e private pa kufizim, me vlerën e tyre nominale.

NENI 36

Banka e Shqipërisë harton planet e emetimit dhe siguron furnizimin e rregullt me kartëmonedha dhe monedha metalike, për të plotësuar kërkesat e ekonomisë për para.

NENI 37

Vlera e kartëmonedhave dhe monedhave metalike në qarkullim futet në llogarinë e Bankës së Shqipërisë në formën e detyrimeve. Kartëmonedhat dhe monedhat metalike të rezervës monetare nuk përfshihen në këto detyrime.

NENI 38

Të gjitha kontratat e përfunduara dhe të pagueshme në valutë do të jenë të vlefshme në Republikën e Shqipërisë. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe me shkrim, debitorët duhet të vendosin nëse detyrimet e tyre mund të paguhet në lekë sipas kursit të këmbimit të valutave në treg në ditën e maturimit. Në rast se debitori është në pamundësi të shlyerjes së detyrimit, kreditori me kërkesën e tij mund të vendosë që detyrimi të paguhet në lekë sipas kursit të këmbimit të valutave në treg në ditën e maturimit ose në ditën e pagesës.

NENI 39

- 1.** Banka e Shqipërisë siguron dhe mban në vende të sigurta kartëmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara dhe ruan ose asgjëson, kur është e nevojshme, pllakat dhe stampat e monedhave metalike dhe të kartëmonedhave që hiqen nga qarkullimi.
- 2.** Banka e Shqipërisë, në përputhje me politikën monetare të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, përcakton sasinë dhe vendos për procedurat e shtypjes së kartëmonedhës dhe monedhës kombëtare që ka kurs ligjor, si dhe të monedhave e kartëmonedhave që do të shtypen për qëllime numizmatike.

3. Banka e Shqipërisë shkëmben pa shpenzime e komisione kartëmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara prej saj me kartëmonedha dhe monedha metalike që kanë kurs ligjor në Republikën e Shqipërisë.

NENI 40

1. Banka e Shqipërisë sekuestron dhe konfiskon kartëmonedhat dhe monedhat metalike false.
2. Kartëmonedhat dhe monedhat e pavlefshme tërhiqen, asgjësohen dhe zëvendësohen me kartëmonedha dhe monedha metalike nga Banka e Shqipërisë.
3. Banka e Shqipërisë mund të refuzojë të shkëmbejë kartëmonedha ose monedha metalike, po qe se pamjet e tyre janë të palejueshme, jo në formë të mirë, të shpuara ose nëse më shumë se 40 për qind e sipërfaqes së tyre ka humbur. Monedha të tilla tërhiqen dhe asgjësohen pa kompensuar poseduesin, me përjashtim të rasteve të veçanta, ku Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë një kompensim të plotë a të pjesshëm.
4. Banka e Shqipërisë nuk jep kompensim për kartëmonedhat dhe monedhat metalike që kanë humbur apo janë dëmtuar. Ajo mund të konfiskojë pa kompensim çdo kartëmonedhë që mund të jetë ndryshuar në pamjen e jashtme, sidomos kartëmonedhat, mbi të cilat është shkruar, vizatuar, shtypur, stampuar apo janë bërë vrima, ose mbi të cilat është vënë material ngjites.
5. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të vendosë të mbledhë dhe të tërheqë nga qarkullimi çdo kartëmonedhë a monedhë metalike që ka emetuar, kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit, duke emetuar në shkëmbim të tyre kartëmonedha dhe monedha metalike të tjera. Në vendim përcaktohet periudha gjatë së cilës kartëmonedhat dhe monedhat metalike duhet të paraqiten. Një periudhë e tillë për ndërrime nuk duhet të jetë më pak se një vit nga shpallja e njoftimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në Fletoren Zyrtare. Në fund të kësaj periudhe:
 - a) kartëmonedhat dhe monedhat metalike të mbledhura për t'u ndërruar nuk do të jenë më para në qarkullim, pavarësisht nga neni 37;
 - b) kartëmonedhat ose monedhat metalike që janë mbledhur, përveç atyre që janë paraqitur për t'u këmbyer, do të zbriten nga sasia e monedhës në qarkullim në regjistrat e Bankës së Shqipërisë.

KREU VI

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË

ENI 41

Banka e Shqipërisë organizohet, drejtohet dhe kryen veprimtarinë e saj nëpërmjet Këshillit Mbikëqyrës, administratorëve, që janë Guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorët, si dhe personelit, siç përcaktohet në këtë ligj.

ENI 42

1. Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i politikave, i administrimit dhe i operacioneve të Bankës së Shqipërisë.
2. Këshilli Mbikëqyrës, për realizimin e detyrave të ngarkuara, duhet të vlerësojë periodikisht situatën ekonomike, duke përfshirë politikën monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore. Për këtë qëllim, Guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë duhet të informojnë, jo më pak se një herë në muaj, Këshillin Mbikëqyrës për çështjet kryesore që i idhen me:
 - a) administrimin dhe veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë;
 - b) zbatimin e politikës monetare dhe rregullatore;
 - c) mbarëvajtjen e sistemit bankar shqiptar në veçanti dhe të sistemit financiar në përgjithësi;
 - ç) gjendjen e tregjeve të parasë, të kapitalit dhe të këmbimeve valutore;
 - d) rrethanat dhe kushtet që mund të pengojnë arritjen ose ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe që kanë ose pritet të kenë efekt në administrimin dhe në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, si dhe të influencojnë në arritjen e politikave mbi sistemin financiar ose mbi tregjet e parasë, të kapitalit dhe të këmbimeve valutore.

ENI 43

Këshilli Mbikëqyrës ka këto kompetenca:

- a) të miratojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar kufijtë e operacioneve të Bankës së Shqipërisë në treg të hapur, përqindjen e interesave për depozitat në Bankën e Shqipërisë dhe për skontimet dhe huatë ose kreditë e Bankës së Shqipërisë, si dhe të rezervave dhe nivelit të rezervave të detyrueshme që bankat e nivelit të dytë duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë;
- b) të vendosë mbi regjimin dhe politikën e këmbimeve valutore të Republikës së Shqipërisë, si dhe të miratojë procedurat që përdoren për përcaktimin e vlerës së l ekut në raport me valutat e huaja;
- c) të miratojë të gjitha vendimet, rregulloret dhe udhëzimet me zbatim të përgjithshëm, që nxirren nga Banka e Shqipërisë;
- ç) të miratojë të gjitha raportet dhe rekomandimet që Banka e Shqipërisë i paraqet Kuvendit Popullor ose Këshillit të Ministrave;
- d) të përcaktojë vlerën nominale, prerjet dhe konfigurimin e kartëmonedhave dhe të monedhave, si dhe kushtet e tërheqjes nga qarkullimi;
- dh) të miratojë kreditë ose huatë e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
- e) të miratojë dhe të revokojë dhënien e miratimeve paraprake dhe të licencave për ushtrimin e veprimtarisë bankare.
- ë) të miratojë skontimin e instrumenteve me maturitet mbi tre muaj nga data e blerjes nga Banka e Shqipërisë, në zbatim të nenit 32; me pëlqimin e të paktën tre të

- pestave të anëtarëve të pranishëm të miratojë çdo kredi, hua apo detyrim tjetër të kushtëzuar të Bankës së Shqipërisë për një bankë në zbatim të nenit 16;
- f) të miratojë statutin dhe rregulloret e brendshme të Bankës së Shqipërisë;
- g) të vendosë mbi politikat e administrimit në përgjithësi, si dhe të përcaktojë mënyrat ose procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të Bankës së Shqipërisë;
- gj) të përcaktojë strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë;
- h) të miratojë emërimet e drejtuesve të departamenteve në Bankën e Shqipërisë, të përcaktojë në përgjithësi kushtet e marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë të agjentëve dhe të korrespondentëve të Bankës së Shqipërisë;
- i) të vendosë për hapjen dhe mbylljen e filialeve, të degëve ose të agjencive të Bankës së Shqipërisë;
- j) të vendosë mbi buxhetin e Bankës së Shqipërisë;
- k) të propozojë rritje të kapitalit të Bankës së Shqipërisë dhe të vendosë mbi fondin e veçantë rezervë të Bankës së Shqipërisë, të vendosë mbi të ardhurat neto të Bankës së Shqipërisë, si dhe mbi masën e të ardhurave neto që do të transferohet në rezervë;
- l) të miratojë raportet vjetore dhe raportet financiare të Bankës së Shqipërisë;
- ll) të përcaktojë letrat me vlerë të borxhit që do të trajtohen si instrumente të përshtatshme për investime nga Banka e Shqipërisë;
- m) të vendosë mbi politikat dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore.

NENI 44

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga nëntë anëtarë, si më poshtë:
 - Guvernatori i Bankës së Shqipërisë - kryetar i Këshillit Mbikëqyrës;
 - Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë - zëvendëskryetar i Këshillit Mbikëqyrës;
 - Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë;
 - gjashtë anëtarë.
2. Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen dhe emërohen nga kuvendi i Republikës së Shqipërisë, mbështetur në propozimet e bëra si më poshtë:
 - a) pesë anëtarë propozohen nga Kuvendi;
 - b) tre anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave;
 - c) një anëtar propozohet nga Këshilli Mbikëqyrës.
 Guvernatori zgjidhet nga Kuvendi, me propozimin e Presidentit të Republikës .

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë zgjedh dhe emëron zëvendësguvernatorët, mbështetur në propozimin e bërë nga guvernatori.

3. Kandidatët për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës duhet të jenë shtetas të Republikës së Shqipërisë, persona që gëzojnë ndershmërinë dhe pastërtinë morale, si dhe kanë :
 - a) arsimin e lartë ekonomik ose juridik;
 - b) përvojë profesionale në çështje financiare dhe bankare;
 - c) kualifikime profesionale të profilit;
 - ç) përvojë pune mbi pesë vjet në administratën publike ose në institucionet financiare dhe bankare;
 - d) të mos kenë pengesa të parashikuara në nenin 47.
4. Afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, për Guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët është shtatë vjet, duke synuar që datat e mbarimit të këtij afati për çdo anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, të jenë të shpërndara gjatë periudhës shtatëvjeçare. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët mund të rizgjidhen, përveçse kur shkarkohen sipas rasteve të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji.

NENI 45

1. Këshilli Mbikëqyrës vendos për shpërblimin e anëtarëve të këtij Këshilli.
2. Këshilli Mbikëqyrës përcakton shpërblimin e Guvernatorit, të zëvendësguvernatorëve si dhe të personelit të Bankës së Shqipërisë. Shuma totale e shpërblimit përcaktohet duke përfshirë shpërblimin e punës (pagën), shpërblimet suplementare, si dhe kompensimet monetare ose jomonetare, përfshirë shëndetin, studimet pasuniversitare, kalimin e kohës së lirë ose përfitime për banesë.

NENI 46

Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, të deputetit në Kuvendin Popullor apo të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të punonjësit, administratorit dhe aksionerit, me pjesëmarrje ndikuese në bankën e nivelit të dytë ose në subjekte që licencohen nga Banka e Shqipërisë.

NENI 47

1. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë Guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët pezullohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave dhe shkarkohet nga KUVENDI, në qoftë se ai ose ajo:
 - a) është në pamundësi për të shërbyer në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, sipas nenit 46;
 - b) është dënuar nga gjykata për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënimin me burgim;
 - c) është në pamundësi për të paguar detyrimet monetare ose është deklaruar i falimentuar dhe nuk është rehabilituar;
 - ç) është ndaluar ose pezulluar nga gjykata të ushtrojë detyrën si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrojë veprimtarinë apo mjeshtërinë;
 - d) gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë aktive merr pjesë në veprimtari politike.
2. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë, si dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit Mbikëqyrës, mund të shkarkohen nga Kuvendi me propozim të shumicës së të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, kur:
 - a) personi i propozuar për shkarkim ka munguar për dy ose më shumë herë në vazhdimësi në mbledhjet e rradhës të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pa shkak të arsyeshëm;
 - b) personi i propozuar për shkarkim është në pamundësi fizike ose mendore për të mbuluar funksionet e ngarkuara; ose
 - c) personi i propozuar për shkarkim gjatë ushtrimit të detyrës ka shkelur rëndë etikën e punës dhe ka cënuar thellë interesat e Bankës së Shqipërisë.
3. Në rast se anëtari i Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë Guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët, është pezulluar prej detyrës nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi nuk e ka shkarkuar brenda 30 ditëve nga pezullimi, atëherë ky pezullim shfuqizohet dhe anëtari i pezulluar rifiton të drejtat dhe detyrimet menjëherë.
4. Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë Guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët nuk mund të largohet nga detyra për shkaqe ose procedura të tjera.

NENI 48

1. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët mund të japin dorëheqjen duke njoftuar me shkrim, përpara jo më pak se tre muajve, Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë.
2. Çdo anëtar tjetër i Këshillit Mbikëqyrës mund të japë dorëheqjen duke njoftuar me shkrim, përpara jo më pak se një muaj, Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë.
3. Çdo vend vakant në Këshillin Mbikëqyrës do të plotësohet me emërimin e anëtarit të ri të Këshillit Mbikëqyrës, sipas dispozitave të nenit 44 të këtij ligji, i cili e ushtron këtë funksion brenda afatit të mbetur të anëtarit që ka zëvendësuar.

ENI 49

1. Në mungesë të guvernatorit ose në pamundësi të tij për të votuar, Zëvendësguvernatori i Parë duhet të kryesojë mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës.
2. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet sa herë që kërkohet për realizimin e veprimtarisë së Bankës të Shqipërisë, por jo më pak se një herë në çdo muaj kalendarik.
3. Normalisht, mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës thirren nga Guvernatori. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund të thirren edhe me kërkesën me shkrim të tre prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ose në rast emergjence të dy prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
4. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës thirren duke komunikuar kohën, vendin dhe programin e mbledhjes për të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të paktën pesë ditë pune përpara datës së caktuar për mbledhje, përveç rasteve kur ka urgjencë dhe mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbledhen me afat njoftimi më të shkurtër.
5. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtën e një vote. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të emëruar, duke përfshirë praninë e kryetarit ose të zëvendëskryetarit të Këshillit Mbikëqyrës.
6. Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës miratohen me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të cilët janë të pranishëm në mbledhje. Vetëm anëtarët e këshillit që janë personalisht të pranishëm kanë të drejtën e votës; si përjashtim nga ky rregull, "Statuti" i Bankës së Shqipërisë mund të lejojë që në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës votimi të kryhet me mjete të tjera komunikimi, dhe në raste të veçanta me teleks ose mjete të testuara elektronike. Në rast barazie vote, kryetari i mbledhjes ka votën përcaktuese.
7. Duke pasur parasysh pikën 5 të këtij neni, lidhur me pjesëmarrjen e anëtarëve në mbledhje, asnjë veprim ose procedurë e Këshillit Mbikëqyrës nuk do të konsiderohet e pavlefshme thjesht për shkak të qenies së vendit vakant ose të vendeve vakante të Këshillit Mbikëqyrës.
8. Të gjitha veprimet e kryera në mirëbesim nga një person me cilësinë e kryetarit ose të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës do të jenë të vlefshme, pavarësisht nga ndonjë mangësi që mund të jetë konstatuar në emërimin, rregullsinë a në kualifikimin e tij.
9. Ministri i Financave ka të drejtë të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ENI 50

1. Procedurat dhe rezultatet e Mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës janë konfidenciale. Këshilli Mbikëqyrës mund të vendosë për të bërë të njohura publikisht një pjesë ose të gjitha vendimet e tij.
2. Protokollin e mbledhjes për çdo mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i Këshillit Mbikëqyrës.
3. Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës prej personelit drejtues të Bankës së Shqipërisë. Sekretari nuk është anëtar i Këshillit Mbikëqyrës.
4. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës regjistrohen dhe nxirren me nënshkrimin e kryetarit që drejton mbledhjen e Këshillit që ka miratuar vendimin, si dhe të sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës.

ENI 51

1. Që në momentin e pjesëmarrjes në Këshillin Mbikëqyrës dhe për çdo vit e më pas, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës do të deklarojnë pranë Këshillit Mbikëqyrës plotësisht interesat e tyre tregtare që ata ose anëtarët e tjerë të familjes mund të kenë, drejtpërdrejt ose tërthorazi. Këto deklarata duhet të bëhen sipas rregullave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
2. Kurdoherë që shtrohen për diskutim në Këshillin Mbikëqyrës çështje në lidhje me këto interesa, anëtarit që ka lidhje me çështjen duhet të deklarojë interesat e tij (saj) në fillimin e diskutimit

dhe nuk do të marrë pjesë në diskutimin dhe vendimin mbi këtë çështje. Prania e këtij anëtar nuk do të llogaritet për efekt të pjesëmarrjes në mbledhje.

ENI 52

Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës, pas largimit nga kjo detyrë, nuk duhet të shërbejnë pranë ndonjë institucioni tjetër financiar gjatë një periudhe prej një viti.

ENI 53

1. Guvernatori vepron si drejtor i përgjithshëm ekzekutiv i Bankës së Shqipërisë, i ngarkuar për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Bankës së Shqipërisë. Në rast se Guvernatori mungon ose është në pamundësi për të vepruar, Zëvendësguvernatori i Parë vepron në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv të Bankës së Shqipërisë.
2. Guvernatori përgjigjet për hartimin dhe për paraqitjen në Këshillin Mbikëqyrës të politikës monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore, si dhe të politikave të tjera.
3. Guvernatori përgjigjet përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e vendimeve të miratuara, duke përfshirë zbatimin e politikës monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore, si dhe për drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi administrimin dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë.
4. Të gjitha kompetencat që nuk specifikohen për Këshillin Mbikëqyrës i njihen Guvernatorit ose, në rastin kur Guvernatori mungon, ose është në pamundësi për të vepruar, këto kompetenca i njihen Zëvendësguvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë. Në veçanti, i njihen kompetencat për të kryer veprimet e kërkuara ose të gjykuara si të pranueshme prej tij për administrimin ose për operacionet e Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë pa kufizim:
 - a) angazhimin në marrëdhënie kontraktore në emër të Bankës së Shqipërisë;
 - b) emërimin e punonjësve, të agjentëve dhe të korrespondentëve të Bankës së Shqipërisë;
 - c) përfaqësimin e Bankës së Shqipërisë në procedurat ligjore.

Guvernatori, me miratim të Këshillit Mbikëqyrës, mund t'ua delegojë disa nga kompetencat e tij nëpunësve të Bankës së Shqipërisë.

ENI 54

1. Inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë emërohet për një afat pesëvjeçar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, midis kandidatëve që janë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe ndaj të cilëve nuk vërtetohen rastet e parashikuara në nenin 47 të këtij ligji. Inspektori i Përgjithshëm duhet të jetë ekonomist me arsim të lartë dhe të ketë punuar në sistemin bankar jo më pak se shtatë vjetë. Inspektori i Përgjithshëm mund të riemërohet. Paga e inspektorit të përgjithshëm, shpërblimet suplementare, duke përfshirë çdo lloj kompesimi, si dhe trajtimet e tjera, njësohen me ato të zëvendësguvernatorit të Bankës së Shqipërisë.
2. Inspektori i Përgjithshëm mund të japë dorëheqjen tre muaj pas njoftimit me shkrim në Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë. Inspektori i Përgjithshëm largohet vetëm me vendim të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, kur vërtetohen një ose disa nga shkaqet e përshkruara në nenin 47 të këtij ligji.
3. Inspektori i Përgjithshëm drejton Departamentin e Kontrollit të Bankës së Shqipërisë. Inspektori i Përgjithshëm propozon inspektorët e këtij departamenti. Inspektori i Përgjithshëm dhe inspektorët e Departamentit të Kontrollit kanë për detyrë:
 - a) të ushtrojnë kontroll kontabël të brendshëm, si dhe të kryejnë kontrole të brendshme periodike për administrimin dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë, me qëllim që të sigurojnë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe të akteve nënligjore në Bankën e Shqipërisë;
 - b) të kontrollojnë dhe t'i paraqesin Këshillit Mbikëqyrës raporte e rekomandime për llogaritë dhe regjistrat, si dhe për procedurat buxhetore, kontabël dhe kontrollet e Bankës së Shqipërisë;

- c) të kontrollojnë raportet periodike financiare dhe dokumentet e lidhura me to të Bankës së Shqipërisë dhe, në qoftë se janë përparitur në mënyrën e duhur, të nxjerrin certifikatë për këtë qëllim.
4. Inspektori i Përgjithshëm aktualisht në detyrë, largohet nga funksioni i tij me hyrjen në fuqi të këtij ligji, por ai ose ajo mund të rrimërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në zbatim të këtij ligji.

ENI 55

1. Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, personeli i saj nuk mund të përfitojë ndonjë kredi ose hua te ndonjë subjekt tjetër, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë vendos ndryshe.
2. Këshilli Mbikëqyrës përshtat rregulloren e personelit që trajton kushtet e punësimit në Bankën e Shqipërisë.

ENI 56

1. Guvernatori emëron dhe largon nëpunësit, agjentët dhe korrespondentët e Bankës së Shqipërisë, sipas dhe brenda kufijve, në përputhje me kushtet dhe afatet e përgjithshme të punësimit dhe të emërimeve, të parashikuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
2. Asnjë pagë, shpërblim, kompensim kuotë ose e ardhur tjetër apo paradhënie e paguar nga Banka e Shqipërisë nuk do të llogaritet mbi bazën e të ardhurave neto, të fitimit neto ose të të ardhurave të tjera të Bankës së Shqipërisë.

ENI 57

1. Gjatë veprimtarisë së tyre Guvernatori, zëvendësguvernatorët dhe Inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë i përkushtojnë të gjitha aftësitë e tyre profesionale shërbimit në Bankën e Shqipërisë dhe asnjë nga ata nuk mund të jetë në marrëdhënie tjetër punësimi, me shpërblim ose jo, përveç rasteve kur përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.
2. Asnjë punonjës i Bankës së Shqipërisë nuk mund hyjë në marrëdhënie punësimi tjetër, pavarësisht me shpërblim ose jo, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.
3. Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, drejtues ose personel i Bankës së Shqipërisë nuk duhet të pranojë ndonjë dhuratë a kredi për veten e tij ose në emër të çdo personi me të cilin ai ka lidhje familjare, veprimtari tregtare a financiare, në qoftë se pranimit në këtë rast mund të rezultojë me uljen e përkushtimit të nevojshëm ndaj detyrave të tij në Bankën e Shqipërisë.

ENI 58

1. Asnjë person që shërben ose ka shërbyer si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, drejtues dhe personel i Bankës së Shqipërisë ose si inspektor kontrolli, agjent ose korrespondent i Bankës së Shqipërisë, nuk duhet që në mënyrë të paautorizuar me ligj ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Banka e Shqipërisë është palë:
- (i) të lejojë zbulimin ose publikimin e informacioneve jopublike, të cilat ai ose ajo i ka përfituar nga kryerja e detyrave të tij/saj; ose
- (ii) të përdorë këtë informacion apo të lejojë që ky informacion të përdoret për përfitime personale.
2. Këta persona mund të bëjnë të njohur informacionin jopublik zyrës së taksave dhe tatimeve të Republikës së Shqipërisë. Informacioni jopublik mund të bëhet i njohur jashtë Bankës së Shqipërisë vetëm kur informacioni do të shërbejë për evidentimin e një akti ligjor ose të rrethanave apo të kushteve që janë pjesë e aktit ligjor për zbatim nga subjekti që e kërkon këtë informacion me shkrim. Sipas rastit, Banka e Shqipërisë mund të bëjë të njohur informacionin jopublik që ka siguruar gjatë kryerjes së detyrave të saj sipas këtij ligji ose ligjit "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" për :

- (i) bankat qendrore dhe autoritetet bankare mbikëqyrëse të vendeve të tjera, sipas marrëveshjeve të përfunduara dhe
- (ii) organizatave ndërkombëtare financiare, në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare.

KREU VII

REGJIMI I KËMBIMEVE VALUTORE, POLITIKA E KËMBIMEVE VALUTORE, REZERVAT VALUTORE, LLOGARITË REZERVË TË VEÇANTA DHE KONTROLLI I KËMBIMEVE VALUTORE

NENI 59

Regjimi i këmbimit valutor i Republikës së Shqipërisë përcaktohet nga Banka e Shqipërisë, në përputhje dhe sipas detyrimeve të traktateve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar.

NENI 60

1. Në zbatim të nenit 59, Banka e Shqipërisë mund të shpallë vlerën e lekut në raport me valutat e huaja dhe çdo ndryshim tjetër të tij. Vlera e lekut në raport me valutat e huaja do të përcaktohet lirisht në treg, në rast se Banka e Shqipërisë nuk shpall kursin e lekut në raport me valutat e huaja ose nuk miraton ndonjë regjim tjetër të këmbimeve valutore.
2. Banka e Shqipërisë përgatit, miraton dhe zbaton politikën e kursit të këmbimit të Republikës së Shqipërisë.
3. Si rregull i përgjithshëm, asnjë kufizim në veprime me llogaritë ose veprime me kapitalin për blerjen, shitjen, posedimin ose transferimin e valutës nuk zbatohet, përveç rasteve si më poshtë :
 - a) Banka e Shqipërisë mund të kufizojë përkohësisht veprimet në blerjen, shitjen, posedimin ose transferimin e valutës në llogaritë korente, në rastet kur, sipas gjykimit të Bankës së Shqipërisë, zbatimi i këtyre kufizimeve i shërben garantimit të mbrojtjes së normave të kursit të këmbimit valutor ose të nivelit të rezervës valutore;
 - b) çdo kufizim i parashikuar sipas paragrafit 3(a) të këtij neni, zbatohet për një afat kohor deri në dymbëdhjetë muaj dhe mund të zgjatet për një afat tjetër dymbëdhjetë muaj me miratim, me shumicë absolute votash, të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
 - c) kurdoherë kur Banka e Shqipërisë zbaton dispozitën 3(a) të këtij neni, duhet të raportojë pranë Kuvendit Popullor brenda shtatë ditëve, dhe më pas një herë në tre muaj, duke paraqitur arsyet dhe shkaqet që e detyruan për zbatimin e këtyre kufizimeve, së bashku me rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e situatës;
 - ç) kufizimet e miratuara sipas këtij neni duhet të jenë në përputhje me detyrimet e Republikës së Shqipërisë, të pranuar në marrëveshjet ndërkombëtare;
 - d) Banka e Shqipërisë mund të aplikojë kufizime valutore për pagesat dhe për transfertat në transaksionet e llogarisë së kapitalit;
 - dh) Banka e Shqipërisë përcakton me rregullore termat "veprime në llogarinë kapitale" dhe "veprime në llogari korente". Këto përcaktime duhet të jenë në përputhje me çdo marrëveshje ndërkombëtare të miratuar nga Republika e Shqipërisë.

NENI 61

Në mënyrë të veçantë, Banka e Shqipërisë ka të drejtë:

- a) të nxjerrë rregullore dhe udhëzime që rregullojnë operacionet e tregut të këmbimeve valutore;
- b) të licencojë, të revokojë licencën, të mbikëqyrë dhe të rregullojë agjentët e këmbimeve valutore, duke përfshirë bankat sipas rregullores së këmbimeve valutore të përgatitur nga Banka e Shqipërisë;
- c) të vendosë kufij mbi pozicionet e këmbimeve valutore të agjentëve të këmbimeve valutore, duke përfshirë bankat;

- ç) të blejë, të shesë, të disponojë, të mbajë dhe të administrojë mjetet (aktivet) e rezervës së saj valutore ndërkombëtare në përputhje me nenin 63 të këtij ligji.

ENI 62

Banka e Shqipërisë mundet që, si për llogari të saj, ashtu dhe për llogari të Shtetit Shqiptar, të marrë pjesë në marrëveshjet e kleringut dhe të pagesave ose në ndonjë kontratë tjetër për të njëjtin qëllim me institucionet publike a private qendrore të kleringut, të vendosura jashtë shtetit.

ENI 63

1. Banka e Shqipërisë mban dhe administron rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë, të cilat konsistojnë në të gjitha ose në një pjesë të mjeteve (aktive) të mëposhtme:
 - a) ar apo metale të tjera të çmuara;
 - b) valutë në formën e kartëmonedhës dhe të monedhës ose në llogaritë e Bankës të mbajtura në monedhë të huaj;
 - c) çdo mjet tjetër ndërkombëtar të njohur, duke përfshirë:
 - i) të drejtën për blerjen e transheve të rezervës nga Fondi Monetar Ndërkombëtar;
 - ii) mbajtjen nga Republika e Shqipërisë të monedhës së Fondit Monetar Ndërkombëtar (S.D.R.);
 - ç) kambialet dhe premtimet e pagesës, të pagueshme në valutë dhe
 - d) letra me vlerë të borxhit të emetuara ose të garantuara nga blerje me afat ose në marrëveshje me kusht riblerjeje, të përfunduara me ose të garantuara nga shtete të huaja ose banka qendrore, ose nga organizata financiare ndërkombëtare publike, të përcaktuara dhe të paguara në monedhë të huaj.
2. Banka e Shqipërisë do të përdorë mundësitë e saj më të mira për të mbajtur rezervën e saj valutore ndërkombëtare në një nivel që, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, do të jetë i përshtatshëm për zbatimin e politikës monetare dhe të këmbimeve valutore të Republikës së Shqipërisë dhe për ekzekutimet e menjëhershme të pagesave në transaksionet me jashtë.
3. Në rast se rezerva valutore e lartpërmendur zvogëlohet ose, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, është në rrezik të zvogëlimit në ato përmasa sa të rrezikojë zbatimin e politikës monetare dhe të këmbimeve valutore, apo të rrezikojë ekzekutimet e menjëhershme të pagesave në transaksionet me jashtë, Banka e Shqipërisë i dorëzon Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë një raport për pozicionet e rezervës valutore ndërkombëtare dhe për shkaqet që kanë çuar ose që mund të çojnë në një rënie të tillë, së bashku me rekomandimet përkatëse për rregullimin e situatës.
4. Për sa kohë që, sipas opinionit të saj, situata nuk është rregulluar, Banka e Shqipërisë do të bëjë raporte të mëtejshme dhe rekomandime, që do të konsiderohen si të këshillueshme.

ENI 64

Fitimi ose humbja e Bankës së Shqipërisë, gjatë një viti financiar, të rezultuar nga ndryshimet në vlerësim, të regjistruar në bilancin e Bankës së Shqipërisë, të aktivitetit ose të pasivit, ose të përcaktuar në ar, S.D.R., ose në monedhë të huaj dhe që rrjedhin nga ndonjë ndryshim në vlerë ose në kursin e këmbimit të arit, të S.D.R.-së ose të valutave në raport me lekun, do të rregullohet si më poshtë:

- a) shuma totale neto e valutës së fituar ose të humbur do të balancohet me një shumë korresponduese të emëruar "Llogaria e Vlerësimit të Rezervës" në bilancin e Bankës së Shqipërisë;
- b) për sa kohë shuma e regjistruar në llogarinë e vlerësimit të rezervës i korrespondon humbjeve neto në valutë, kjo shumë duhet të mbulohet me letrat me vlerë të borxhit, të cilat mbartin interes sipas interesit të tregut, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë për Bankën e Shqipërisë dhe të mbajtura nga Banka e Shqipërisë në llogarinë e vlerësimit të rezervës së letrave me vlerë jashtë bilancit. Brenda katër muajve pas mbylljes së vitit financiar, shuma kryesore totale e këtyre letrave me vlerë, të mbajtura nga Banka e Shqipërisë do të rritet ose do të zbritet sipas nevojës për të

- siguruar ekuivalencën midis kësaj shume dhe shumës së regjistruar në llogarinë e vlerësimit të rezervës si humbje neto e valutës në fund të vitit financiar;
- c) si fitimi neto, ashtu dhe humbja neto, të parashikuara në këtë nen nuk duhet të përfshihen në llogaritjen e fitimit neto vjetor të Bankës së Shqipërisë.

ENI 65

Agjentët e licencuar të këmbimeve valutore, duke përfshirë bankat, me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, duhet të raportojnë periodikisht pranë Bankës së Shqipërisë për operacionet e tyre, duke përfshirë pozicionet e hapura të këmbimeve valutore sipas monedhave. Banka e Shqipërisë duhet të përcaktojë formën e raportimit dhe dokumentet shoqëruese që duhet të dorëzohen.

KREU VIII

KONTABILITETI, BILANCI DHE RAPORTIMET E BANKËS SË SHQIPËRISË

ENI 66

Viti financiar i Bankës së Shqipërisë hapet më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.

ENI 67

Banka e Shqipërisë mban, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe standardet ndërkombëtare, llogari e regjistra, që në çdo kohë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.

ENI 68

Llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë mund të kontrollohen nga kontrollorë të jashtëm të institucioneve kontrolluese të njohura në arenën ndërkombëtare dhe që caktohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Kontrollorët do të shprehin opinionet e tyre, nëse raportet e përgatitura nga Banka e Shqipërisë paraqesin, në mënyrë të plotë dhe të drejtë, situatën financiare të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranura përgjithësisht të kontabilitetit.

ENI 69

1. Banka e Shqipërisë përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar. Ato i paraqiten Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të vitit financiar të Bankës.
2. Raporti dhe bilanci financiar i Bankës së Shqipërisë publikohen në formën e përcaktuar nga Banka, pas miratimit të tyre nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
3. Raporti duhet të përfshijë edhe opinionin e kontrollorëve lidhur me gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.
4. Banka e Shqipërisë publikon çdo muaj përmbledhjen e bilancit të saj.
5. Banka e Shqipërisë publikon çdo tre muaj një opinion të detajuar mbi gjendjen e ekonomisë.
6. Brenda gjashtë muajve me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dhe më pas për çdo gjashtë muaj, Banka e Shqipërisë informon Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë, duke publikuar edhe një deklaratë, e cila përmban:
 - a) nëse ekzistojnë kërcënime mbi stabilitetin e sistemit financiar;
 - b) natyrën dhe llojin e kërcënimit;
 - c) nëse kërkohen si domosdoshmëri përmirësimet ligjore dhe nënligjore në fuqi ose ndonjë iniciativë tjetër ligjvënëse.

KREU IX

DISPOZITA TË FUNDIT

ENI 70

1. Banka e Shqipërisë nxjerr vendime, rregullore, urdhra dhe udhëzime për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.
2. Rregulloret e nxjerra nga Banka e Shqipërisë dhe që zbatohen nga disa subjekte, publikohen në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë mban regjistrin publik të rregulloreve dhe të rekomandimeve.

ENI 71

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të marrë nga bankat dhe institucionet e tjera financiare dokumente ose informacione të tjera lidhur me marrëdhëniet ndërmjet secilës prej tyre dhe Bankës së Shqipërisë.

ENI 72

1. Çdo subjekt juridik ose fizik, i cënuar nga shkeljet e pretenduara të këtij ligji nga ana e Bankës së Shqipërisë, ka të drejtë t'i kundërshtojë ato përpara Gjykatës së Apelit.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, akti i Bankës së Shqipërisë do të zbatohet pa kufizim, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

ENI 73

1. Banka e Shqipërisë përjashtohet nga të gjitha tatimet dhe taksat.
2. Kartëmonedhat që qarkullojnë me emrin "Banka e Shtetit Shqiptar" do të vazhdojnë të jenë të vlefshme pa kufizim.
3. Kartëmonedhat e reja do të emetohen me emrin "Banka e Shqipërisë".

ENI 74

Banka e Shqipërisë ka vulën e saj me shenjat e stemës së Republikës të Shqipërisë.

ENI 75

Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji nga ndonjë bankë, agjenci këmbimi valutor, person, nëpunës apo subjekt tjetër juridik ose fizik, do të konsiderohet si kundërvajtje dhe dënohet sipas ligjit "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë".

ENI 76¹

Përjashtohet Banka e Shqipërisë si subjekt i dispozitave të ligjit "Për prokurimet publike", të ligjit "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë", si dhe të akteve nënligjore në fuqi për zbatimin e këtyre dispozitave. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të cilët kanë qenë propozuar nga Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Ministri i Financave dhe Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, të zgjedhur dhe të emëruar në bazë të ligjit nr.8230, datë 6.8.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8076, datë 22.2.1996 "Për Bankën e Shqipërisë", qëndrojnë në këtë funksion deri në mbarimin e mandatit të tyre.

Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, që largohen para mbarimit të mandatit për shkaqe të parashikuara në këtë ligj dhe që sipas ligjit nr.8230, datë 6.8.1997

propozoheshin nga Presidenti i Republikës dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, bëhet me propozim të Kuvendit Popullor. Ndërsa anëtari që propozohet nga Ministri i Financave do të propozohet nga Këshilli i Ministrave. Zgjedhja dhe emërimi i dy anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikëqyrës për të plotësuar vendet e reja, që u krijuan për shkak të shtimit të numrit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë sipas këtij ligji, bëhet nga Kuvendi Popullor.

Guvernatori, Zëvendësguvernatori dhe Sekretari i Përgjithshëm të emëruar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kryejnë funksionet (Sekretari i Përgjithshëm si Zëvendësguvernatori i Dytë) deri në mbarimin e mandatit të tyre, dhe mund të rizgjidhen sipas dispozitave të këtij ligji.

ENI 77

Ligji nr.8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë", ligji nr.8173 datë 21.12.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe ligji nr.8230 datë 06.08.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8173 datë 21.12.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë" shfuqizohen.

ENI 78

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shënim : Katër paragrafët e fundit të nenit 76 janë dispozita tranzitore të miratuara me ligjin nr.8384, datë 29.07.1998 dhe dekretuar me nr.2182, datë 11.08.1998.



BANKA E SHQIPËRISË KËSHILLI MBIKËQYRËS

STATUT

I

BANKËS SË SHQIPËRISË

Miratuar me vendimin nr. 100 datë 19.12.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nryshuar me vendimin nr. 84, datë 7.11.2001. Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" (si më poshtë ligji), Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton Statutin e Bankës së Shqipërisë.

Dispozitat e statutit zërthejnë dhe detajojnë kërkesa të ligjit për "Bankën e Shqipërisë".

Përcaktimet në këtë statut kanë të njëjtin kuptim si në ligjin për "Bankën e Shqipërisë".

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

ENI 1

Objekti i Statutit

Ky Statut përcakton parimet bazë të procedurave institucionale, administrative dhe operative të Bankës së Shqipërisë, personaliteti juridik, objektivat, pushteti dhe kompetencat e së cilës rregullohen nga ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

ENI 2

Statusi Juridik, Selia dhe Objektet e Veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë

- 2.1 Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" dhe me aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i saj, me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë, dhe konform qëllimit për të cilin janë dhënë këto kompetenca.
- 2.2 Banka e Shqipërisë është person juridik publik me seli në sheshin Skënderbej nr.1, Tiranë. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka të drejtë të ndryshojë vendndodhjen e selisë të Bankës së Shqipërisë.

- 2.3 Banka e Shqipërisë, brenda kompetencave të përcaktuara në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj si dhe në ushtrimin e detyrave të caktuara.
- 2.4 Banka e Shqipërisë ka si objekt të veprimtarisë së saj :
- a) hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikës monetare në Republikën e Shqipërisë;
 - b) hartimin, miratimin dhe zbatimin e regjimit të këmbimit valutor dhe të politikës së kursit të këmbimit të valutave në Republikën e Shqipërisë;
 - c) dhënien e licencave ose revokimin e tyre për bankat, si dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë bankare me qëllim sigurimin e stabilitetit bankar;
 - d) disponimin dhe administrimin e rezervës valutore të saj;
 - e) veprimin me cilësinë e bankierit, të këshilltarit dhe të agjentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
 - f) mbarëvajtjen e sistemit bankar shqiptar në veçanti dhe të sistemit financiar në përgjithësi;
 - g) nxitjen e funksionimit normal të sistemit të pagesave në Republikën e Shqipërisë;
 - h) tregtimin e letrave me vlerë, shpërndarjen e letrave me vlerë për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe emetimin e letrave me vlerë për llogari të saj;
 - i) mbikëqyrjen e pagesave ndërkombëtare, që rrjedhin nga veprime tregëtare dhe jotregëtare me jashtë, si dhe angazhimet e bankave të licencuara në Shqipëri, që kanë lidhur kontrata me shtete, banka apo me shoqëri të huaja;
 - j) hartimin e bilancit të pagesave të Shtetit Shqiptar, si dhe organizimin dhe drejtimin e sistemit të statistikave të këtij bilanci pagesash;
 - k) të drejtën ekskluzive për të qenë emetuesi i vetëm i kartëmonedhës dhe i monedhës kombëtare që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të drejtën e përcaktimit të formave, peshave, modelit dhe karakteristikave të tjera të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike kombëtare, të cilat kanë kurs ligjor, si dhe të monedhave e kartëmonedhave, që do të shtypen për qëllime numizmatike.
 - l) hartimin e planeve të emetimit dhe sigurimin e furnizimit të rregullt me kartëmonedha dhe me monedha metalike, për të plotësuar kërkesat e ekonomisë për para;
 - m) licencimin ose revokimin e licencës për agjentët e këmbimeve valutore, mbikëqyrjen dhe rregullimin e agjentëve të këmbimeve valutore, duke përfshirë bankat sipas rregullores së këmbimeve valutore të përgatitur nga Banka e Shqipërisë.

ENI 3

Objektivat dhe Kapitali i Bankës së Shqipërisë

- 3.1 Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve. Objektivat e tjerë të Bankës së Shqipërisë të kushtëzuar nga objektivi kryesor i saj, duhet të nxisin ruajtjen e likuiditetit, aftësinë pagueuese dhe funksionimin normal të sistemit bankar të

bazuar në parimet e tregut.

- 3.2 Banka e Shqipërisë në përputhje me objektivin e saj kryesor, mbështet zhvillimin e politikave të përgjithshme ekonomike të Republikës së Shqipërisë.
- 3.3 Kapitali i Bankës së Shqipërisë përbëhet nga :
- a) fondi i themelimit të Bankës, që akordohet dhe është në pronësi të Shtetit Shqiptar, dhe është në shumën 750 milionë lekë;
 - b) fondi i rezervës së përgjithshme, që është 500 për qind i fondit të themelimit të Bankës së Shqipërisë.

NENI 4

Bilanci

- 4.1 Viti financiar në Bankën e Shqipërisë hapet më datë 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor. Banka e Shqipërisë mban, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe me standardet ndërkombëtare, llogari dhe regjistra që në çdo kohë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.
- 4.2 Llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë mund të kontrollohen nga kontrollorë të jashtëm të institucioneve kontrolluese të njohura në arenën ndërkombëtare dhe që caktohen nga Këshilli Mbikëqyrës, dhe të cilët do të shprehin opinionin e tyre për këtë qëllim.
- 4.3 Bilanci i Bankës së Shqipërisë miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës, pas paraqitjes të raportit përkatës nga Departamenti i Kontrollit, dhe mbyllet në fund të çdo viti financiar.
- 4.4 Në fund të çdo viti financiar, Banka e Shqipërisë përgatit raportin dhe llogaritë financiare, të cilat paraqiten në Kuvendin Popullor dhe në Këshillin e Ministrave nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të vitit financiar të Bankës. Banka e Shqipërisë publikon çdo muaj përmbledhjen e bilancit të saj.

NENI 5

Vulat

- 5.1 Banka e Shqipërisë ka stemën e saj zyrtare të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, sipas formës së mëposhtme :
- 5.2 Vula Zyrtare në Bankën e Shqipërisë përdoret së bashku me nënshkrimet e autorizuara në Bankën e Shqipërisë.
- 5.3 Vula Zyrtare e Bankës së Shqipërisë është në formë të rumbullakët, në qendër vendoset stema dhe rreth saj shkruhen "Republika e Shqipërisë" dhe "Banka e Shqipërisë", si dhe shënimet e nevojshme për identifikim, sipas formës së mëposhtme :
- 5.4 Këshilli Mbikëqyrës përcakton :
- a) kategoritë e nëpunësve, të punonjësve të autorizuar të Bankës së Shqipërisë për përdorimin e Vulës Zyrtare, si dhe mënyrën e verifikimit të saj me origjinalin;
 - b) elementet formale dhe specifike të Vulës Zyrtare të Bankës së Shqipërisë si dhe vulat datare, të cilat do të jenë në qarkullim.

- 5.5 Vula Zyrtare e Bankës së Shqipërisë vendoset në dokumentet që janë parashikuar në aktet ligjore, nënligjore ose zakonet bankar.
- 5.6 Përveç Vulës Zyrtare, në Bankën e Shqipërisë përdoren edhe vula të tjera të zakonshme, që përfaqësojnë struktura të Bankës së Shqipërisë ose elemente të tjera (vula datare). Forma, lloji dhe veçoritë e tyre miratohen nga njëri prej administratorëve të Bankës së Shqipërisë, sipas fushës përkatëse.

KREU II

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 6

- 6.1 Banka e Shqipërisë organizohet në mënyrë të centralizuar me seli në Tiranë dhe degë në qendrat e tjera administrative në Shqipëri.
- 6.2 Banka e Shqipërisë ka të drejtë të hapë filiale, degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi në qendrat administrative brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Organizimi, shpërndarja dhe juridiksioni i filialeve, degëve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

NENI 7

Organet vendimore dhe ekzekutive

- 7.1 Banka e Shqipërisë organizohet dhe drejtohet nga organet e saj vendimore dhe ekzekutive.
- 7.2 Organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i politikave, i administrimit dhe i operacioneve të Bankës së Shqipërisë është Këshilli Mbikëqyrës, i cili kryen veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" dhe Statutin.
- 7.3 Veprimtaria ekzekutive në Bankën e Shqipërisë realizohet nëpërmjet organeve të saj të përcaktuara në nenin 12 të këtij Statuti. Objekti i veprimtarisë së organeve ekzekutive përcaktohet nga Këshilli Mbikëqyrës, administratorët apo autorizimet e përgjithshme dhe të posaçme.

NENI 8

Administratorët

Banka e Shqipërisë drejtohet dhe administrohet nga Guvernatori, Zëvendësguvernatori i Parë dhe Zëvendësguvernatori i Dytë. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët realizojnë detyrat dhe funksionet e tyre në përputhje me dispozitat ligjore, me statutin, me aktet e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës dhe me aktet e tjera nënligjore.

ENI 9

Guvernatori

- 9.1 Guvernatori është Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës dhe vepron si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës së Shqipërisë.
- 9.2 Guvernatori monitoron dhe mbikëqyr drejtpërsëdrejti veprimtarinë e zëvendësguvernatorëve dhe të organeve ekzekutive në Bankën e Shqipërisë.
- 9.3 Guvernatori nxjerr urdhra me karakter të posaçëm, udhëzime, rekomandime dhe opinione në zbatim të ligjit dhe të akteve nënligjore të Këshillit Mbikëqyrës.
- 9.4 Guvernatori përgjigjet për :
- a) hartimin, paraqitjen në Këshillin Mbikëqyrës të politikës monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore, si dhe të politikave të tjera të Bankës së Shqipërisë;
 - b) zbatimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës duke përfshirë zbatimin e politikës monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore;
 - c) zbatimin e politikave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme, për administrimin e procedurave ekzekutive si dhe për qeverisjen e punëve administrative të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë;
 - ç) koordinimin e punës në Bankën e Shqipërisë që të sigurohet zbatimi i vendimeve, i rregulloreve dhe i udhëzimeve me karakter të përgjithshëm të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
- 9.5 Guvernatori me propozim të organit vartës ekzekutiv paraqet për miratim në Këshillin Mbikëqyrës buxhetin vjetor administrativ të Bankës së Shqipërisë. Buxheti faktik, i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, i aneksohet Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë.
- 9.6 Guvernatori përfaqëson Bankën e Shqipërisë në marrëdhëniet e punësimit.
- 9.7 Guvernatori përfaqëson Bankën e Shqipërisë në marrëdhënie me subjekte të treta, të huaja ose vendase ose jorezidente.
- 9.8 Guvernatori nënshkruan në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë.
- 9.9 Për çështje specifike dhe të një karakteri të veçantë për Bankën e Shqipërisë, Guvernatori mund t'i delegojë kompetencat e tij komiteteve të veçanta, të cilat si organe kolegjiale krijohen me miratim të Këshillit Mbikëqyrës. Përbërja e këtyre komiteteve përzgjidhet nga Guvernatori sipas fushave përkatëse dhe strukturës së Bankës së Shqipërisë.
- 9.10 Përveç kur Këshilli Mbikëqyrës i miraton shprehimisht, komitetet që krijohen si në pikën 9.9, nuk kanë të drejtë të nëndelegojnë kompetencat në një organ tjetër.

ENI 10

Zëvendësguvernatori i Parë

- 10.1 Zëvendësguvernatori i Parë asiston dhe përgjigjet përpara Guvernatorit për çështje të lidhura me zhvillimet në sistemin bankar dhe me rolin mbikëqyrës

të Bankës së Shqipërisë në këtë sistem, të politikave të administrimit të parasë të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, duke influencuar në arritjen e politikave kredituese.

- 10.2 Zëvendësguvernatori i Parë përgjigjet për paraqitjen e informacioneve e raporteve në Këshillin Mbikëqyrës jo më pak se një herë në muaj, për mbarëvajtjen e mbikëqyrjes së sistemit bankar shqiptar në veçanti dhe të sistemit financiar në përgjithësi, dhe për hartimin dhe realizimin e buxhetit të Bankës së Shqipërisë.
- 10.3 Zëvendësguvernatori i Parë monitoron dhe mbikëqyr drejtpërsëdrejti veprimtarinë e strukturave të caktuara në Bankën e Shqipërisë me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, dhe organizon dhe drejton mbledhje periodike të tyre. Në mbledhjet periodike mund të ftohen për raportime, referime dhe këshillime nëpunës, ekspertë ose specialistë të tjerë të punësuar ose jo në Bankën e Shqipërisë, që kanë lidhje me çështjen objekt diskutimi.
- 10.4 Zëvendësguvernatori i Parë përgatit dhe lëshon urdhra për përdorim të brendshëm, të detyrueshëm për zbatim në Bankën e Shqipërisë si dhe nxjerr rekomandime e opinione.

ENI 11

Zëvendësguvernatori i Dytë

- 11.1 Zëvendësguvernatori i Dytë asiston dhe përgjigjet përpara Guvernatorit për :
- a) zbatimin e politikës rregullatore dhe juridike;
 - b) zbatimin e politikave të administrimit të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës;
 - c) mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave të përdorimit të mjeteve financiare të Bankës së Shqipërisë;
 - dh) për zbatimin e procedurave në drejtimin e përgjithshëm ekzekutiv dhe administrativ në Bankën e Shqipërisë.
- 11.2 Për vlerësimin periodik të administrimit në përgjithësi në Bankën e Shqipërisë, Zëvendësguvernatori i Dytë përgatit dhe paraqet raporte në Këshillin Mbikëqyrës si më poshtë:
- a) për marrëdhëniet kontraktore juridike civile të Bankës së Shqipërisë;
 - b) për ecurinë e procedurave dhe të praktikave administrative.
- 11.3 Zëvendësguvernatori i Dytë monitoron dhe mbikëqyr drejtpërsëdrejti veprimtarinë e strukturave të caktuara në Bankën e Shqipërisë me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, dhe organizon dhe drejton mbledhje periodike të tyre. Në mbledhjet periodike mund të ftohen për raportime, referime dhe këshillime nëpunës, ekspertë ose specialistë të tjerë të punësuar ose jo në Bankën e Shqipërisë.
- 11.4 Zëvendësguvernatori i Dytë përgatit dhe lëshon urdhra të brendshëm, të detyrueshëm për zbatim në Bankën e Shqipërisë si dhe nxjerr rekomandime e opinione.

KREU III

VEPRIMTARIA EKZEKUTIVE

NENI 12

- 12.1 Veprimtaria ekzekutive në Bankën e Shqipërisë organizohet nëpërmjet njësive organizative të saj në përputhje me strukturën administrative të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 12.2 Struktura administrative e Bankës së Shqipërisë përbëhet nga :
- a) Administrata në qendër:
 - i) departamentet;
 - ii) Kabineti i Guvernatorit.
 - b) Administrata lokale:
 - i) degët.
 - ii) Shtypshkronja.

NENI 13

Departamenti

- 13.1 Departamenti në Bankën e Shqipërisë është njësi organizative në strukturën e Bankës së Shqipërisë me fuqi administrative dhe ekzekutive. Departamenti organizon, administron dhe drejton punën me objekt të përcaktuar, në përputhje me rolin dhe me funksionin sipas rregullores së brendshme të tij të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Departamenti drejtohet nga drejtori i departamentit. Drejtori i departamentit është drejtues ekzekutiv. Departamenti mund të ndahet në drejtori, sektorë dhe zyra.
- 13.2 Departamentet në Bankën e Shqipërisë klasifikohen:
- a) departamente me funksione kryesore (parësore);
 - b) departamente me funksione shërbimi dhe ndihmëse (dytësore);
 - c) departamente me funksione shërbimi (tretësore).

Përcaktimi konkret i departamenteve sipas këtij klasifikimi bëhet nga Këshilli Mbikëqyrës.

NENI 14

- 14.1 Drejtorët e departamenteve e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin, me statutin, me rregulloren përkatëse të çdo departamenti dhe rregulloret e tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 14.2 Çdo drejtor departamenti përgjigjet për :
- i) hartimin e projekteve dhe të studimeve, që paraqiten për miratim në Këshillin Mbikëqyrës ;
 - ii) organizimin dhe drejtimin e punës në njësine organizative që i është besuar;
 - iii) zbatimin me efikasitet, në kushte normale dhe në kohë të të gjitha detyrave të deleguara nga Këshilli Mbikëqyrës, Guvernatori, Zëvendësguvernatori i Parë dhe i Dytë;
 - iv) zbatimin me efikasitet, në kushte normale dhe në kohë të të gjitha përgjegjësisë dhe pushteteve të parashikuara në rregulloren e brendshme të njësisë organizative dhe në rregulloret e tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

- 14.3 Çdo vend vakant në postin e drejtuesit të departamentit për shkak të vdekjes, dorëheqjes, transferimit, kualifikimit pasuniversitar ose të ndonjë shkakut tjetër plotësohet nga Guvernatori për një afat të pacaktuar, por jo më shumë se një vit kalendarik, deri në emërimin nga Këshilli Mbikëqyrës.

ENI 15

Degët

- 15.1 Banka e Shqipërisë, përveç administratës qendrore me seli në Tiranë për ushtrimin e veprimtarisë ekzekutive të saj, ka degë në rrethe të tjera të Shqipërisë, aktiviteti i të cilave rregullohet me rregullore të veçantë.
- 15.2 Me degë do të kuptohet njësi organizative e Bankës së Shqipërisë nën varësinë e kësaj të fundit, që kryen drejtpërsëdrejti të gjitha ose disa veprimtari në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë.

ENI 16

Personeli

- 16.1 Marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë rregullohen nga ligji "Për Bankën e Shqipërisë" dhe rregullorja e personelit, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
- 16.2 Anëtarët e personelit të Bankës së Shqipërisë emërohen dhe largohen nga Guvernatori, përveç atyre që emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 16.3 Anëtarët e personelit emërohen dhe stimulohen në bazë të parimeve të kualifikimit profesional, publicitetit, transparencës, barazisë së palëve dhe jo diskriminimit.
- 16.4 Në bazë të akteve të Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatori vendos mbi emërimin e punonjësve brenda çdo njësie të Bankës së Shqipërisë. Vendimi është i publikueshëm.
- 16.5 Njësitë dhe strukturat organike të Bankës së Shqipërisë vendosen nën drejtimin administrativ të administratorëve sipas rregullave proceduriale të miratuar. Në bazë të rregullave proceduriale, administratorët përcaktojnë përgjegjësitë individuale sipas njësive dhe strukturave të miratuara.
- 16.6 Çdo anëtar i personelit të Bankës së Shqipërisë duhet të informohet për pozicionin e tij/saj në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë, për mënyrat e raportimit dhe për përgjegjësitë profesionale.
- 16.7 Për zbatimin e ligjit, të statutit dhe të rregullave proceduriale të Bankës së Shqipërisë në marrëdhënie me anëtarët e personelit nxirren akte administrative. Aktet administrative janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e personelit të Bankës së Shqipërisë.
- 16.8 Këshilli Mbikëqyrës miraton rregulloren e personelit dhe të kodit etik të punonjësve të Bankës së Shqipërisë, e cila përmirësohet sipas propozimit të organit vartës ekzekutiv.

ENI 17

Kontrolli

Departamenti i Kontrollit në veprimtarinë e tij drejtohet nga Inspektori i Përgjithshëm dhe bazohet në ligjet dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Inspektori i Përgjithshëm i paraqet Këshillit Mbikëqyrës raporte e rekomandime për problemet që dalin nga kontrollat e ushtruara, dhe çertifikon bilancet tremujore në pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë.

Inspektorët e Departamentit të Kontrollit emërohen dhe largohen nga Guvernatori , me propozim të Inspektorit të Përgjithshëm.

Objektet dhe procedurat e kontrollit përcaktohen në rregulloren e brendshme të këtij departamenti.

Rregullorja e brendshme e Departamentit të Kontrollit propozohet nga Inspektori i Përgjithshëm dhe miratohet në Këshillin Mbikëqyrës.

KREU IV

MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

NENI 18

- 18.1 Procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës në Bankën e Shqipërisë janë përcaktuar në rregulloren "Për funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".
- 18.2 Këshilli Mbikëqyrës vendos dhe gjykon mbi procedurat e votimit në mbledhjet e tij. Për raste të veçanta, urgjente dhe të rëndësishme, votimi në Këshill Mbikëqyrës mund të realizohet me mjete elektronike të testuara komunikimi. Mënyra e votimit duhet të shënohet në procesverbal dhe të verifikohet nga Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës.

KREU V

TË NDRYSHME

NENI 19

- 19.1 "Kompetencat e nënshkrimit, ekzekutimit dhe qarkullimit të dokumentacionit nga dhe në Bankën e Shqipërisë, si dhe limitet e veprimit të pagesave, do të përcaktohen me udhëzim të veçantë të nxjerrë nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë".
- 19.2 Çdo ndryshim në librin e nënshkrimeve të autorizuara duhet t'i njoftohet palëve të interesuara.
- 19.3 Në bazë të nenit 2 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës , administrator dhe nëpunës i Bankës së Shqipërisë sipas të drejtave të deleguara dhe detyrave të ngarkuara, nuk duhet të kërkojë apo të përfaqësojë interesat , udhëzimet apo porositë e organeve të tjera qendrore publike.
- 19.4 Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, nëpunësit dhe punonjësit (personeli) e Bankës së Shqipërisë gjatë ushtrimit të pushteteve dhe të detyrimeve të njohura nga ligji, Statuti ose ndonjë rregullore tjetër e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, mund të zhëmtohen ose rimbursohen nga Banka e Shqipërisë për shpenzime të arsyetuara, të argumentuara dhe të dokumentuara, që shkaktohen nga ndjekja e veprimeve, mosveprimeve, procedurave civile dhe penale dhe çdo pasojë tjetër e

kryer në detyrë ose në përfaqësimin e institucionit me të tretët. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur subjektet e lartpërmendura kanë vepruar me keqdashje ose nga neglizhenca.

- 19.5 Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, nëpunësit dhe punonjësit (personeli) e Bankës së Shqipërisë gjatë dhe pas ushtrimit të pushteteve dhe të detyrimeve të njohura nga ky Statut dhe nga ligji, detyrohen të ruajnë sekretin e informacionit, dokumenteve dhe të shënimeve, të çështjeve të përfunduara ose të papërfunduara, për përdorim të brendshëm ose për jashtë Bankës së Shqipërisë.
- 19.6 Në prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve të Bankës së Shqipërisë ndiqen parimet e transparencës, të publikimit, të barazisë së palëve, të jodiskriminimit dhe të administrimit me eficiencë, në përputhje me aktet përkatëse të prokurimit në Bankën e Shqipërisë.
- 19.7 Këshilli Mbikëqyrës miraton të gjitha aktet në zbatim të ligjit dhe Statutit të Bankës së Shqipërisë për çdo rast që konsiderohet e nevojshme apo e përshtatshme për të administruar veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

ENI 20

- 20.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen ose të revokohen në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës me shumicë të thjeshtë votash.
- 20.2 Ky statut, së bashku me ndryshimet e tij, publikohet dhe depozitohet pranë Bankës së Shqipërisë për inspektim në çdo kohë brenda orarit zyrtar.
- 20.3 Statuti i Bankës së Shqipërisë miratuar me vendimin nr.141 datë 26.10.1998 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe ndryshuar me vendimin nr.12 datë 17.02.1999 shfuqizohet.

Shkëlqim CANI

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS



BANKA E SHQIPËRIË

RREGULLORE

MBI

RREGULLAT PROCEDURIALE TË BANKËS SË

SHQIPËRIË

Miratuar me vendimin nr. 37, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" (si më poshtë "Ligji"), dhe të Statutit të Bankës së Shqipërisë, vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.100, datë 19.12.2000 "Për miratimin e Statutit të Bankës së Shqipërisë" (si më poshtë "Statuti"), Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton rregulloren "Mbi rregullat procedurale të Bankës së Shqipërisë" (si më poshtë "Rregullat").

Rregullat zërthejnë dhe detajojnë zbatimin e Ligjit dhe të Statutit të Bankës së Shqipërisë.

Përcaktimet në këto rregulla kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin dhe në Statutin e Bankës së Shqipërisë.

NENI 1

Objekti dhe përkufizime

- 1.1 Rregullat kanë për objekt organizimin e punëve në Bankën e Shqipërisë, linjat e raportimit dhe përgjegjësitë administrative në Bankën e Shqipërisë. Përveç kur është parashikuar ndryshe me akte të veçanta, dispozitat e rregullave përmbajnë veprime operacionale, procedura të brendshme dhe interpretime në drejtimin e veprimtarisë administrative.
- 1.2 Sipas përdorimit në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kuptojnë si vijon:
 - a) "Organizim" është struktura organizative dhe mënyra e administrimit të punëve në Bankën e Shqipërisë.
 - b) "Linjat e raportimit" janë format dhe mënyrat e komunikimit (verbale dhe joverbale, elektronike dhe joelektronike etj.) monitorimi dhe ekzaminimi i detyrave si dhe i kryerjes së angazhimeve apo detyrimeve të tjera në Bankën e Shqipërisë.
 - c) "Përgjegjësitë" janë detyrime të përcaktuara apo të autorizuara, individuale apo kolegjiale të shprehura në akte ligjore e nënligjore.
 - ç) "Korrespondencë" është komunikimi midis njësive organizative brenda Bankës së Shqipërisë ose ndërmjet tyre dhe personave të tjerë fizikë apo juridikë, nëpërmjet letrave, shkresave apo këmbimit të informacionit dhe materialeve informative.
- 1.3 Rregullat janë norma që përcaktojnë detyrime për Administratorët dhe për personelin e Bankës së Shqipërisë.

- 1.4 Drejtuesit e departamenteve, me pëlqimin e administratorëve, mund të ndërmarrin veprime administrative sipas këtyre rregullave apo akteve të tjera për drejtimin e punës në departamentet e tyre.
- 1.5 Anekset e mëposhtme janë një pjesë përbërëse e rregullave :
- | | | |
|----|------------------------|----------|
| a) | Struktura organizative | Aneksi 1 |
| b) | Plani organizativ | Aneksi 2 |

ENI 2

Parimi i besimit reciprok dhe i bashkëpunimit

Banka e Shqipërisë është njësi e vetme organizative në të cilën administratorët dhe personeli punojnë së bashku në bazë të parimeve të besimit reciprok dhe të bashkëpunimit për të siguruar që puna e Bankës së Shqipërisë të kryhet rregullisht, që vendimet janë marrë me kujdes e janë zbatuar me përpikmëri si dhe qëndrimet e saj janë prezantuar vazhdimisht në publik.

ENI 3

Struktura dhe organizimi

Struktura organizative e Bankës së Shqipërisë është treguar në tabelën e strukturës së organizimit (aneksi 1). Struktura organizative është e publikueshme. Kompetencat e veçanta për vendet e punës, të kushtëzuara nga dispozitat e neneve 4 dhe 5 të këtij akti, përcaktohen në planin organizativ (aneksi 2).

ENI 4

Kompetencat që i rezervohen administratorëve

- 4.1 Administratorët drejtojnë veprimtarinë dhe procedurat administrative të Bankës së Shqipërisë. Administratorët, sipas ndarjes në anekset 1 dhe 2, lëshojnë urdhra me karakter të posaçëm dhe porosi në zbatim të ligjit dhe të akteve nënligjore të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- 4.2 Guvernatori përfaqëson Bankën e Shqipërisë, kryesisht :
- a) në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, tek Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe në Këshillin e Ministrave;
 - b) tek anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe në subjektet e tjera të sektorit publik për fushën e veprimtarisë që mbulon sipas anekseve 1 dhe 2 të këtyre rregullave;
 - c) në marrëdhënie me përfaqësuesit e zgjedhur të politikës si dhe të fushës tregtare, të akademisë dhe të shoqërisë civile.
- 4.3 Përveç kur përcaktohet ndryshe në raste të veçanta, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë nxjerr deklarata në shtyp, në radio dhe në televizion, në bazë të rregullores përkatëse.
- 4.4 Guvernatori është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjitha çështjeve që i paraqiten për miratim Këshillit Mbikëqyrës. Guvernatori është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve të Këshillit Mbikëqyrës nga organet ekzekutive të Bankës së Shqipërisë.
- 4.5 Guvernatori duhet të përfshihet në përgatitjen dhe në zbatimin e politikave të Bankës së Shqipërisë si dhe në të gjitha çështjet e rëndësishme të veçanta për Bankën e Shqipërisë. Sipas

përdorimit në këtë rregullore, me 'përfshirje' kuptohet shkëmbimi periodik i informacionit si dhe lëshimi i udhëzimeve, rekomandimeve dhe porosive për nëpunësit e Bankës së Shqipërisë.

- 4.6 Zëvendësgubernatorët, me pëlqimin paraprak të Guvernatorit, përfaqësojnë Bankën e Shqipërisë tek anëtarët e Këshillit të Ministrave si dhe tek subjektet e tjera të sektorit publik dhe privat për fushën e veprimtarisë që mbulojnë sipas anekseve 1 dhe 2 të këtyre rregullave.
- 4.7 Administratorët miratojnë kërkesat për ndërprerje të përkohshme të marrëdhënieve të punës si dhe vizitat zyrtare të nëpunësve dhe punonjësve, sipas ndarjes në anekset 1 dhe 2 të këtyre rregullave. Në këtë rast, duhet të zbatohen parimet administrative të administrimit të punëve me kosto të ulët.

ENI 5

Mungesa dhe pamundësia për të ushtruar kompetencat

- 5.1 Në rast se Guvernatori mungon apo është në pamundësi për të ushtruar kompetencat, Zëvendësgubernatori i Parë merr dhe ushtron kompetencat e tij.
- 5.2 Në rast se Guvernatori dhe Zëvendësgubernatori i Parë mungojnë apo janë në pamundësi për të ushtruar kompetencat, Zëvendësgubernatori i Dytë merr dhe ushtron kompetencat e tyre.
- 5.3 Në rast se Zëvendësgubernatori i Parë mungon apo është në pamundësi për të ushtruar kompetencat, Zëvendësgubernatori i Dytë merr dhe ushtron kompetencat e tij.
- 5.4 Në rast se Zëvendësgubernatori i Dytë mungon apo është në pamundësi për të ushtruar kompetencat, Zëvendësgubernatori i Parë merr dhe ushtron kompetencat e tij.
- 5.5 Në rast se të gjithë administratorët mungojnë apo janë në pamundësi për të ushtruar kompetencat, Banka e Shqipërisë përfaqësohet nga nëpunësi me vjetërsinë më të madhe në Bankën e Shqipërisë në shkallën më të lartë të hierarkisë në departamentet e kategorisë së parë sipas anekseve 1 dhe 2 të këtyre rregullave.
- 5.6 Për çdo rast mungese apo pamundësie për të vepruar në çdo njësi apo strukturë të Bankës së Shqipërisë sipas anekseve 1 dhe 2 të këtyre rregullave, si rregull i përgjithshëm, kompetencat i delegohen nëpunësit me vjetërsinë më të madhe në atë njësi apo strukturë.

ENI 6

Komitetet

- 6.1 Komitetet në Bankën e Shqipërisë janë organe kolegjinale. Komitetet janë organe vendimore, për çështjet e deleguara në zbatim të politikës dhe operacioneve monetare, të operacioneve financiare dhe administrative të Bankës së Shqipërisë. Komitetet krijohen edhe si organe këshillimore, sipas specifikave të veçanta për të cilat merret vendimi i krijimit të tyre.
- 6.2 Komiteti krijohet me propozim të Guvernatorit dhe me miratim të Këshillit Mbikëqyrës.
- 6.3 Qëllimi kryesor i komiteteve është të ndihmojë dhe të asistojë administratorët në kryerjen e punëve në Bankën e Shqipërisë. Komitetet vendosin për çështje të deleguara nga Këshilli Mbikëqyrës, nga Guvernatori, ose për çështje të veçanta sipas propozimit të departamentit.
- 6.4 Përbërja e komitetit përcaktohet me urdhër të Guvernatorit. Afati i veprimtarisë së komitetit mund të jetë i kufizuar ose i pakufizuar.

- 6.5 Komiteti përbëhet si rregull i përgjithshëm nga Administratorët dhe drejtuesit e departamenteve të Bankës së Shqipërisë. Kryetari, që kryeson mbledhjen e Komitetit, fton anëtarët e komitetit të marrin pjesë në mbledhje. Sipas rastit, Guvernatori cakton nëpunës të tjerë të Bankës së Shqipërisë për të marrë pjesë në mbledhjet e komitetit.

ENI 7

Dita dhe vendi i mbledhjeve të komitetit

- 7.1 Dita e mbledhjes së komitetit përcaktohet nga Administratori, i cili kryeson mbledhjen e tij.
- 7.2 Mbledhjet e Komitetit kryesohen nga Administratorët. Në këtë rast Administratori, i cili kryeson mbledhjen e komitetit, është në pozicionin e kryetarit. Mbledhjet e komitetit zhvillohen në rast se janë jo më pak se tre anëtarë.
- 7.3 Komiteti mund të zhvillojë mbledhjet e tij kurdoherë kur e gjykon të nevojshëm kryetari me propozim të tij ose të një anëtari.
- 7.4 Mbledhjet e komitetit si rregull i përgjithshëm, zhvillohen në ambjentet e Bankës së Shqipërisë. Mbledhjet e komitetit mund të zhvillohen edhe nëpërmjet telekonferencës me iniciativë të Administratorëve të Bankës së Shqipërisë.

ENI 8

Pjesëmarrja në mbledhjet e komitetit

- 8.1 Pjesëmarrja në mbledhjet e komitetit është e kufizuar vetëm për anëtarët. Çdo anëtar, me pëlqimin e kryetarit, mund të shoqërohet nga një nëpunës.
- 8.2 Në rast se ndonjë anëtar mungon apo është në pamundësi për të marrë pjesë në mbledhjet e komitetit mund të autorizojë një person tjetër për të marrë pjesë në mbledhje. Kryetari njoftohet për çdo rast.
- 8.3 Në komitet mund të ftohen persona të tretë për pjesëmarrje në mbledhjet e tij në rast se gjykohet e përshtatshme. Pjesëmarrja e personave të tretë është pa të drejtë vote.

ENI 9

Votimi në mbledhjet e komitetit

- 9.1 Vendimet në komitet merren me shumicën e thjeshtë të votave. Vota e kryetarit është përcaktuese në rast barazie të votave.
- 9.2 Me kërkesën e jo më pak se tre anëtarëve, vendimet merren në formën dokumentare (me shkrim).
- 9.3 Kurdoherë kur komiteti, vendos brenda kompetencave të deleguara, mendimi i pakicës prezantohet për dijeni në organet vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë.
- 9.4 Procedurat dhe rezultatet e komitetit protokollohen nga sekretari i komitetit. Sekretari emerohet nga kryetari prej personelit të Bankës së Shqipërisë.

NENI 10

Organizimi i mbledhjes së komitetit

- 10.1 Rendi i çështjeve që do të shqyrtohen në mbledhjet e komitetit përgatitet nga Administratorët e Bankës së Shqipërisë sipas ndarjeve të parashikuara në Anekset 1 dhe 2 të këtyre rregullave.
- 10.2 Rendi i çështjeve që do të shqyrtohen në mbledhjet e komitetit, si rregull i përgjithshëm, njoftohet dy ditë pune përpara mbledhjes.
- 10.3 Kryetari mund të heqë ose të shtojë çështje në rendin e çështjeve, që do të shqyrtohen në mbledhjen së komitetit.

NENI 11

Marrëdhëniet ndërmjet Këshillit Mbikëqyrës, administratorëve dhe komitetit

- 11.1 Komitetet vendosin për çështjet administrative dhe operacionale brenda kompetencave dhe autoritetit të deleguar nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 11.2 Komiteti këshillon dhe asiston administratorët në marrjen e vendimeve për çështjet administrative dhe operacionale sipas fushës së veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Instrumentet ligjore

Dokumentet e shqyrtuara në komitetet, përfshirë rekomandimet dhe opinionet, në rast se i adresohen organeve vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë, nënshkruhen nga Guvernatori.

NENI 13

Departamentet

- 13.1 Drejtuesit e departamenteve marrin vendime përfundimtare në përgjegjësinë e tyre lidhur me drejtimin e punës në fushat sipas ndarjes në Anekset 1 dhe 2 të këtyre rregullave. Pavarësisht nga kjo, drejtuesit e departamenteve raportojnë rregullisht, për të gjitha çështjet e rëndësishme, pranë administratorit përgjegjës.
- 13.2 Drejtuesit e departamenteve janë përgjegjës për organizimin e punëve në departamentet e tyre si dhe për shfrytëzimin e burimeve njerëzore nën drejtimin e tyre. Drejtuesit e departamenteve monitorojnë shfrytëzimin me kosto eficiente të burimeve njerëzore dhe materiale si dhe të drejtimit të operacioneve të përgjithshme në departamente. Drejtuesit e departamenteve informojnë anëtarët e personelit të tyre për objektivat e punës dhe për të gjitha çështjet e rëndësishme për administrimin e departamentit.
- 13.3 Drejtuesit e departamenteve miratojnë kërkesat për ndërprerje të përkohshme nga marrëdhëniet e punës brenda një dite të personelit të tyre, për arsye personale ose pune. Drejtuesit e departamenteve vendosin për ndarjen e punëve në njësitë dhe strukturat që drejtojnë.
- 13.4 Drejtuesit e departamenteve përgjigjen për monitorimin e përdorimit efikas të vlerave financiare dhe materiale në ngarkim të strukturës që ata drejtojnë, si dhe kontrollojnë rregullisht zbatimin e parimet administrative të administrimit të punëve me kosto të ulët.

- 13.5 Në mungesë ose në pamundësi për ushtrimin e detyrave të tyre, drejtuesit e departamenteve përfaqësohen nga zëvendësdrejtuesi, sipas ndarjeve në Aneksat 1 dhe 2 të këtyre rregullave. Përveç kur janë autorizuar në mënyrë të veçantë në funksionin e zëvendësdrejtuesit, në mungesë ose në pamundësi për ushtrimin e detyrave nga zëvendësdrejtuesi i departamentit, nëpunësi më i vjetër në Bankën e Shqipërisë, në rangun vijues në atë departament, përfaqëson departamentin apo njësinë sipas ndarjes në anekset 1 dhe 2 të këtyre rregullave. Në rastin kur departamenti ka dy zëvendësdrejtues, drejtuesi lëshon autorizimin përkatës për zëvendësdrejtuesin, që përfaqëson departamentin gjatë kohës që drejtuesi mungon.

ENI 14

Grupet e punës

- 14.1 Për studimin e çështjeve specifike dhe për trajtimin e çështjeve që ndikojnë në më shumë se një departament, krijohen grupet e punës, të cilat përbëhen nga anëtarë të personelit të departamenteve të ndryshme. Grupet e punës kanë një drejtues të grupit të punës.
- 14.2 Drejtuesi dhe anëtarët e grupit të punës propozohen nga drejtuesi i departamentit dhe miratohen nga administratorët, sipas ndarjes së parashikuar në anekset 1 dhe 2 të këtyre rregullave. Me krijimin e grupit të punës përcaktohet objektivi, detyrat specifike, koha e disponueshme dhe masa e shpërblimit si dhe duhet të përcaktohet përbërja e grupit të punës. Për çështje specifike në grupin e punës mund të ftohen edhe persona të tretë, jo anëtarë të personelit të Bankës së Shqipërisë.

ENI 15

Kontrolli i veprimtarisë së brendshme

Në kryerjen e veprimtarisë së kontrollit të brendshëm, inspektorëve të departamentit të Kontrollit duhet t'i vihet në dispozicion informacioni i plotë dhe i vërtetë si dhe të gjitha dokumentet që lidhen me objektin e kontrollit. Inspektorët kanë të drejtë të inspektojnë të gjitha dokumentet e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë, që përfshihen brenda mandatit të tyre kontrollues. Inspektorit nuk i njihet e drejta të nxjerrë udhëzime.

ENI 16

Linjat e raportimit

- 16.1 Me qëllim që të organizohet në mënyrë të përshtatshme veprimtaria e Bankës së Shqipërisë, linjat e raportimit ndërtohen mbi bazën e komunikimit të shpejtë, të dokumentuar, të bashkëpunimit dhe përfshirjes së strukturave sipas planit organizativ.
- 16.2 Linjat e raportimit në Bankën e Shqipërisë ndërtohen mbi bazën e hierarkisë sipas anekseve 1 dhe 2 të këtyre rregullave, sipas parimit të delegimit të kompetencave dhe të bashkëredimit e përfshirjes së njësisë të tjera të Bankës së Shqipërisë. Linjat e raportimit në Bankën e Shqipërisë zbatohen për të gjithë korrespondencën.
- 16.3 Korrespondenca duhet të përgatitet në mënyrë të përmblodhur, të qartë, të plotë dhe e hartuar me profesionalizëm. Korrespondenca strukturohet në mënyrë të tillë që përmbajtja e kryesore të jetë qartësisht dhe e dukshme për lexuesin.
- 16.4 Linjat e raportimit dhe procesimi i postës në Bankën e Shqipërisë rregullohen me udhëzim të Guvernatorit.

NENI 17

Memorandumet me shkrim

- 17.1 Memorandum i shkruar përgatitet kur diskutohen çështje të rëndësishme dhe biseda telefonike si dhe për çështje të tjera që duhet të trajtohen në mënyrë zyrtare. Në çdo rast, mbajtja e dokumentacionit duhet të sigurojë vërtetësinë e ecurisë së çështjes.
- 17.2 Memorandumi duhet të shënojë emrin e autorit (në rast të memorandumëve të përbashkëta emrat e autorëve) si dhe çdo referencë të departamentit (eve) në krye të anës së majtë. Në anën e djathtë të fletës shënohet vendi dhe data. Poshtë vendit dhe datës, vendoset numri i telefonit të autorit dhe, mundësisht, një numër reference e dosjes si dhe numri i skedarit në kompjuter (numri i dokumentit).
- 17.3 Memorandumet adresohen dhe kalohen, në se është e duhur, nëpërmjet drejtuesit të departamentit. Memorandumi qarkullohet për komentim dhe i kthehet autorit.

NENI 18

Posta në nisje

Përveç kur kërkesat e pritësit janë të ndryshme nga rregulli i përgjithshëm, korrespondenca për nisje duhet të dërgohet në origjinal në zyrën e arshivës, e cila regjistron në ditar dokumentin në nisje, dhe konfirmon shpërndarjen duke e dërguar materialin për nisje në njesinë e postës.

NENI 19

Konfidencialiteti

Për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe bankar si dhe për konfidencialitetin e korrespondencës, personeli i Bankës së Shqipërisë zbaton rregullat përkatëse gjatë dhe pas kryerjes së detyrave.

NENI 20

Pushteti i nënshkrimit

Shkalla dhe kufijtë e përgjegjësisë së çdo anëtari të personelit të Bankës së Shqipërisë për nënshkrim, kategorizohen dhe rregullohen nga rregullat përkatëse si më poshtë:

- a) sipas strukturës dhe planit organizativ të parashikuar në anekset 1 dhe 2 të këtyre rregullave; dhe
- b) sipas autorizimeve të posaçme të Guvernatorit në përputhje me rregullat përkatëse.

NENI 21

Regjistrimi i dokumenteve

- 21.1 Korrespondenca e regjistruar vendoset në dosje dhe arkivohet në Arshivën e Bankës së Shqipërisë.
- 21.2 Në Bankën e Shqipërisë mbahet një regjistër i përgjithshëm për regjistrimin dhe gjetjen e korrespondencës.

ENI 22

Të ndryshme

- 22.1 Kjo rregullore ka fuqi mbi aktet e tjera nënligjore të cilat rregullojnë të njëjtat dispozita si ato të përcaktuara në këto rregulla.
- 22.2 Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Shkëlqim Cani

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI POPULLOR

L I G J

NR.8365, DATË 2.7.1998

PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29. 4. 1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

1. Ky ligj vendos parimet kryesore të ushtrimit të veprimtarisë bankare në Republikën e Shqipërisë, të krijimit, organizimit dhe të mbikëqyrjes së bankave, si dhe rregullon kujdestarinë dhe likuidimin e tyre.
2. Ky ligj zbatohet për të gjitha subjektet që kryejnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë degët dhe zyrat e përfaqësimit të bankave të huaja. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përjashtojë subjekte të tilla, nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, tërësisht ose pjesërisht, për shkak të natyrës, vëllimit të veprimtarisë dhe origjinës së burimeve financiare të tyre.
3. Banka e Shqipërisë, me akte nënligjore, ka të drejtë të vendosë që subjektet që kryejnë veprimtari të përshkuara në nenin 26 të këtij ligji, t'i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

NENI 2

1. Termat vijues të këtij ligji kanë këto domethënie:
 - a) "Bankë" është personi juridik që kryen veprimtari bankare sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë.
 - b) "Veprimtari bankare" është veprimtaria tregtare e pranimit dhe e grumbullimit të depozitave nga publiku dhe e përdorimit të këtyre fondeve për të dhënë kredi, paradhënie, hua ose si investim për llogari dhe në ngarkim të personit juridik që e kryen këtë veprimtari, si dhe veprimtari të tjera tregtare të përcaktuara me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë.
 - c) "Licencë" është akti administrativ i lëshuar nga Banka e Shqipërisë që autorizon të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë bankare.

- ç) “Depozita bankare” është marrëdhënia juridike për shumën monetare të vënë si depozitë në bankë me kushtet e mëposhtme:
- i) kjo shumë monetare do të ripaguhet nga banka me ose pa interes apo vlerë të çdo lloji, me ose pa afat, sipas kushteve të pranuar nga vetë depozituesi apo përfaqësuesi i tij dhe banka; dhe ii) kjo shumë monetare nuk i përket marrëdhënies të pronësisë apo shërbimeve ose mjeteve të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve.
- d) “Kredi” nënkupton marrëdhënien juridike të detyrimit për të livruar një shumë monetare në këmbim të së drejtës së ripagimit të shumës së livruar, të tepricës dhe të interesit ose komisioneve të tjera bankare mbi këto shuma, si dhe çdo shtyrje të datës së maturimit të një letre me vlerë borxhi apo të ndonjë të drejte tjetër për të paguar një shumë monetare.
- dh) “Veprimtari financiar” është çdo lloj veprimtarie që përshkruhet në nenin 26 të këtij ligji.
- e) “Pjesëmarrje në kapital” është çdo e drejtë pronësie e një subjekti mbi aksionet në kapitalin e një personi juridik ose çdo e drejtë vote e tij e bazuar mbi këto aksione.
- ë) “Pjesëmarrje influencuese” nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të së drejtës së pronësisë të një aksioneri në masën dhjetë për qind ose më shumë të kapitalit të personit juridik ose të aksioneve të tij me të drejta vote, ose në një masë të tillë që krijon mundësi të ndikojë në drejtimin a në politikat e këtij personi juridik.
- f) “Persona juridikë të lidhur” nënkupton një ose disa persona juridikë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë:
- i) kanë pjesëmarrje të pjesshme ose influencuese në kapitalin e bankës apo të personave të tjerë juridikë;
- ii) ushtrojnë kontroll mbi bankën ose persona të tjerë juridikë;
- iii) ushtrojnë ndikim në drejtimin e bankës ose të personave të tjerë juridikë.
- g) “Filial” nënkupton çdo person juridik, në të cilin një subjekt tjetër ose persona juridikë të lidhur zotërojnë më shumë se pesëdhjetë për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote, duke e lejuar këtë subjekt ose personat juridikë të lidhur të ushtrojnë kontrollin mbi të.
- gj) “Degë e bankës” është njësi organizative e bankës nën varësinë e drejtorisë qendrore të saj që kryen drejtpërsëdrejti të gjitha ose disa veprimtari financiare në emër dhe për llogari të bankës.
- h) “Angjenci bankare” është njësi organizative e bankës, nën varësinë e degës së bankës, që kryen drejtpërsëdrejti një ose disa veprimtari financiare në emër dhe për llogari të bankës.
- i) “Zyrë përfaqësimi e bankës” nënkupton njësi organizative të bankës që i bën reklamë veprimtarisë financiare; kjo zyrë nuk kryen veprimtari bankare dhe financiare.
- j) “Aksione me të drejtë vote” janë aksionet e zakonshme në kapitalin e emetuesit, si dhe çdo aksion tjetër, të cilat gëzojnë të drejtën e votës për çdo iniciativë vendimmarrëse në asamblenë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të emetuesit.
- k) “Person kontrollues” nënkupton subjektin kontrollues të bankës ose të ndonjë personi juridik, i cili:
- i) në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose duke vepruar nëpërmjet një ose më shumë personave, disponon, kontrollon ose ka plotfuqishmërinë për të votuar në masën njëzet e pesë për qind ose më shumë për çdo klasë të aksioneve votuese të bankës a të personit juridik;
- ii) kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen dhe emërimin e shumicës së administratorëve të bankës ose të personit juridik;
- iii) në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ushtron influencë kontrolluese mbi drejtimin ose politikat e bankës ose të personit juridik, kur Banka e Shqipërisë, sipas rastit, e përcakton si të tillë.
- l) “Administrator” nënkupton individin që është:
- i) anëtar i këshillit drejtues ose i komitetit të kontrollit të bankës;
- ii) me funksione drejtuese ekzekutive ose administrimi të bankës.
- ll) “Person” nënkupton individin, personin fizik, personin juridik dhe personat juridikë të lidhur.

- m) "Shpërndarje e kapitalit" nënkupton shpërndarjen e mjeteve fizike monetare ose të çdo pasurie tjetër nga banka aksionerëve të saj për pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e bankës. Nuk përfshihen dividendët që përfitohen për llogari të aksioneve të aksionerëve ose të drejtat për të blerë aksione të tilla.
 - n) "Kapital rregullator" nënkupton kategoritë e ndryshme të kapitalit dhe të rezervave, të cilat përcaktohen kohë pas kohe nga Banka e Shqipërisë për qëllimin e llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës.
2. Titujt e kërret në këtë ligj janë përdorur vetëm për orientim e referim dhe nuk kanë për qëllim të shpjegojnë, të kufizojnë a të ndihmojnë në kompozimin e ndonjë përcaktimi ose dispozite.
 3. Në këtë ligj, fjalët në njëjës mund të interpretohen si shumës dhe e kundërta, kurdoherë që ndryshimi është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e kuptueshëm të dispozitës në diskutim.
 4. Përemrat mashkullorë nënkuptojnë edhe përemrat femërorë.

ENI 3

Sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë organizohet në dy nivele. Në nivelin e parë bën pjesë Banka e Shqipërisë, statusi i së cilës caktohet me ligj të veçantë. Në nivelin e dytë bëjnë pjesë bankat e tjera.

ENI 4

1. Veprimtaria bankare ushtrohet vetëm nga:
 - a) bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë;
 - b) subjektet e përshkruara në nenin 1, paragrafi 3 i këtij ligji, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
 - c) degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë.
2. Banka themelohet si shoqëri tregtare anonime, publike ose private, me kapital tërësisht shqiptar, tërësisht të huaj ose me kapital të përbashkët. Banka mund të themelohet si bankë kooperativë, sipas dispozitave të nenit 64 të këtij ligji.

ENI 5

1. Banka ka të drejtë të hapë degë, agjenci ose zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me miratim të Bankës së Shqipërisë.
2. Banka ka të drejtë të hapë filiale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me miratim të Bankës së Shqipërisë.
3. Banka ka të drejtë të zgjerojë ose të pakësojë numrin e degëve, të agjencive a zyrave të përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë njoftohet paraprakisht Banka e Shqipërisë, e cila ka të drejtë të kundërshtojë zgjerimin e numrit të degëve të bankës, në rast se ky zgjerim kërcënon pozitën organizative, financiare dhe mbikëqyrjen e bankës.

ENI 6

1.
 - a) Asnjë person nuk lejohet të ushtrojë veprimtari bankare pa licencë të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.
 - b) Asnjë person tjetër, pa miratimin me shkrim të Bankës së Shqipërisë dhe sipas kushteve të kërkuara prej saj, nuk ka të drejtë të ushtrojë në Shqipëri veprimtari tregtare të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave, me përjashtim të rastit kur është bankë e licencuar. Kur Banka e Shqipërisë nga rrethanat e faktit konkludon se një person është duke ushtruar veprimtari tregtare të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave pa miratimin e saj, i kërkon informacion personit, si dhe njofton Këshillin e Ministrave.
 - c) Asnjë person nuk do të kryejë në Shqipëri veprimtari financiare të rregulluara nga ligji nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", ndryshuar me ligjin nr.8227, datë 30.7.1997, pa

autorizimin me shkrim të Këshillit të Ministrave. Nëse Banka e Shqipërisë ka arsye të besojë se një person po kryen veprimtari të tilla pa autorizimin e Këshillit të Ministrave, ajo i kërkon informacion personit, si dhe njofton Këshillin e Ministrave.

- ç) Banka e Shqipërisë informon çdo gjashtë muaj në Kuvendin Popullor dhe në Këshillin e Ministrave:
- i) nëse kërcënohet stabiliteti i sistemit financiar;
 - ii) për llojin e kërcënimit, duke përfshirë rishfaqjen e operacioneve të tipit të skemave piramidale, përkufizuar në nenin 7.1 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", ndryshuar me ligjin nr.8227, datë 30.7.1997;
 - iii) nëse legjislacioni në fuqi është i mjaftueshëm për shmangien e kërcënimit të sistemit financiar dhe për parandalimin e rishfaqjes së operacioneve të tilla të tipit të skemave piramidale dhe, nëse jo;
 - iv) çfarë legjislacioni tjetër, akte ligjore ose nënligjore kërkohen për të rregulluar gjendjen.
- d) Banka e Shqipërisë publikon informacionin e parashikuar në paragrafin (ç) të pikës 1 të këtij neni, të paktën në një gazetë kryesore në Shqipëri.
2. Asnjë subjekt i përmendur në nenin 1(3) të këtij ligji nuk lejohet të ushtrojë veprimtari të përshtatura në nenin 26 të këtij ligji pa disponuar licencë të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.
 3. Asnjë subjekt nuk do të përdorë fjalën "bankë" ose derivate të fjalës "bankë" në ushtrimin e veprimtarisë tregtare, prodhuese a të shërbimit, pa licencë të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj ose në marrëveshjet ndërkombëtare, ose kur bëhet e qartë nga përmbajtja se fjala "bankë" nuk ka lidhje me veprimtari bankare.
 4. Asnjë bankë e organizuar jashtë Republikës së Shqipërisë nuk lejohet të ushtrojë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur kjo veprimtari lejohet të ushtrohet nga një degë e saj e licencuar nga Banka e Shqipërisë.
 5. Asnjë subjekt nuk duhet të keqinterpretojë faktet materiale a të përfaqësojë veprimet me qëllim mashtrimi, të mashtrjë ose të ushtrojë praktika dhe veprime manipuluese në lidhje me veprimtarinë bankare.
 6. Të gjitha subjektet e licencuara duhet të përdorin gjuhën shqipe për emrat e tyre, për dokumentacionin dhe për korrespondencën që zhvillojnë në Republikën e Shqipërisë.

KREU II

LICENCIMI

NENI 7

Banka e Shqipërisë është i vetmi autoritet për licencimin e bankave për të ushtruar veprimtari bankare.

NENI 8

1. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor shumën e kapitalit fillestar minimal të bankave dhe ndryshimin e kësaj shume nga njëra periudhë në tjetrën.
2. Shuma e kapitalit fillestar minimal të paguar do të jetë një tregues, që do të përcaktojë veprimtarinë bankare dhe financiare, që banka e licencuar do të lejohet të kryejë në zbatim të nenit 26 të këtij ligji.

NENI 9

1. Kërkesa për licencimin e bankës bëhet me shkrim dhe paraqitet në Bankën e Shqipërisë në formën e përcaktuar në aktin nënligjor të saj, duke u shoqëruar me :
 - a) informacion për kualifikimin, reputacionin dhe përvojën e administratorëve të bankës së propozuar, me të dhëna për veprimtarinë tregtare ose profesionale të tyre për shtatë vjetët e fundit, me emrat e personave rekomandues, me të cilët Banka e Shqipërisë do të kontaktojë, si dhe me një deklaratë që asnjë nga faktorët skualifikues të nenit 21 të këtij ligji nuk vërtetohet tek administratorët e ardhshëm;
 - b) shumën e kapitalit aksioner të nënshkruar të bankës;
 - c) informacion për planin e veprimtarisë tregtare për tre vjetët e parë të veprimtarisë së bankës së propozuar që përshkruan, ndër të tjera, strukturën organizative, llojet e veprimtarive financiare të parashikuara për t'u kryer, deklaratat financiare të parashikuara, si dhe parimet, në bazë të të cilave ato janë përgatitur;
 - ç) informacion për emrin, vendqëndrimin ose selinë dhe të dhëna për veprimtarinë tregtare ose profesionale për shtatë vjetët e fundit të çdo personi që propozon të zotërojë pjesëmarrjen influencuese të bankës së propozuar, si dhe shumën e propozuar. Për qëllimin e kësaj dispozite, pjesëmarrja e propozuar nga personat juridikë të lidhur në këtë pronë, do të mblidhet për të përcaktuar shumën e pronësisë së propozuar për disponim;
 - d) dokumentacion dhe informacion shtesë, si vijon:
 - i) projektaktin e themelimit dhe projektstatutin e bankës,
 - ii) emrin e propozuar të bankës,
 - iii) vendndodhjen e selisë së bankës,
 - iv) burimin e kontributeve në kapital,
 - v) vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatimtaksave nga aksionerët;
 - dh) informacion shtesë për licencimin, që do të përcaktohet në aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë.
2. Nëse një bankë e huaj propozon të zotërojë më shumë se dhjetë për qind të kapitalit të nënshkruar të një banke, banka e huaj duhet të jetë e autorizuar nga autoritetet përkatëse të kryejë veprime të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave në para ose fonde të tjera të ripagueshme në vendin e huaj, ku drejtorja e saj qendrore ka selinë. Autoritetet e huaja përkatëse që mbikëqyrin veprimtarinë financiare të drejtorisë qendrore të bankës së huaj, japin pëlqimin e tyre me shkrim për marrjen e kësaj licence.

3. Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'i kërkojë kërkuarit të licencës të paraqesë informacion plotësues, nëse sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë informacioni bazë i paraqitur nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm për të dhënë licencën.
4. Kërkesa për licencimin e degës së një banke të huaj bëhet nga banka e huaj. Kjo kërkesë shoqërohet me informacion dhe dokumentacion të njëjtë me atë të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe me dokumentacion shtesë për bankën e huaj si vijon:
 - a) Leja e ushtrimit të veprimtarisë bankare të dhënë nga autoritetet përkatëse në vendin ku ndodhet selia e saj.
 - b) Akti i themelimit dhe statuti i bankës, duke përfshirë të dhënat për adresën e saktë të selisë, përshkrimi i veprimtarisë, shuma e kapitalit, forma e drejtimit të bankës dhe administratorët e saj.
 - c) Llogaritë dhe raporti vjetor, llogaritë dhe raporti vjetor i konsoliduar, si dhe opinionin i ekspertit kontabël të autorizuar për kontrollin e llogarive vjetore dhe të llogarive të konsoliduara gjatë tre vjetëve të fundit.
 - ç) Pëlqimi për hapjen e degës së bankës së huaj, i dhënë nga autoritetet përkatëse të licencimit dhe të mbikëqyrjes.
 - d) Shuma e dhuruar e kapitalit fillestar, e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Në kuptim të këtij paragrafi, disa degë të së njëjtës banke të huaj do të konsiderohen si një bankë e vetme. Dega e bankës së huaj zgjedh dhe emëron të paktën dy administratorë rezidentë për drejtimin e degës së bankës së huaj.
5. Kërkesa për miratimin e zyrës së përfaqësimit të një banke të huaj bëhet nga banka e huaj. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 shkronjat a, b, c, ç dhe d të këtij neni.

ENI 10

1. Banka e Shqipërisë, brenda tre muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, jep ose refuzon miratimin paraprak për licencë dhe njofton me shkrim kërkuarin për vendimin e saj. Në kuptimin e këtij paragrafi, datë e pranimit të kërkesës për licencë është data kur kërkuari ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas aktit nënligjor të Bankës së Shqipërisë.
2. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak të licencës vetëm kur krijon bindjen se:
 - i) banka u përmbahet dispozitave të këtij ligji;
 - ii) kualifikimet, përvoja e reputacioni i administratorëve të bankës dhe i aksionerëve të saj me pjesëmarrje influencuese janë të përshtatshme për planin e veprimtarive bankare dhe financiare për të cilat banka licencohet;
 - iii) gjendja e pritshme financiare e bankës së propozuar është e kënaqshme;
 - iv) themeluesit e bankës janë jo më pak se tre ortakë, me përjashtim të rastit të hapjes së degës të një banke të huaj;
 - v) banka e huaj që kërkon licencë për hapje dege banke është e mbikëqyrur në mënyrë të mjaftueshme dhe në baza të qëndrueshme nga autoritete të huaja përkatëse mbikëqyrëse;
 - vi) kapitali fillestar aksioner nuk përbëhet nga hua, kredi, paradhënie nga subjekte të treta;
 - vii) banka ka jo më pak se dy drejtorë ekzekutivë.
3. Banka e Shqipërisë kur vendos për refuzimin e miratimit paraprak të licencës, shpjegon arsyet, të cilat mund të përmbliidhen në atë që informacioni i parashtruar nga kërkuari është, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, i pamjaftueshëm për të vendosur nëse kërkuari plotëson kriteret e paragrafit 2 të këtij neni.
4. Në vendimin e miratimit paraprak të licencës, Banka e Shqipërisë përcakton kushtet që duhet të plotësojë banka për të marrë licencën e për të filluar veprimtarinë e saj.
 - a) Ndër kushtet kryesore për marrjen e licencës janë:
 - i) pagesa e kapitalit fillestar nga aksionerët e bankës/transferimi efektiv i kapitalit të dhuruar i degës së bankës së huaj;
 - ii) marrja në punë e administratorëve të bankës;

- iii) blerja ose marrja me qira e lokaleve të bankës dhe e pajisjeve të punës;
 - iv) emërimi i ekspertit kontabël të autorizuar në përputhje me nenin 39 të këtij ligji.
 - b) Banka e Shqipërisë jep licencën për të filluar veprimtarinë bankare, në rast se plotësohen kushtet e këtij neni. Ajo ka të drejtë të përcaktojë kërkesa dhe kushte të arsyetuara shtesë për marrjen e licencës.
 - c) Banka e Shqipërisë shfuqizon miratimin paraprak të licencës, në rast se banka brenda një viti nga marrja e këtij miratimi nuk i plotëson kushtet për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë së saj. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të zgjatë afatin njëvjeçar të vlefshmërisë së miratimit paraprak të licencës, jo më shumë se gjashtë muaj nga çasti i përfundimit të afatit.
5. Degës së bankës së huaj të licencuar nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarisë bankare që nuk kryhet nga banka mëmë.

NENI 11

1. Licencimi jepet i pakufizuar në kohë dhe nuk është i transferueshëm.
2. Kur banka beson se kapitali i saj ka arritur shumën që mundëson kryerjen e veprimtarive financiare shtesë sipas nenit 26 të këtij ligji, ka të drejtë t'i kërkojë Bankës së Shqipërisë të l ejojë të kryejë veprimtari të tilla shtesë. Nëse sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë banka kërkuese ka plotësuar kushtet e nenit 26 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë autorizon bankën për të ushtruar veprimtaritë financiare shtesë. Në të kundërtën, Banka e Shqipërisë nuk do ta miratojë këtë kërkesë, duke shpjeguar me shkrim arsyet e këtij refuzimi.
3. Pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë, banka nuk mund:
 - a) të ndryshojë emrin;
 - b) të përfundojë marrëveshjen e binjakëzimit për administrimin dhe drejtimin e bankës;
 - c) të kryejë veprimtari financiare jashtë licencës së dhënë;
 - ç) të zmadhojë kapitalin me mjete jolikuide;
 - d) të riblejë aksionet e saj ose të personave të lidhur me të;
 - dh) të zvogëlojë kapitalin;
 - e) të emërojë një ose disa administratorë;
 - ë) të bashkojë, të ndajë, të shkrijë ose të shesë aktivet e bankës;
 - f) të kryejë veprimtaritë e parashikuara në nenin 33 të këtij ligji.

A fatet për dhënien apo refuzimin e miratimit paraprak të veprimeve sipas pikës 3 të këtij neni përcaktohen në rregulloren e Bankës së Shqipërisë.
4. Banka e Shqipërisë vendos komision për:
 - a) përpunimin e kërkesës për licencë;
 - b) dhënien e licencës.

Këto komisione nuk rimbursohen.

NENI 12

1. Banka e Shqipërisë mban një regjistër për konsultim nga publiku, ku për secilën bankë të licencuar regjistrohen emri, adresat e selisë dhe të degëve, duke përfshirë emrat dhe adresat e administratorëve dhe aksionerëve me pjesëmarrje influencuese, si dhe kopjet aktuale të dokumenteve të renditura në nenin 18 të këtij ligji.
2. Një kopje e këtij regjistri mbahet për konsultim publik në çdo përfaqësi rajonale të Bankës së Shqipërisë.
3. Dokumentet që kanë të bëjnë me ish-bankat, licencat e të cilave janë revokuar, hiqen nga regjistri. Një listë e këtyre bankave mbahet në regjistër, duke cilësuar se licencat e tyre janë të revokuara.
4. Banka e Shqipërisë publikon dhënien e licencës në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në një a më shumë nga gazetatat kryesore me tirazh më të madh.

NENI 13

1. Licenca e bankës revokohet vetëm me vendim të Bankës së Shqipërisë kur :
 - i) kërkohet nga vetë banka e licencuar;
 - ii) ka shkelje të nenit 44, pika 2 të këtij ligji.
2. Për një a më shumë arsye të mëposhtme licenca e bankës revokohet me vendim të Bankës së Shqipërisë edhe kur:
 - a) licenca është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë, pavarësisht se është dhënë nga kërkuesi apo ka të bëjë me kërkuesin, duke përfshirë të dhënat për kualifikimet, përvojën ose reputacionin e administratorëve dhe të aksionerëve me pjesëmarrje influencuese të propozuar ose parregullsi të tjera materiale të shkaktuara në lidhje me kërkesën për licencë;
 - b) banka nuk ka filluar veprimtarinë brenda afatit të parashikuar sipas nenit 10, pika 4, shkronja "c" të këtij ligji ose ka ndërprerë për më shumë se 6 muaj veprimtarinë tregtare të pranimit dhe grumbullimit të depozitave bankare;
 - c) një banke tjetër, që zotëron një pjesëmarrje influencuese në kapitalin e bankës, i është revokuar licenca;
 - ç) ka ndodhur një bashkim, ndarje, shkrirje ose shitje e pjesës së konsiderueshme apo e gjithë aktiveve të bankës;
 - d) pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë, zotëruesi i pjesës influencuese të kapitalit në bankë ka transferuar ose ka humbur këtë të drejtë ose një person tjetër bëhet zotërues i një pjesëmarrjeje influencuese në bankë;
 - dh) aksionerët e bankës kanë vendosur të shpërndajnë a të likuidojnë bankën ose banka ka pushuar së ekzistuari si subjekt juridik;
 - e) veprimtaritë e bankës gjatë tre vjetëve të parë të veprimtarisë ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato të paraqitura në kërkesën për miratim paraprak të licencës dhe, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, një shmangie e tillë nuk përligjet nga ndryshimet në rrethanat ekonomike.
2. Banka e Shqipërisë vendos revokimin e licencës së bankës brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës me shkrim nga banka.
3. Banka e Shqipërisë revokon licencën e dhënë një ose më shumë degëve të bankës së huaj edhe nëse banka mëmë nuk ka ose ka humbur autoritetin për të kryer veprimtarinë tregtare të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave në para apo të fondeve të tjera të ripagueshme, në vendin e huaj ku banka ka selinë.
4. Vendimi i Bankës së Shqipërisë për revokimin e licencës i komunikohet menjëherë me shkrim bankës ose degës përkatëse, duke parashtruar edhe arsyet e revokimit.

NENI 14

1. Vendimi i Bankës së Shqipërisë për revokimin e licencës publikohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në një a më shumë nga gazetatat kryesore me tirazh më të madh. Vendimi i revokimit të licencës hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
2. Me hyrjen në fuqi të vendimit të revokimit të licencës, banka ndalohet të angazhohet në veprimtari bankare e financiare dhe detyrohet të likujdojë, sa më parë që të jetë e mundur, aktivet e saj, të zgjidhë marrëdhëniet kontraktore mbi depozitat pa afat dhe të shlyejë detyrimet e saj. Gjatë kësaj kohe banka vazhdon të jetë subjekt i dispozitave të këtij ligji, njësoj sikur të ishte e licencuar.

KREU III

ADMINISTRIMI DHE DREJTIMI

NENI 15

1. Banka organizohet si shoqëri tregtare anonime sipas ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë ligj. Banka organizohet edhe si degë e bankës së huaj ose si bankë kooperativë, sipas nenit 64 të këtij ligji.
2. Banka e organizuar si shoqëri anonime themelohet nga të paktën tre ortakë. Ortakët mund të jenë individë, persona fizikë ose juridikë.
3. Banka, në organizimin e saj si shoqëri tregtare anonime, nuk ka këshill mbikëqyrës. Neni 96, fjalia e parë e nenit 97 dhe nëndarja II e pjesës IV të ligjit nr. 7638, datë 19. 11. 1992 "Për shoqëritë tregtare" nuk zbatohet për bankat.
4. Në nenin 98 të ligjit "Për shoqëritë tregtare" termi "këshilli mbikëqyrës" zëvendësohet me termin "asamble e aksionerëve". Në nenin 136, paragrafi i parë i pikës katër, termi "këshilli mbikëqyrës" zëvendësohet me termin "këshill drejtues" dhe çdo përgjegjësi tjetër e këtij këshilli sipas ligjit "Për shoqëritë tregtare" është përgjegjësi e këshillit drejtues.

NENI 16

Banka gëzon pavarësi ligjore, operacionale, financiare dhe administrative nga çdo subjekt tjetër, duke përfshirë Bankën e Shqipërisë dhe çdo strukturë legjislativë ose ekzekutive, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj. Kjo pavarësi do të respektohet dhe asnjë subjekt nuk do të kërkojë të ndikojë tek administratori i ndonjë banke për kryerjen e detyrave të tij ose të ndërhyjë në veprimtaritë e ndonjë banke, përveç rasteve të ekzekutimit të urdhrit të organeve gjyqësore ose të një detyre të dhënë me ligj.

NENI 17

1. Banka drejtohet nga këshilli drejtues si organ përgjegjës, vendimor dhe mbikëqyrës. Banka ka një komitet kontrolli.
2. Kompetencat e këshillit drejtues dhe të komitetit të kontrollit përcaktohen në statut. Statuti i bankës dhe çdo ndryshim i tij miratohen nga asambleja e aksionerëve. Banka njofton Bankën e Shqipërisë për ndryshimet në statut.

NENI 18

Banka drejtohet e udhëhiqet nga aktet e brendshme të miratuara nga këshilli drejtues, akte që janë në përputhje me statutin e saj dhe përcaktojnë:

- a) strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të bankës, duke përfshirë njësitë e saj funksionale dhe administrative, funksionet e tyre, pozicionet mbikëqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese;
- b) detyrat e çdo drejtori dhe të njësive që ai drejton e mbikëqyr;
- c) funksionet e komitetit të kontrollit dhe të komiteteve të tjera të brendshme të përhershme;
- d) kufijtë e kompetencave të administratorëve dhe të punonjësve të tjerë të bankës që do të kryejnë veprimtari financiare në emër dhe për llogari të bankës.

NENI 19

1. Këshilli drejtues i bankës është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave, si dhe për mbikëqyrjen e veprimtarisë së bankës.

2. Këshilli drejtues i bankës përbëhet nga një numër tek anëtarësh, jo më pak se pesë. Anëtarët e këshillit caktohen nga asambleja e aksionerëve të bankës për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen për periudha vijuese.
3. Asambleja e aksionerëve të bankës vendos dhënie shpërblimi për anëtarët e këshillit drejtues.

ENI 20

1. Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga asambleja e aksionerëve dhe ka këto detyra:
 - a) kontrollon dhe mbikëqyr procedurat kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, si dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre procedurave dhe kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse.
 - b) kontrollon zbatimin e rregulloreve e të akteve të tjera dhe i raporton këshillit drejtues të bankës.
 - c) jep mendime për të gjitha problemet që i kërkohen nga këshilli drejtues i bankës.
2. Komiteti i kontrollit mbledhet jo më pak se tre herë në vit në mbledhje të zakonshme dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga këshilli drejtues i bankës. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Abstenime nuk lejohen.
3. Komiteti i kontrollit, me kërkesën e tij, ndihmohet nga ekspertë që emërohen nga këshilli drejtues i bankës.
4. Asambleja e aksionerëve të bankës vendos dhënie shpërblimi për anëtarët e komitetit të kontrollit.

ENI 21

1. Gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si administratorë të bankës duhet të kenë reputacion të mirë, diplomë universitare, si rregull, për ekonomi ose jurisprudencë dhe të përmbushin kriteret e vëna në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, lidhur me kualifikimet, me përvojën në fushën bankare e financiare, si dhe me përvojën në drejtim.
2. Një person nuk është i përshtatshëm për t'u bërë anëtar i këshillit drejtues të një banke ose lirohet nga anëtarësia në këshillin drejtues të bankës me vendim të mbledhjes së asamblesë së aksionerëve, në rastet kur :
 - a) është anëtar i këshillit drejtues të një banke tjetër në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur kjo banke është person juridik i lidhur me të;
 - b) me ligj i është hequr e drejta të jetë në këshillin mbikëqyrës ose në drejtorinë e një shoqërie tregtare të organizuar sipas ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare";
 - c) shërben ose ka shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës dymbëdhjetëmujore paraardhëse si administrator i një banke, e cila ka qenë subjekt i procedurave të kujdestarisë dhe/ose të likuidimit sipas dispozitave të këtij ligji;
 - ç) ka shërbyer me çdo lloj autoriteti ose ka ndihmuar në themelimin e veprimtarive të paautorizuara tregtare të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave apo të një "subjekt të kontrollit", sipas ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave j uridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", ndryshuar me ligjin nr.8227, datë 30.7.1997;
 - d) shërben ose ka shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës dymbëdhjetëmujore paraardhëse në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;
 - dh) është shpallur fajtor nga gjykata për një vepër që ka të bëjë me figurën morale;
 - e) ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese të detyrimeve dhe nuk është çliruar ende nga pagesat e detyrimeve të shkuara.
3. Këshilli drejtues i bankës ka të drejtë t'i delegojë detyrat e tij te persona të tjerë, por mban përgjegjësi për vendimet e tyre.

NENI 22

Bashkimi, shkrirja, ndarja dhe shitja në një masë të konsiderueshme e aktiveve të bankës hyn në fuqi pas miratimit nga Banka e Shqipërisë. Vendimi bazohet në kriteret e parashikuara në nenin 9 të këtij ligji, sikur ky vendim t'i përkiste dhënies së licencës. Për rastet e shkrirjes miratimi jepet vetëm nëse banka e porsakrijuar ka marrë licencën. Nuk autorizohen bashkimet dhe shkrirjet që nuk përputhen me dispozitat e nenit 26 të këtij ligji.

NENI 23

1. Për çdo informacion, që marrin gjatë ushtrimit të veprimtarisë në bankë, administratorët, nëpunësit dhe agjentët aktualë e të mëparshëm të bankës, administratorët, agjentët, nëpunësit e çdo sistemi informacioni apo shërbimi zyrtar të parashikuar në nenin 23 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", autoritetet gjyqësore dhe personat e tjerë që ngarkohen për kontrollin e veprimtarisë bankare, ruajnë sekretin dhe nuk e përdorin atë për përfitime vetjake ose për të tretët jashtë bankës, të cilëve u shërbejnë ose u kanë shërbyer.
2. Informacioni i përshkruar në pikën 1 të këtij neni mund t'i jepet vetëm Bankës së Shqipërisë, ekspertit kontabël të autorizuar të bankës, administratorëve, agjentëve, nëpunësve të çdo sistemi informacioni a shërbimi zyrtar të parashikuar në nenin 23 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", autoriteteve juridike që e fitojnë këtë të drejtë me ligj, si dhe kur e kërkon mbrojtja e interesave të bankës në procedurat ligjore.
3. Banka përgatit procedura e rregulla të përshtatshme, në mënyrë që ajo, administratorët dhe nëpunësit e bankës të mos vihen në një situatë ku detyrat e tyre kundrejt një klienti bien në kundërshtim me detyrën e tyre ndaj një tjetri ose kur vetë interesat e tyre bien në konflikt me detyrën ndaj klientit.

NENI 24

1. Banka ndalohet të fshehë, të konvertojë ose të transferojë para a pasuri tjetër, kur ajo ka dijeni se një pasuri e tillë buron nga një veprimtari kriminale, se ka për qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurisë ose ka për qëllim të ndihmojë ndonjë person që angazhohet në një veprimtari të tillë për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimit të tij.
2. Banka nuk duhet të zbulojë që informacioni është përcjellë tek autoritetet përgjegjëse për luftën kundër pastrimit të parave ose është kërkuar prej tyre, ose që procedurat e hetimit kanë filluar, ose që udhëzimet për mosekzekutimin e operacionit janë dhënë, me përjashtim të rastit kur të dhëna të tilla kërkojnë nga organet gjyqësore.
3. Të pasurit dijeni, për sa përshkruhet në pikën 1 të këtij neni, konkludohet nga rrethanat objektive të faktit.
4. Banka, edhe kur ka dyshime të bazuara, pavarësisht nga neni 23 i këtij ligji, me nismën e saj informon autoritetet që janë përgjegjëse për luftën kundër pastrimit të parave, me të dhëna për pasurinë ose për prejardhjen e saj, që buron nga veprimtari kriminale, dhe jep me kërkesën e autoriteteve çdo informacion shtesë përkatës, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislati në fuqi.
5. Banka mban përgjegjësi vetëm për identifikimin e plotë e të saktë të klientit. Ajo duhet të ketë njohuri të mjaftueshme për klientët dhe për vëllimin e transaksioneve të tyre. Në zbatimin e dispozitave të këtij neni, banka përjashtohet nga çdo lloj përgjegjësie kur jep informacionin me mirëbesim dhe/ose për shkeljen e ndonjë kufizimi për zbulimin e informacionit, pavarësisht nga pasojat e transmetimit të informacionit të dhënë me mirëbesim.
6. Në kuptim të kësaj dispozite, banka përfshin administratorët dhe nëpunësit e bankës dhe subjektet e licencuara për të ushtruar veprimtarinë bankare sipas nenit 4 të këtij ligji.

NENI 25

1. Administratori i deklaron me shkrim bankës natyrën dhe shkallën e interesit material dhe të marrëdhënieve me përfitim material kur:

- a) është palë në një kontratë të propozuar ose të përfunduar me bankën;
 - b) ka përfitim material ose marrëdhënie me përfitim material me çdo person, i cili është palë në një kontratë të përfunduar ose të propozuar me bankën.
2. Deklarimi i kërkuar në pikën 1 të këtij neni bëhet nga administratori, kur ai është në dijeni se kontrata e përfunduar ose e propozuar cilësohet me përfitim material ose nga rrethanat e faktit duhet të cilësohet si e tillë nga administratori.
3. Deklarimi nga administratori i interesave materiale dhe i marrëdhënieve me përfitim material i njoftohet me shkrim këshillit drejtues të bankës herë pas here, por jo më rrallë se një herë në vit. Deklarimi përmban:
- a) emrin, adresën e administratorit dhe detaje të plota e të arsyeshme për çdo veprimtari me objekt përfitimi material, që ky person ka gjatë kësaj periudhe;
 - b) interesat materiale në çdo kontratë të përfunduar ndërmjet bankës dhe çdo personi të përmendur në deklaram.
4. Administratori që ka interes material ose marrëdhënie me përfitim material sipas paragrafëve 1 ose 3 të këtij neni, nuk merr pjesë në mbledhje të këshillit drejtues të bankës gjatë diskutimit të kontratës dhe nuk ka të drejtë vote për çdo çështje që ka lidhje me këtë dhe që është objekt vendimi nga këshilli drejtues i bankës. Një interes i tillë me përfitim material, nëse deklarohet, nuk e skualifikon personin në fjalë për sa i përket *quorumit* të domosdoshëm.
5. Një interes do të quhet material, kur ai buron nga pasuria, nga veprimtaria tregtare ose nga lidhja familjare (këtu përfshihet çdo person që është i lidhur nga marrëdhëniet bashkëshortore ose ato të gjakut deri në shkallën e dytë) e personit që e disponon atë. Një person konsiderohet se ka interes material, kur ai:
- a) disponon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi një pjesëmarrje influencuese në një shoqëri tregtare apo është administrator i saj;
 - b) është ortak në një shoqëri tregtare të çdo forme tjetër.
6. Kur një administrator nuk deklaron konfliktet e interesave materiale sipas këtij neni, merren këto masa:
- a) gjykata e juridiksionit përkatës, me kërkesë të bankës, të një aksioneri ose të Bankës së Shqipërisë, ka të drejtë të deklarojë pavlefshmërinë e kontratës.
 - b) Banka e Shqipërisë ka të drejtë të pezullojë administratorin për një periudhë deri në një vit;
 - c) Banka e Shqipërisë i kërkon bankës largimin përgjithmonë të administratorit.
7. Pavarësisht nga detyrimet e marrëdhënieve të besimit ndaj bankave, sipas nenit 23 të këtij ligji, administratorët e bankave detyrohen të respektojnë marrëdhëniet e besimit ndaj bankës dhe klientëve të cilëve ata i shërbejnë, për të vënë interesat e bankës dhe të klientëve të saj mbi interesat e veta.

KREU IV

VEPRIMTARITË E LEJUESHME PER BANKAT

NENI 26

1. Bankat licencohen të kryejnë veprimtaritë bankare dhe financiare të përshkruara në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni, në këto kushte:
 - a) bankat, që fillojnë veprimtarinë me kapital nga kapitali minimum i paguar për marrjen e licencës deri në dyfishimin e këtij minimumi, si dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, kanë të drejtë të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.
 - b) bankat, që fillojnë veprimtarinë me kapital nga dyfishi deri në trefishin e kapitalit minimum të paguar, si dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, kanë të drejtë të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni;
 - c) bankat, që fillojnë veprimtarinë me kapital më të madh se trefishi i kapitalit minimum të paguar, si dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, kanë të drejtë të kryejnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni.
 - ç) mbi bazën e kapitalit të dhuruar e të paguar nga banka e huaj, si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, dega e bankës së huaj ka të drejtë të kryejë veprimtaritë financiare të përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni.
2. Asnjë bankë nuk lejohet të kryejë veprimtari financiare jashtë atyre të lejuara shprehimisht në licencën e saj.
3. Në përputhje me licencën e marrë, banka ka të drejtë:
 - a) të pranojë dhe të grumbullojë depozita bankare;
 - b) të japë kredi;
 - c) të marrë hua mjete financiare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve:
 - i) instrumente të tregut të parave;
 - ii) letrat me vlerë të borxhit;
 - iii) kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option), që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit; ose
 - iv) instrumentet e normës së interesit;
 - ç) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
 - d) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
 - dh) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
 - e) të ushtrojë qiranë financiare;
 - ë) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
 - f) të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
 - g) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikën 3/a dhe 3/b të këtij neni);
 - gj) të ushtrojë veprimtari të tjera bankare dhe financiare të përcaktuara me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë.
4. Në përputhje me licencën e marrë, banka ka të drejtë të bëjë edhe këmbimin e valutave, duke përfshirë edhe kontratat e së ardhmes (futures) për këmbime valutore.
5. Në përputhje me licencën e marrë banka ushtron edhe:
 - a) shërbime besimi (trust), përfshirë, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
 - b) shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;
 - c) shërbime për nënshkrimin dhe për shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe për tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klientëve, sipas kufizimeve të parashikuara në nenin 33 të këtij ligji.

ENI 27

1. Banka ushtron veprimtarinë e saj administrative dhe operacionale në përputhje me procedurat korrekte administrative dhe kontabël, në bazë të kërkesave të legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Banka mban kapital dhe burime likuide të mjaftueshme, si dhe në raport me natyrën e veprimtarisë së saj tregtare siguron shpërndarjen e aktiveve me qëllim shmangien e rrezikut të humbjeve.

ENI 28

1. Banka, për çdo transaksion kredie, detyrohet të mbajë të paktën dokumentet vijuese:
 - a) Kërkesën për kredi, dokumentet që tregojnë përdorimin e saj dhe statusin ligjor.
 - b) Përshkrimin e çdo kolaterali të cilin kredidhënësi e mban si mjet për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit që do të paguhet si pjesë e borxhit dhe një vlerësim të vlerës së tij.
 - c) Deklaratën e plotë financiare të kredimarrësit dhe të çdo garantuesi të borxhit të kredimarrësit.
 - ç) Marrëveshjen e kredisë, përfshirë shumën monetare kryesore (kryegjënë), përqindjen e interesit, planin e shlyerjes dhe objektin e kredisë ose të qëllimit të marrjes së kredisë.
 - d) Vendimin që miraton transaksionin e kredisë të nënshkruar nga personat përgjegjës ose një kopje e protokollit të mbledhjes, kur vendimi merret nga këshilli drejtues i bankës.
 - dh) Nënshkrimin e çdo personi që është i autorizuar për dhënien e kredisë në emër të kredidhënësit.
2. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë dokumente e procedura plotësuese tej kushteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

ENI 29

1. Banka përgatit dhe mban në drejtorinë qendrore të saj dokumentacionin vijues:
 - a) Statutin dhe rregulloret e brendshme me të gjitha amendamentet e tyre.
 - b) Regjistrin e aksionerëve të saj, duke përfshirë edhe numrin e aksioneve të regjistruara në emër të çdo aksioneri.
 - c) Protokollin e mbledhjeve dhe vendimet e këshillit drejtues.
 - ç) Protokollin e asamblesë dhe vendimet e aksionerëve.
 - d) Politikat dhe procedurat për njohjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e rreziqeve të tregut e të rreziqeve të tjera të mundshme, si dhe për politikën përkatëse për rezervat, në zbatim të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë.
 - dh) Dokumentacionin kontabël që pasqyron qartë e në mënyrë korrekte gjendjen e veprimtarisë të saj tregtare, duke shpjeguar transaksionet dhe pozicionin financiar, në mënyrë që t'i krijojë Bankës së Shqipërisë mundësitë për të përcaktuar nëse subjekti vepron në përputhje me të gjitha dispozitat e këtij ligji.
 - e) Çdo dokument tjetër që parashikohet si i domosdoshëm nga ky ligj ose nga aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

ENI 30

1. Banka disponon kapitalin rregullator të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
2. Banka detyrohet të respektojë normat e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë:
 - a) për raportet dhe ekspozimet maksimale që duhet të mbahen për aktivet me ose pa rrezik dhe zërat jashtë bilancit të bankës në lidhje me kategoritë e ndryshme të kapitalit rregullator;
 - b) për shumën totale maksimale të kredisë të shprehur në përqindje ndaj kapitalit rregullator, për të cilën banka lejohet të angazhohet ose të akordojë në përfitim të një

- personi të vetëm ose grupi personash të lidhur me njëri-tjetrin;
- c) për shumën totale maksimale të kredisë, të shprehur në përqindje ndaj shumës totale të të gjitha kredive të saj (teprica gjithsej e kredive), për të cilën banka lejohet të angazhohet ose të akordojë në përfitim të dhjetë personave (duke përfshirë grupin e personave të lidhur), të cilët përfaqësojnë kredimarrësit më të mëdhenj të bankës.

NENI 31

1. Banka detyrohet të respektojë shumën totale minimale të burimeve likuide ose të kategorive të veçanta të tyre në raport me vlerën ose me ndryshimin e vlerës së aktiveve ose të kategorive specifike të tyre. Banka detyrohet të mbajë depozita monetare pranë Bankës së Shqipërisë, parashikuar në nenin 19 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", në lidhje me shumën e pasiveve apo ndryshimeve të tyre ose të kategorive specifike të pasiveve.
2. Sipas kërkesave të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, banka detyrohet:
 - a) të klasifikojë dhe të vlerësojë aktivet e saj;
 - b) të krijojë fonde rezervë specifike mbi bazën e klasifikimeve dhe vlerësimeve të saj;
 - c) të vlerësojë kohën kur të ardhurat nga aktivet me probleme nuk mund të kontabilizohen si të tilla, përveç rasteve kur arkëtohen fizikisht.
3. Banka nuk ka të drejtë të bëjë shpërndarje kapitali, në qoftë se sipas Bankës së Shqipërisë, pas shpërndarjes, bankës do t'i mbetet më pak se minimumi i kapitalit rregullator.
4. Banka nuk ka të drejtë të marrë pjesë drejtpërsëdrejti në veprimtari industriale, tregtare ose të kryejë shërbime jobankare, veç atyre të parashikuara në nenin 26.

NENI 32

Banka detyrohet të shpallë rregullisht për klientët e saj afatet dhe kushtet e normave të interesit, që lidhen me depozitat, me kreditë ose me huatë dhe me ndryshimet e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e llogaritjes, sipas mënyrës dhe formës së parashikuar në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

NENI 33

Pa miratimin e Bankës së Shqipërisë, banka nuk kryen veprimtaritë e mëposhtme për:

- a) pakësimin e kapitalit nëpërmjet riblerjes së aksioneve ose shpërndarjes së fondeve rezervë;
- b) blerjen e aksioneve të shoqërive tregtare që nuk janë banka apo të institucione financiare ose për pjesëmarrje si ortak në këto shoqëri tregtare me një shumë më të madhe se 10 për qind e kapitalit të tyre ose të vënies në pronësi të përbashkët, apo të bashkimit me subjekte të tjera, përveç bankave ose subjekteve të tjera që përcaktohen nga Banka e Shqipërisë;
- c) investimin e përshkruar në shkronjën (b) të këtij neni në masën mbi 15 për qind të kapitalit rregullator. Banka e Shqipërisë nuk miraton investime mbi 25 për qind të kapitalit rregullator.

NENI 34

Kufizimet sipas nenit 33 të këtij ligji nuk zbatohen për :

- a) përfitimin e aksioneve ose të të drejtave të tjera të pronësisë kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna. Në këtë rast banka përfituese i disponon të gjitha aksionet ose të drejtat e pronësisë të fituara për një vit, me përjashtim të rastit kur Banka e Shqipërisë e ka zgjatur këtë afat;
- b) përfitimin e aksioneve ose të të drejtave të tjera të pronësisë si agjent;
- c) blerjen e aksioneve ose të të drejtave të tjera të pronësisë me qëllim rishitjen e tyre të tretëve.

KREU V

MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONA TË LIDHUR ME TË

NENI 35

Banka nuk kryen veprimtari financiare me dhe në përfitim të personave të lidhur me të në rast se këto veprimtari mund të përfundohen me kushte dhe afate më pak të favorshme se tregu. Në kuptimin e këtij paragrafi, persona të lidhur me bankën përfshijnë:

- a) çdo administrator të bankës;
- b) çdo person të lidhur me administratorin nga marrëdhëniet bashkëshortore dhe të gjakut deri në shkallën e dytë ose të lidhur me të nga veprimtaria tregtare, siç mund të përcaktohen nga Banka e Shqipërisë me akte nënligjore.

NENI 36

Banka nuk jep kredi për dhe në përfitim të personave të lidhur me të, nëse totali i tepricës së të gjitha kredive të dhëna nga banka për personat e lidhur me të do të kalojë shumën e kapitalit rregullator të përcaktuar me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë.

NENI 37

Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kufizimet dhe kushtet e kredive të bankës për personat e lidhur me të. Në kuptimin e këtij paragrafi, në personat e lidhur me bankën përfshihen:

- a) personi, ose ndonjë grup personash që veprojnë të lidhur me njëri-tjetrin, të cilët disponojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi pjesëmarrje influencuese mbi bankën që jep kredinë;
- b) personi juridik, tek i cili banka disponon pjesëmarrjen influencuese.

KREU VI

LLOGARITË, KONTROLLI, INSPEKTIMI DHE MËNYRA E RAPORTIMIT

NENI 38

1. Banka mban llogaritë kontabël dhe përgatit raportet financiare, për të pasqyruar saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat kontabël gjendjen e saj financiare.
2. Kur banka ka më shumë se pesëdhjetë për qind të kapitalit të vet të investuar si pjesëmarrje në kapitalin e një a më shumë bankave të tjera, mban llogaritë e nevojshme kontabël dhe përgatit raportet financiare, për të pasqyruar me saktësi dhe në përputhje me parimet e metodologjinë standarde kontabile, situatën financiare edhe të këtyre bankave.
3. Llogaritë kontabël dhe raportet financiare duhet të jenë në formë dhe përmbajtje në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ndërkombëtare, duke respektuar rregullat e përgatitjes dhe të paraqitjes së llogarive kontabël të bankës, përfshirë krijimin e fondeve rezervë të duhura për aktivet e këqija e të dyshimta, si dhe për njohjen e të ardhurave e shpenzimeve.

NENI 39

1. Banka emëron ekspertin kontabël të autorizuar, të licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuar nga Banka e Shqipërisë. Eksperti kontabël i autorizuar duhet :
 - a) të ndihmojë për mbajtjen në mënyrën e duhur të llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare, përfshirë metodat e parashikuara nga Banka e Shqipërisë;
 - b) të përgatitë raport vjetor së bashku me opinionet e kontrollit, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të bankës, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare në zbatim të dispozitave të këtij ligji;
 - c) të shqyrtojë mjaftueshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe të praktikave e procedurave kontrolluese, si dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.
2. Eksperti kontabël i autorizuar informon Bankën e Shqipërisë për çdo veprim mashtrues të kryer nga nëpunësi i bankës, si dhe për parregullsitë dhe mangësitë në administrim ose në transaksionet që mund t'i sjellin bankës humbje.
3. Kopje e raportit vjetor dhe e opinionit të kontrollit të ekspertit kontabël të autorizuar i dërgohet edhe Bankës së Shqipërisë.

NENI 40

Bilanci kontabël i bankës, raporti vjetor financiar dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar për vitin financiar botohen në buletin zyrtar të bankës.

NENI 41

Banka dhe dega e bankës së huaj është objekt kontrolli nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë dhe nga ekspertit kontabël i autorizuar. Banka e Shqipërisë dhe ekspertit kontabël i autorizuar kanë të drejtë:

- a) të kontrollojnë dhe të shqyrtojnë llogaritë kontabël, librat e shoqërisë, dokumentet dhe çdo të dhënë tjetër në arkivat e bankës. Për rastet e degëve të bankave të huaja kontrolli shtrihet edhe në bilancet kontabël dhe deklaratat e të ardhurave të bankës së huaj;
- b) të kërkojnë në çdo kohë nga administratorët, nëpunësit dhe agjentët e bankës të

japin informacione për çështje që lidhen me administrimin, me drejtimin dhe me transaksionet. Informacionet përgatiten në formën e parashikuar nga Banka e Shqipërisë dhe eksperti kontabël i autorizuar sipas planit kontabël të miratuar.

ENI 42

Bilancet kontabël dhe raportet financiare të degëve të bankës së huaj përgatiten sipas parimeve kombëtare të kontabilitetit.

ENI 43

1. Banka përgatit dhe i paraqet Bankës së Shqipërisë një ose disa raporte për vlerësimin e gjendjes financiare të bankës dhe të degës së bankës së huaj, sipas rastit në mënyrë të veçantë ose të konsoliduar, në bazë të kërkesave të parashikuara në aktet nënligjore përkatëse së Bankës së Shqipërisë.
2. Nëpunësit e autorizuar të autoritetit mbikëqyrës të një vendi tjetër të ngarkuar për mbikëqyrjen bankare në atë vend, në marrëveshje me Bankën e Shqipërisë, mund të lejohen për inspektimin e një banke që :
 - a) është degë ose filial i bankës së huaj, e cila ka drejtorinë qendrore në atë vend;
 - b) ka pjesëmarrje influencuese në bankën e huaj, selia e të cilës është në atë vend.
3. Banka dhe dega e bankës së huaj lejojnë kontrollin dhe bashkëpunojnë me inspektorët e Bankës së Shqipërisë e me ekspertët kontabël të autorizuar e të miratuar.

KREU VII

SHKELJET DHE DËNIMET

NENI 44

1. Masat ndëshkimore dhe dënime të parashikuara për shkeljet sipas këtij neni vendosen nga Banka e Shqipërisë. Çdo palë e dëmtuar ka të drejtë t'i kundërshtojë këto masa ndëshkimore dhe dënime në gjykatë, brenda tetë ditëve nga njoftimi i vendimit.
2. Për shkeljen e dispozitave të këtij ligji ose të çdo akti nënligjor të Bankës së Shqipërisë, për shkeljen e çdo kushti a kufizimi që i bashkëlidhet licencës së Bankës të Shqipërisë dhe anekseve të saj, për shkeljen e marrëdhënieve të besimit, për ushtrimin e veprimtarisë të pasigurt dhe të paqëndrueshme, Banka e Shqipërisë vendos një ose disa dënime a masa ndëshkimore, pavarësisht nga renditja e tyre, si vijon:
 - a) Vërejtje me paralajmërim me shkrim për administratorët.
 - b) Urdhëron bankën të dorëzojë në Bankën e Shqipërisë një program të pranueshëm për veprimet që duhen për ndreqjen e shkeljeve.
 - c) Urdhëron bankën të ndërpresë dhe të mos vazhdojë veprimet në kundërvajtje, si dhe ndërmerr veprimet e tjera për ndreqjen e shkeljeve.
 - ç) Urdhëron bankën të ndërpresë një pjesë ose të gjitha transaksionet e saj ose të kufizojë pagimin e dividendëve.
 - d) Gjëmbet administratorët në shumën deri në tetë paga mujore dhe subjektin deri në njëzet milionë lekë.
 - dh) Pezullon deri në dymbëdhjetë muaj administratorët.
 - e) Kërkon largimin e një ose të të gjithë administratorëve nga vendi i punës në bankë.
 - ë) Urdhëron ndërprerjen e shpërblimit të administratorëve nga banka.
 - f) Merr në administrim dhe kontrollon bankën për një periudhë jo më të gjatë se dymbëdhjetë muaj dhe shkarkon një ose gjithë administratorët dhe nëpunësit e bankës.
 - g) Revokon licencën e bankës.
3. Kur raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të saj me rrezik dhe zërave jashtë bilancit është më pak se gjysma e raportit minimal të kërkuar, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, përveç masave dhe dënimeve të parashikuara në paragrafin 2, Banka e Shqipërisë i kërkon aksionerëve të rregullojnë situatën brenda periudhës kohore jo më tepër se gjashtë muaj.

Në rast se, me mbarimin e afatit, raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të saj me rrezik dhe zërave jashtë bilancit është më pak se gjysma e raportit minimal të kërkuar, zbatohet dispozita e nenit 48 të këtij ligji.

NENI 45

1. Shkelja e dispozitave të nenit 6 të këtij ligji nga subjektet e tjera, veç bankave, përbën vepër penale. Personat fajtorë dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.
2. Shkelja e dispozitave të nenit 23 të këtij ligji përbën kundërvajtje penale. Personat fajtorë dënohen me gjobë ose me burgim deri në një vit. Kur kjo vepër kryhet me qëllim fitimi ose për të dëmtuar një person tjetër, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
3. Sanksionet e parashikuara në nenin 44 të këtij ligji zbatohen edhe për çdo subjekt të përkthyer në nenin 1(3) të këtij ligji. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kufizojë ose të mbyllë veprimtarinë tregtare të këtyre subjekteve. Dispozitat e neneve 51 dhe 54 të këtij ligji zbatohen edhe për këto subjekte.

NENI 46

Masat ndëshkimore dhe dënimet e parashikuara në nenin 44 të këtij ligji nuk pengojnë marrjen në përgjegjësi civile ose penale të përcaktuara në akte të tjera ligjore.

NENI 47

Gjobat e vendosura sipas nenit 44 të këtij ligji arkëtohen për llogari të Bankës së Shqipërisë.

KREU VIII

KUJDESTARIA DHE LIKUIDIMI.

NENI 48

Kur raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të saj me rrezik dhe zërave jashtë bilancit është më pak se gjysma e raportit minimal të kërkuar, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, kjo e fundit i kërkon aksionerëve të rregullojnë situatën brenda një periudhe kohore jo më tepër se gjashtë muaj. Në rast se, me mbarimin e afatit, ky raport vazhdon të jetë më pak se gjysma, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të zgjedhë dhe të emërojë kujdestarin për të marrë në administrim dhe në kontroll bankën për një periudhë kohe jo më tepër se dymbëdhjetë muaj.

NENI 49

1. Kujdestari i gëzon të gjitha pushtetet e administratorëve, të drejtorëve ekzekutivë dhe të nëpunësve të bankës, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë me aktin e emërimit ka kufizuar shprehimisht autoritetin e kujdestarit.
2. Kujdestari administron bankën në mënyrën që ai e gjykon si më të mirën për rikthimin e bankës në gjendje të shëndetshme financiare.
3. Kujdestari është subjekt i akteve nënligjore të nxjerra herë pas here nga Banka e Shqipërisë.
4. Kujdestarit i njihen të njëjtat të drejta, detyrime, kufizime, dënime dhe kushte që zbatohen për administratorët, për nëpunësit ose për punonjësit e bankës.
5. Kompetencat e aksionerëve, të administratorëve dhe të nëpunësve të bankës pezullohen gjatë periudhës së kujdestarisë. Kujdestari ka të drejtë të urdhërojë nëpunësit dhe administratorët për zbatimin e funksioneve të veçanta në bankë. Këta administratorë dhe nëpunës mund të shkarkohen nga kujdestari.
6. Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, kujdestari ka të drejtë të veçojë dhe të sigurojë shumat e duhura monetare për t'u tërhequr nga depozituesit, si dhe për pagimin e detyrimit ndaj kreditorëve të tjerë. Të gjithë depozituesit dhe kreditorët, të cilët janë në kushte të barabarta, trajtohen në mënyrë të barabartë.
7. Kujdestari raporton periodikisht në Bankën e Shqipërisë për ecurinë e kujdestarisë.

NENI 50

Kujdestaria përfundon me :

- a) mbarimin e afatit të parashikuar në aktin e vendosjes së kujdestarisë;
- b) kërkesën e kujdestarit drejtuar Bankës së Shqipërisë, në rast se Banka e Shqipërisë e gjykon të drejtë që banka mund të ushtrojë veprimtarinë e saj normalisht;
- c) vendimin e Bankës së Shqipërisë për likuidimin e bankës.

NENI 51

1. Banka e Shqipërisë zgjedh dhe emëron likuidatorin për marrjen në posedim e në kontroll të bankës, si dhe revokon licencën, kur konstaton qenien e një apo më shumë rrethanave të tilla:
 - a) Janë shkelur aktet ligjore ose nënligjore, duke sjellë si pasojë paaftësinë paguese të bankës, shpërndarjen e konsiderueshme të aktiveve ose të fitimit të bankës, krijimin e premisave serioze për diskriminimin e të drejtave të depozituesve. Në kuptimin e këtij paragrafi, me "paaftësi paguese" nënkuptojmë:
 - i) banka nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat e depozituesve të saj ose të paguajë detyrimet gjatë ecurisë normale të veprimtarisë tregtare të saj; ose
 - ii) vlera e aktiveve të bankës bie nën shumën e pasiveve të saj.
 - b) Banka e Shqipërisë ka prova të besueshme që administratorët e bankës janë përfshirë në transaksione të jashtëligjshme, kanë kryer mashtrime të rënda ose kanë përfutur personalisht

- dhe i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme bankës ose personave të tretë.
- c) Kur kreditori i bankës vërtetohet, përpara Bankës së Shqipërisë, se dhjetë për qind a më shumë e detyrimeve të evidencuara nga bilanci kontabël më i fundit i bankës nuk i janë paguar brenda afatit. Në rast se Banka e Shqipërisë nuk ndërmer veprimet e mësipërme, një ose më shumë persona të interesuar kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata kompetente të detyrojë Bankën e Shqipërisë të veprojë në përputhje me këtë paragraf.
2. Likuiduesi zgjidhet dhe emërohet :
- a) brenda shtatë ditëve nga vendimi i Bankës së Shqipërisë, sipas paragrafit 1 të këtij neni; ose
- b) brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dorëzimi i vërtetimit në Bankën e Shqipërisë, sipas paragrafit 1 (c) të këtij neni.

NENI 52

1. Likuidatori, jo më vonë se dymbëdhjetë muaj nga data e emërimit sipas rrethanave dhe afateve të parashikuara në nenin 51, paragrafi 2 të këtij ligji, duhet :
- a) të sigurojë kushtet për blerjen e aktiveve specifike nga të tretët dhe të përqendrojë pasivët e veçanta në një ose disa banka; ose
- b) të likuidojë aktivet e bankës, siç parashikohet në këtë kre, me kusht që Banka e Shqipërisë të miratojë ose të refuzojë kushtet e propozuara të shitjes së bankës;
- c) të shesë bankën.
2. Likuidatori kryen veprimet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, kur sipas gjykimit të tij janë mundësitë për grumbullimin e shumave më të mëdha të aktiveve të bankës ose që mbrojnë të drejtat e depozituesve dhe të kreditorëve të tjerë.
3. Për realizimin e shitjes së bankës sipas paragrafit 1(c) të këtij neni ose për sigurimin e kushteve për blerjen e të gjitha aktiveve kryesore nga të tretët, si dhe të përqendrimit të të gjitha pasiveve kryesore në një ose disa banka sipas paragrafit 1(a) të këtij neni, likuidatori ka të drejtë të lejojë reduktimin e vlerave të pasivit aq sa sipas gjykimit të tij asnjë depozitues ose kreditor tjetër të mund të marrë më pak sesa mund të merrte në likuidim.
4. Për përcaktimin e shumës së aktiveve, që mund të sigurohen nga shitja e aktiveve të bankës, likuidatori duhet:
- a) të vlerësojë alternativat e vlerave të çastit, duke përdorur përqindje skontimi realiste; dhe
- b) të dokumentojë vlerësimin dhe parashikimin, mbi të cilin vlerësimi është i bazuar, duke përfshirë çdo parashikim në lidhje me përqindjen e interesave, me përqindjen e aktiveve të kthyeshme, me inflacionin, me koston e zotërimit (mirëmbajtja) të aktiveve dhe me pagimin e detyrimeve të kushtëzuara.

NENI 53

- Likuidatori i zgjedhur dhe i emëruar sipas nenit 51 të këtij ligji brenda tre ditëve nga data e emërimit merr në posedim bankën dhe:
- a) dërgon në çdo zyrë të bankës një njoftim për publikimin e këtij emërimi dhe revokimin e licencës, duke përcaktuar datën dhe kohën kur hyn në fuqi posedimi i bankës nga likuidatori;
- b) publikon njoftimin në një a më shumë nga gazetatat kryesore me tirazh më të madh;
- c) dërgon menjëherë kopje të këtij njoftimi në Bankën e Shqipërisë.

NENI 54

1. Brenda tridhjetë ditëve nga data e emërimit të likuidatorit, kanë të drejtë të fillojnë procedurat ligjore në gjykatën kompetente për të kërkuar ndërprerjen e procedurave të likuidimit të vlerësuar vetëm mbi bazën e rrethanave të emërimit të likuidatorit, sipas nenit 51 të këtij ligji këta persona:

- i) një ose më shumë aksionerë të bankës që disponojnë në total jo më pak se njëzet e pesë për qind të çdo klase të aksioneve me të drejtë vote në bankë.
 - ii) çdo person që zotëron të paktën një të katërtën e shumës totale të depozitave.
 - iii) kreditorët që përbëjnë të paktën një të katërtën në vlerë të totalit të detyrimeve të pretenduara nga kreditorë të tjerë, duke përjashtuar depozituesit.
2. Mbi bazën e rrethanave të parashikuara në nenin 51 të këtij ligji, gjykata vendos vetëm nëse Banka e Shqipërisë ka vepruar ose jo në mënyrë arbitrare apo të pakujdesshme për vendosjen e likuidimit.
 3. Gjykata zhvillon seancën brenda dhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesëpadisë. Brenda njëzet ditëve nga seanca përgatitore, gjykata vendos për kërkesëpadinë e bërë.
 - a) Në rast se gjykata vendos që Banka e Shqipërisë ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe të pakujdesshme për vendosjen e likuidimit, e vetmja masë dëmshpërblimi që vendoset nga gjykata është dëmi monetar që Banka e Shqipërisë duhet të paguajë. Bankës së Shqipërisë i njihet e drejta e rishqyrtimit të vendimit të revokimit dhe e ridhënies së licencës.
 - b) Në rast se gjykata vendos që Banka e Shqipërisë nuk ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe të pakujdesshme për vendosjen e likuidimit, padia refuzohet dhe likuidimi i bankës vazhdon në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

NENI 55

1. Likuidatori ka pushtet të plotë dhe ekskluziv për administrimin, drejtimin dhe kontrollin e bankës. Për të mirën e likuidimit të bankës, likuidatori synon sigurimin e shumës maksimale të aktiveve, pavarësisht se licenca e bankës është revokuar, si më poshtë:
 - a) vazhdon ose ndërpret çdo transaksion;
 - b) huazon mjete monetare, duke vendosur ose jo masën e sigurisë mbi aktivet e subjektit;
 - c) ndalon ose kufizon pagimin e çdo detyrimi, sipas kushteve të përshkruara në paragrafin dh (iv) të këtij neni;
 - ç) rivendos përqindjet e interesave të ripagueshëm të pasiveve të bankës, me kusht që këto përqindje të mos jenë më të ulta se përqindjet mbizotëruese në tregun përkatës.
 - d) punëson çdo nëpunës, punonjës ose këshilltar profesionist të domosdoshëm.
 - dh) ekzekuton çdo instrument në emër të bankës, ngre padi ose mbron dhe ndjek në emër të tij çdo veprim a procedurë ligjore, me kusht që likuidatori të marrë më parë miratimin e Bankës së Shqipërisë për ndërmarrjen e veprimeve vijuese:
 - i) shitjen e çdo aktivi të bankës që ka vlerë mbi një kufi të parashikuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë,
 - ii) vendosjen e masës së sigurisë si mjet për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit mbi çdo aktiv të bankës në favor të kreditorit, i cili ka dhënë një kredi të re për subjektin në vlerën që kalon shumën e parashikuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;
 - iii) ristrukturimin ose faljen e çdo detyrimi të pretenduar, në rast se vlera e detyrimit të pretenduar kalon shumën e parashikuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë,
 - iv) pagesën e çdo detyrimi të pretenduar (detyrim tjetër i pretenduar që nuk i takon një detyrimi të lindur nga likuidatori gjatë ushtrimit të pushtetit të tij në procesin e likuidimit, përpara përfundimit të procedurave të parashikuara në nenet 57 dhe 58 të këtij ligji), në të cilin të gjithë depozituesit dhe kreditorët në pozita të barabarta duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë.
2. Likuidatori raporton çdo muaj në Bankën e Shqipërisë për ecurinë e procesit të likuidimit. Këto raporte përmbajnë informacionin për veprimet që propozohen sipas nenit 52(1) të këtij ligji, totalin e shumës së detyrimeve të pretenduara ndaj bankës, totalin e shumës së aktiveve të bankës që janë shitur dhe parashikimin e të ardhurave nga shitja e aktiveve.

ENI 56

1. Kur likuidatori merr në posedim bankën:
 - a) Banka e Shqipërisë revokon licencën e bankës;
 - b) çdo kusht ligjor, kontraktual ose i çfarëdoshëm, me mbarimin e afatit të të cilit, një detyrim i pretenduar ose një e drejtë e bankës mund të shuhet ose të ngurtësohet, duhet të rivendoset në afat deri në gjashtë muaj nga data e mbarimit të afatit ose e ngurtësimit;
 - c) shfuqizon çdo sekuestro, barrë ose peng (përveç sekuestros, barrës ose pengut të vendosur gjashtë muaj përpara vendosjes së bankës në likuidim). Përveç sekuestros, barrës ose pengut të vendosur nga likuidatori në zbatim të nenit 55 të këtij ligji, për aq kohë sa procedura e likuidimit vazhdon, asnjë sekuestro, barrë, peng ose titull ekzekutiv në zbatim të vendimit gjyqësor të marrë përpara datës së emërimit të likuidatorit për një shumë në masën e parashikuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, nuk vendoset mbi çdo aktiv ose pronë të bankës;
 - ç) të drejtat e aksionerëve duhet të ngurtësohen, përveç të drejtave për të përfituar dividendët nga procedura e likuidimit sipas nenit 60(3) të këtij ligji;
 - d) çdo pagesë ose transfertë e ndonjë aktivi ose pronë e bankës e bërë :
 - i) brenda periudhës tremujore përpara se likuidatori vendos posedimin mbi bankën; ose
 - ii) një personi juridik i lidhur me të brenda periudhës njëvjeçare përpara se likuidatori të ketë vendosur posedimin mbi bankën; me qëllim preferencimi të përfituesit ndaj kreditorëve të tjerë të bankës, është absolutisht e pavlefshme dhe nuk zbatohet. Bëjnë përjashtim nga ky rregull pagesat e depozitave bankare në shumat e parashikuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

Personat që kërkojnë deklarin e transaksionit si absolutisht të pavlefshëm dhe të pazbatueshëm, për shkaqet që i përkasin paragrafit 1(d) të këtij neni, janë të detyruar të vërtetojnë që pagesa ose transfertat ishte bërë për të realizuar preferencën siç e kërkon ky paragraf.
2. Kur pagesa ose transfertat bëhet për qëllim preferimi për përfituesin, prezumohet si e tillë, përveç rasteve të mëposhtme:
 - a) pagesa është bërë nga banka për kreditorin gjatë ushtrimit të veprimtarisë normale tregtare, për të shlyer plotësisht ose pjesërisht një borxh ose ndonjë detyrim tjetër të bankës ndaj përfituesit; ose
 - b) transfertat e një aktivi ose pasurie është bërë nga banka si shkëmbim në kompensim të një vlere të barabartë me vlerën e vërtetë të aktiveve në treg ose të pasurisë së transferuar.

ENI 57

1. Brenda tridhjetë ditëve nga marrja në posedim e bankës, likuidatori bën inventarin e aktiveve dhe të pasurive të bankës dhe përcjell një kopje në Bankën e Shqipërisë, e cila përgatit një kopje të përshtatshme për konsultim nga publiku.
2. Likuidatori shet aktivet e bankës, të përshkruara në nenin 52(1)(b) të këtij ligji nëpërmjet procedurave transparente, me anë të së cilave bankat e tjera dhe publiku i gjerë të kenë mundësinë të konkurrojnë në blerjen e aktiveve të bankës.
3. Likuidatori ka të drejtë të përfundojë:
 - a) kontratat e punësimit në bankë me çdo person;
 - b) kontrata shërbimesh në të cilat banka është palë;
 - c) çdo detyrim, ku banka është qiramarrës i pasurisë së paluajtshme.
4. Brenda dy muajve nga data e emërimit të likuidatorit:
 - a) ai ndërmerr veprimet e domosdoshme për të zgjidhur të gjitha marrëdhëniet e besimit të kryera nga banka, për t'u kthyer aksionerëve të gjitha aktivet dhe pasuritë e poseduara nga banka mbi bazën e marrëdhënieve të besimit, si dhe për të mbyllur llogarinë kontabël të këtyre marrëdhënieve të besimit;

- b) ai dërgon me postë rekomande, sipas adresave në regjistrat e bankës, tek të gjithë depozituesit, kreditorët e tjerë, klientët e shërbimeve të arkës kasafortë dhe dorëzanësit e pasurive të poseduara nga banka, një deklaratë për natyrën dhe shumën e detyrimeve të pretenduara të tyre, sipas regjistrave të bankës. Në deklaratë cilësohet se çdo kundërshtim depozitohet pranë likuidatorit brenda një muaji dhe i kërkon klientëve të shërbimeve të arkës kasafortë, si dhe dorëzanësve të pasurive të poseduara nga banka, të tërheqin pasuritë e tyre.
5. Çdo pasuri e mbajtur në objektet e bankës brenda arkave kasafortë dhe që nuk është tërhequr përpara datës së përcaktuar në deklaratë sipas nënparagrafit 4(b) të këtij neni, merret në posedim nga likuidatori sipas mënyrës së parashikuar nga Banka e Shqipërisë.
6. Çdo mjet financiar i papretenduar dhe i poseduar nga banka si mbajtëse e dorëzanisë, së bashku me inventarët përkatëse, konsiderohen si mjete financiare të papretenduara, që merren në posedim dhe mbahen nga Banka e Shqipërisë, e cila duhet të përpiket të identifikojë pronarin e vërtetë.

NENI 58

Likuidatori, brenda dy muajve pas datës së fundit të përcaktuar në njoftimin e parashikuar në paragrafin 4(b) të nenit 57 të këtij ligji, për regjistrimin e detyrimeve të pretenduara:

- a) refuzon çdo detyrim të pretenduar, në rast se dyshon për vlefshmërinë e tij;
- b) përcakton shumën, në rast se ka, që i detyrohet çdo depozituesi të njohur dhe kreditorëve të tjerë, si dhe detyrimet e pretenduara preferuese sipas dispozitave të këtij ligji;
- c) përgatit për regjistrim në Bankën e Shqipërisë një strukturë mbi detyrimet e pretenduara të pranueshme;
- ç) njofton çdo person, detyrimi ndaj të cilit nuk është pranuar plotësisht, duke publikuar një herë në çdo tre javë kronologjike, në një ose disa gazeta kryesore me tirazh më të madh, një njoftim për datën dhe vendin në të cilin struktura e detyrimeve të pretenduara të përshkruara në paragrafin 1(c) të këtij neni është e vlefshme për konsultim nga publiku, si dhe datën brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e publikimit për herë të tretë të njoftimit, në të cilën likuidatori do të regjistrojë strukturën e detyrimeve të pretenduara në Bankën e Shqipërisë.

NENI 59

1. Brenda njëzetë ditëve pas regjistrimit të strukturës së detyrimeve të pretenduara, sipas paragrafit (c) të nenit 58 të këtij ligji, çdo depozitues, kreditor tjetër ose një apo më shumë aksionerë që disponojnë në total jo më pak se dhjetë për qind të çdo klase të aksioneve me të drejtë vote të bankës, kanë të drejtë të paraqitin kundërshtimet në Bankën e Shqipërisë për çdo veprim ose propozim për veprim, sipas paragrafit (a) ose (b) të nenit 58 të këtij ligji. Për çdo kundërshtim të paraqitur, Banka e Shqipërisë vendos brenda një muaji nga regjistrimi i ankesës.
2. Në rast se kundërshtimi është pranuar, Banka e Shqipërisë modifikon dhe përmirëson strukturën e detyrimeve të pretenduara ose veprimet e propozuara për shlyerjen e detyrimeve.
3. Pas regjistrimit të strukturës, likuiduesi herë pas here ka të drejtë t'i përmbushë pjesërisht detyrimet e pretendimeve të perefuzuara ose të pretendimeve të pranuar nga Banka e Shqipërisë, me kusht që të jetë mbajtur një rezervë e mjaftueshme për pagimin e detyrimeve të pretenduara, por të refuzuara.

NENI 60

1. Në rast të likuidimit të bankës, detyrimet e pretenduara, të siguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, shlyhen sipas vetë kushteve të parashikuara për këtë qëllim, kurse detyrimet për pretendimet e tjera të pranuar shlyhen me preferencë ndaj të gjitha detyrimeve të tjera, sipas rradhës së detyrimeve të pretenduara si vijon:

- a) shpenzimet e domosdoshme dhe të arsyeshme të bëra nga likuiduesi dhe Banka e Shqipërisë në zbatim të dispozitave të këtij kreu;
 - b) kreditorët e kredive të reja të dhëna bankës pas zgjedhjes dhe emërimit të likuidatorit;
 - c) detyrimet e pretenduara nga depozituesit e vegjël deri në masën e parashikuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;
 - ç) depozituesve që nuk kanë përfituar sipas nënparagrafit (c) të këtij neni;
 - d) detyrimet e tjera të pretenduara kundrejt bankës.
- 2.** Çdo detyrim tjetër i pretenduar, i vlefshëm dhe i mbetur pa u zgjidhur, për shkak të mosregjistrimit brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e kundërshtimeve sipas nenit 59 të këtij ligji, paguhet mbi bazën e përqindjes së përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, pas shlyerjes të të gjitha detyrimeve të pretenduara të regjistruara dhe të detyrimeve të pretenduara të siguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve. Detyrimi i pretenduar, i siguar me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, shlyhet deri në masën e sigurimit të tij në datën e regjistrimit të tij në strukturën e detyrimeve të pretenduara e të pranuar, parashikuar në paragrafin (c) të nenit 58 të këtij ligji.
- 3.** Çdo aktiv i mbetur pas shlyerjes të të gjitha detyrimeve të pretenduara shpërndahet midis aksionerëve në raport me të drejtat dhe pjesëmarrjen e secilit në kapitalin e bankës. Në rast se shuma e mbetur për shlyerjen e detyrimeve të pretenduara të secilit grup të renditur në këtë nen është e pamjaftueshme për të kryer pagesën e plotë të tyre, atëherë ajo bëhet proporcionale me shumatat që do të paguhen.

ENI 61

- 1.** Likuidatori i raporton menjëherë Bankës së Shqipërisë për përfundimin e shpërndarjes së të gjitha aktiveve të bankës gjatë procesit të likuidimit.
- 2.** Banka e Shqipërisë dhe likuidatori lirohen nga çdo përgjegjësi tjetër në lidhje me likuidimin e bankës, sapo Banka e Shqipërisë të miratojë këtë raport.

ENI 62

- 1.** Likuidatori gëzon aftësitë profesionale, reputacionin dhe përvojën e besueshme.
- 2.** Asnjë person nuk zgjidhet dhe emërohet si likuidator, në rast se:
 - a) është dënuar penalisht;
 - b) gjatë pesë vjetëve të fundit është shpallur fajtor për vepra kundër personit, moralit dhe dinjitetit të tij, si dhe për vepra kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
 - c) momentalisht dyshohet për pjesëmarrje në veprimtari mashtruese ose akuzohet për vepra penale apo i kërkohet dëmshpërblim që mund të privojë ose të cënojë materialisht mundësitë e tij për të realizuar detyrën;
 - ç) është subjekt i hetimeve për veprimtari mashtruese ose për vepra të tjera penale;
 - d) me vendim të gjykatës është në pamundësi të ushtrojë detyrat ndaj bankës.
- 3.** Përpara zgjedhjes dhe emërimit, likuidatori depoziton një vërtetim, ku tregon se ai nuk ka ndonjë ndalesë të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni për kryerjen e shërbimit si likuidator.
- 4.** Përpara zgjedhjes dhe emërimit të likuidatorit, sa më shpejt që të jetë e mundur, personi duhet të depozitojë informacionin për t'i krijuar mundësinë Bankës së Shqipërisë të vendosë për konfliktet e interesave. Informacioni shprehet për marrëdhëniet vetjake, tregtare dhe financiare të personit ose bashkëshortit/ bashkëshortes, si dhe të fëmijëve të mitur, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në informacionet vijuese për :
 - a) hua ose kredi të marra në bankë, aktivet e së cilës janë përfshirë në likuidim;
 - b) marrëdhënie punësimi në bankë, aktivet e së cilës janë përfshirë në likuidim;
 - c) të drejta pronësie në bankë, aktivet e së cilës janë përfshirë në likuidim;
 - ç) marrëdhëniet e tij gjatë pesë vjetëve të fundit me çdo bankë tjetër si nëpunës apo punonjës ose si administrator apo drejtor, ose aksioner me pjesëmarrje influencuese;
 - d) marrëdhëniet financiare, tregtare ose marrëdhëniet e ngushta financiare me çdo subjekt që ka pjesëmarrje në kapitalin e bankës që është objekt likuidimi, ose aktivet e së cilës janë objekt likuidimi, duke përfshirë informacionin për negociimet ose marrëveshjet

- dh) e punësimit të pritshëm me këtë subjekt;
 - dh) listën dhe përshkrimin e çdo rasti që ai ka qenë në pamundësi për të shlyer çdo detyrim ndaj bankës gjatë pesë vjetëve të fundit;
 - e) të drejta pronësie për çdo pasuri në diskutim, në rast se likuidatori vlerëson, disponon ose administron një pasuri të paluajjtshme;
 - ë) çdo veprimtari tjetër tregtare ose pjesëmarrje në kapitalin e një subjekti që kryen veprimtari financiare, të cilat mund të çenojnë mundësinë e personit të veprojë në mënyrë të pavarur si likuidator;
 - f) çdo informacion tjetër që mund të kërkohet nga Banka e Shqipërisë.
5. Personi i propozuar për likuidator vërteton se nuk ka konflikte interesi për shkak të marrëdhënieve familjare dhe tregtare brenda kohës së depozitimit të informacionit të përshkruar në paragrafin 4 të këtij neni. Banka e Shqipërisë, përpara zgjedhjes dhe emërimit të likuidatorit, vendos për qenien e konflikteve të interesave dhe nëse ka të tilla, personi njoftohet se është në pamundësi për të vepruar në mënyrë të pavarur. Në rast se personi i emëruar si likuidator, vihet në dijeni për konfliktin e interesave, njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë brenda dhjetë ditëve nga marrja dijeni për këto konflikte dhe parashtron masat që ka marrë ose do të marrë për mënjanimin e tyre.
6. Likuidatori është i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij. Likuidatori nuk duhet:
- a) të pranojë ose të kërkojë përfitime, dhurata ose sende të tjera me vlerë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga çdo subjekt :
 - (i) për të cilin ai është në dijeni se mund t'i kërkojë ndërhyrje lidhur me procesin e likuidimit; ose
 - (ii) i cili ka interesa materiale që mund të çenohen në mënyrë thelbësore nga kryerja ose moskryerja e detyrave;
 - b) të përdorë në mënyrë të papërshtatshme ose të lejojë përdorimin në mënyrë të papërshtatshme të pasurisë së tij, ose pasurinë që ai e mbikëqyr ose e kontrollon, për përfitime vetjake të çdo subjekti tjetër;
 - c) të bëjë çdo premtim ose veprim të paautorizuar.
7. Likuidatori ndalohet të bëjë të njohur informacionin jopublik për çdo person, përveç rasteve kur kërkohet për të realizuar detyrat e tij si likuidator. Në rast se Banka e Shqipërisë vëren se likuidatori nuk i përmbush cilësitë dhe nuk zbaton kërkesat dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj, e shkarkon këtë person.

ENI 63

1. Nëpunësit profesionistë të caktuar dhe të emëruar nga likuidatori për ndihmë, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë kre dhe në varësi të kërkesave dhe të kushteve të shërbimit, nuk shpërblehen më shumë se nëpunësit e bankës për të njëjtat shërbime, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë ka autorizuar pagesën e shumave më të larta. Banka e Shqipërisë e jep këtë autorizim, kur arrin në përfundimin se pagesa e shumave më të larta është më se e domosdoshme për të rekrutuar dhe mbajtur personelin e nevojshëm.
2. Të gjitha pretendimet e ngritura për dhe në lidhje me paaftësinë paguese të bankës ose të bankës në likuidim, kundrejt likuidatorit ose Bankës së Shqipërisë, parashtrihen në përputhje me dispozitat e këtij kreu.
3. Gjykata ose arbitrazhi, që shqyrton çështjet për dhe në lidhje me paaftësinë paguese të bankës ose të bankës në likuidim, kundrejt likuidatorit ose Bankës së Shqipërisë, vendos:
 - a) nëse i padituri ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe të pakujdesshme, sipas rrethanave të faktit dhe të ligjit në zbatim;
 - b) nëse Banka e Shqipërisë, likuidatori dhe nëpunësit profesionistë të emëruar për të ndihmuar likuidatorin nuk janë përgjegjës për dëmet ose përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e kryera në përputhje me dhe gjatë ushtrimit të funksioneve dhe të detyrave të procesit të likuidimit, përveç rasteve kur veprimet ose mosveprimet e tilla janë qëllimisht të gabuara;

- c) nëse procesi i likuidimit dhe veprimet në fjalë do të vazhdojnë pa u ndërprerë gjatë periudhës së apelimit të vendimit dhe çdo apelimi tjetër apo procesi tjetër juridik të lidhur me apelimin.

ENI 64

1. Sipas dispozitave të këtij neni, banka kooperativë detyrohet të zbatojë të gjitha dispozitat e këtij ligji, duke përfshirë edhe kërkesat e mbikëqyrjes. Banka kooperativë është objekt i mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë.
2. Organizimi, drejtimi, kapitalizimi, transaksionet, shpërndarja e tepricave dhe likuidimi vullnetar i bankave kooperativë bëhen në përputhje me dispozitat e këtij neni. Banka kooperativë është person juridik dhe ka personalitet juridik për:
 - i) nënshkrimin e kontratave dhe emetimin e obligacioneve;
 - ii) nxjerrjen e akteve nënligjore dhe për të qenë subjekt i procedurave të tilla;
 - iii) të përfituar, poseduar dhe disponuar pronë të luajtshme a të paluajtshme për qëllime të veprimtarisë tregtare të saj.
 - a) Bankat kooperativë regjistrohen në regjistrim tregtar.
 - b) Anëtarët e bankës kooperativë janë të kufizuar në:
 - i) individë, të cilët paguajnë një kuotë anëtarësie fillestare, të përcaktuar nga banka, të cilët kanë depozita në bankë dhe që kanë një lloj profesioni ose banojnë brenda një rrezeje prej 25 kilometrash nga selia e bankës; dhe
 - ii) artizanët dhe tregtarët e vegjël me veprimtari tregtare lokale, të përcaktuar si persona fizikë a juridikë, me një ose disa ortakë, parashikuar nga ligji "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar" dhe ligjet e tjera përkatëse, të lokalizuar brenda një rrezeje prej 25 kilometrash nga selia e bankës dhe që kanë një qarkullim vjetor në shumën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, të cilët paguajnë një kuotë fillestare anëtarësie të përcaktuar nga banka.
 - c) Anëtarët nuk janë përgjegjës për detyrimet e bankës kooperativë. Përgjegjësia e tyre ndaj bankës është e kufizuar deri në ato detyrime të cilat ata i marrin përsipër me akte të veçanta në lidhje me bankën kooperativë.
3. Bankat kooperativë drejtohen nga këshilli drejtues, i cili përbëhet prej të paktën tre personash, të cilët qëndrojnë në detyrë për një afat prej katër vjetësh. Anëtarët e këshillit drejtues zgjidhen dhe emërohen nga asambleja e përgjithshme e bankës. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund të rizgjidhen.
 - a) Çdo anëtar i bankës kooperativë, në kohën e ushtrimit të veprimtarisë së asamblesë së përgjithshme, ka të drejtën e një vote.
 - b) Këshilli drejtues përcakton me akte nënligjore drejtimin e punëve të tij. Këto akte miratohen paraprakisht nga Banka e Shqipërisë.Banka kooperativë ka edhe komitet kontrolli, anëtarët e të cilit zgjidhen dhe emërohen nga asambleja e përgjithshme e bankës kooperativë.
4. Gjendja e llogarisë tepricë në fillim do të jetë 1/3 e shumës së kapitalit minimum të kërkuar kohë pas kohe nga Banka e Shqipërisë për të licencuar bankat e reja dhe mund të jetë në formën e detyrimeve të borxhit në varësi nga kërkesat e depozituesve me një afat mesatar maturimi prej pesë vjetësh. Pas pesë vjetësh të fillimit të veprimtarisë, një bankë kooperativë do të ketë një llogari tepricë të barabartë me 10 për qind të aktiveve gjithsej.
5. Kredi mund të jepet vetëm për individë dhe subjekte lokale me veprimtari tregtare të vogla. Kredia për një kredimarrës të vetëm apo kredimarrës solidarë është e kufizuar deri në shumën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
6. Bankat kooperativë kalojnë tepricën, e cila del nga të ardhurat që tejkalojnë shpenzimet dhe taksat, në një llogari tepricash. Nëse në një vit financiar llogaria e tepricës tejkalon 10 për qind të totalit të aktiveve, atëherë një tepricë e tillë mund, me vendim të këshillit të drejtuesve, t'u shpërndahet anëtarëve në raport me depozitat e tyre gjendje, gjashtë muaj përpara datës së mbylljes së bilancit.
7. Bankat kooperativë mund të likuidohen vullnetarisht me:
 - i) votim të anëtarëve që zotërojnë 75 për qind të shumës së depozitave të bankës 30

- ditë përpara votimit, dhe
ii) miratim të Bankës së Shqipërisë.
- a) Kërkesa e bërë në Bankën e Shqipërisë për miratimin e likuidimit vullnetar të bankës do të shoqërohet me:
- i) një kopje të duhur autentike të vendimit të depozituesve të bankës për të likuiduar bankën;
 - ii) një përshkrim të arsyeve për likuidimin e propozuar;
 - iii) një plan likuidimi, duke përfshirë një grafik kohor për likuidim;
 - iv) emrin e likuidatorit që emërohet nga banka, së bashku me një përshkrim të cilësive profesionale të tij dhe të përvojës;
 - v) informacion të mjaftueshëm, duke përfshirë raportin e vitit të fundit financiar të kontrolluar nga eksperti kontabël i autorizuar, i pranueshëm nga Banka e Shqipërisë, për t'ia treguar Bankës së Shqipërisë, që banka ka aftësi paguese dhe aktivet e saj j anë likuide e të mjaftueshme për të shlyer detyrimet e saj brenda periudhës së propozuar.
- b) Brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës dhe informacionit të nevojshëm, Banka e Shqipërisë informon aksionerët e bankës për vendimin e saj lidhur me kërkesën. Nëse kërkesa nuk pranohet, vendimi do të përmbajë edhe arsyet për mospranimin. Nëse kërkesa miratohet, vendimi përmban revokimin e licencës së bankës dhe botohet në Buletinin Zyrtar, si dhe në një a më shumë nga gazetatat kryesore me tirazh më të madh.

ENI 65

1. Banka e cënuar nga urdhri, vendimi ose rregullorja e Bankës së Shqipërisë, për të cilin banka e gjykon se është i kundërligjshëm, ka të drejtë të depozitojë një ankesë në gjykatën e apelit. Akti i Bankës së Shqipërisë zbatohet pa kufizim gjatë periudhës së ankimit dhe çdo apeli tjetër ose procesi tjetër juridik të lidhur me apelimin, përveç rasteve kur gjykata e apelit e pezullon shprehimisht aktin e Bankës së Shqipërisë pas dëgjimit të çështjes në fjalë.
2. Për masën e marrë nga Banka e Shqipërisë sipas këtij ligji ose ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", gjykata vendos vetëm:
 - a) nëse Banka e Shqipërisë ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe në mënyrë arbitrare;
 - b) nëse administratorët ose këshilltarët e Bankës së Shqipërisë, të angazhuar për të përfaqësuar ose ndihmuar Bankën e Shqipërisë, nuk do të jenë përgjegjës për dëmet, veprimet ose neglizhimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre për Bankën e Shqipërisë. Ata janë përgjegjës vetëm nëse veprime ose neglizhime të tilla janë të qëllimshme.

KREU IX

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 66

1. Banka e Shqipërisë, në marrëveshje me bankat ose subjektet e tjera që kryejnë veprimtari bankare, zbaton sisteme elektronike për transferimin e fondeve në sistemin ndërbankar të pagesave.
2. Në rastet e zbatimit të sistemeve elektronike për transferimin e fondeve, sipas pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë është e autorizuar të procedojë mbi urdhrat e pagesave elektronike të pakushtëzuara, të marra nga banka urdhëruese, si dhe të ekzekutojë transfertat e pagesave, duke kredituar menjëherë llogaritë përkatëse dhe njofton në mënyrë elektronike bankën pritëse.
3. Në rastet e pagesave elektronike, kur është përcaktuar datë-valuta, vepohet si në paragrafin 2 të këtij neni, duke respektuar afatin e përcaktuar të pagesës.

NENI 67

Banka ka stemën dhe vulën e saj me shenjat përkatëse.

NENI 68

Banka paguan tatime dhe taksa të parashikuara me ligj.

NENI 69

1. Subjektet që veprojnë si bankë në kohën kur ky ligj hyn në fuqi dhe kanë marrë licencën në zbatim të ligjit nr.8075, datë 22.2.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë", konsiderohen si të licencuara për të ushtruar veprimtarinë bankare në përputhje me këtë ligj. Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'i kërkojë bankës të paraqesë informacion plotësues, nëse sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë informacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm.
2. Subjektet që veprojnë si bankë dhe që nuk kanë marrë licencën ose nuk janë rilicencuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8075, datë 22.2.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë", janë të detyruara të paraqesin dokumentacionin e plotë për licencë, sipas kërkesave të këtij ligji, brenda një periudhe tremujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në të kundërt, me mbarimin e afatit të parashikuar në këtë dispozitë, Banka e Shqipërisë detyrohet të ndërpresë veprimtarinë financiare të bankës, të likuadojë, sa më parë që të jetë e mundur, aktivet e saj, të zgjidhë marrëdhëniet kontraktore mbi depozitat pa afat dhe të shlyejë detyrimet e saj.

NENI 70

1. Banka publike shqiptare kryen veprimtari bankare, organizohet dhe mbikëqyret sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë.
2. Banka publike shqiptare, e cila me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nuk plotëson kërkesat për kapitalin:
 - a) deri në fund të vitit 1999 detyrohet të plotësojë kërkesat e përkrahura në nenet 31 dhe 32 të këtij ligji;
 - b) brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të paraqesin për miratim në Bankën e Shqipërisë një program të detajuar sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë, në zbatim të paragrafit 2 (a) të këtij neni.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të zgjasë afatin e parashikuar në paragrafin 2 (a) të këtij neni vetëm për shkaqe të përligjura dhe jo më tej se një vit nga mbarimi i këtij afati.

ENI 71

1. Të gjitha vendimet, rregulloret, udhëzimet, urdhërat, miratimet dhe autorizimet e Bankës së Shqipërisë konsiderohen si akte nënligjore.
2. Aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, të dala në zbatim të ligjit nr.8075, datë 22.2.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë", përveç rasteve kur bien haptazi në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, mbeten në fuqi.

ENI 72

Ligji nr.8075, datë 22.2.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

ENI 73

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

RREGULLORE

PËR DHËNIEN E LICENCËS

PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE

NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

NENI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 1.1. Në këtë rregullore përcaktohen:
- kushtet, afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të ushtruar veprimtari bankare si bankë dhe degë e bankës së huaj, si dhe procedurat e krijimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë,
 - rastet, afatet dhe procedurat e revokimit të licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare,
 - kërkesat dhe procedurat për zgjerimin apo për pakësimin e rrjetit të bankës,
 - procedurat për miratimin e transferimit të pronësisë mbi aksionet e bankës.
- 1.2. Bazën ligjore të kësaj rregulloreje e përbëjnë: ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 3, pika 4.c dhe neni 12, ligji nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", kreu i dytë, ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.
- 1.3. Banka e Shqipërisë është i vetmi autoritet që lëshon licencën si akt administrativ për dhënien e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë bankare.
- 1.4. Banka krijohet ligjërisht si një shoqëri aksionere. Emri i saj përcaktohet në statutin e shoqërisë dhe paraprihet nga fjala "Banka".
- 1.5. Shuma e kapitalit fillestar minimal të paguar (kontributi në para), për licencimin e një banke është jo më pak se **700 milionë lekë**.
- 1.6. Shuma e kapitalit fillestar minimal e dhuruar dhe e paguar (kontributi në para), për licencimin e një dege të një banke të huaj është jo më pak se **700 milionë lekë**.
- 1.7. Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje termat e përdorur në të kanë të njëjtin kuptim si ata të shprehur në nenin 2 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

- 1.8. Termat vijues të kësaj rregulloreje kanë këto domethënie:
- a) **"kapitali fillestar minimal"**, përfaqëson shumën minimale të kapitalit të kërkuar nga Banka e Shqipërisë për marrjen e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë;
 - b) **"kapitali fillestar i paguar"**, përfaqëson kapitalin që ka paguar banka për të filluar aktivitetin;
 - c) **"aksioner direkt të bankës"** do të kuptojmë çdo person fizik tregtar, person juridik apo individ që ka pjesëmarrje në kapitalin e bankës;
 - d) **"aksioner indirekt i bankës"** do të kuptojmë çdo person fizik tregtar, person juridik apo individ që zotëron të drejtën e pronësisë në kapitalin e një personi juridik që është aksioner direkt, me pjesëmarrje influencuese, në kapitalin e bankës.

ENI 2

KAPITALI FILLESTAR DHE BURIMET E TIJ

- 2.1. Pagesa e shumës së kapitalit fillestar minimal për kontributin në para, mund të bëhet në monedhën shqiptare (Lekë), në dollarë amerikanë ose në monedhën europiane Euro, që përbëjnë kundravleftën e kapitalit në Lekë, sipas pikave 1.5 dhe 1.6 të kësaj rregulloreje, vlerësuar me kursin mesatar ditor, të llogaritur nga Banka e Shqipërisë në ditën e pagesës së kapitalit .
- 2.2. Kapitali fillestar i paguar (për kontributin në para) për të marrë licencën për të kryer veprimtari bankare depozitohet në Bankën e Shqipërisë në një llogari depozitë e marrë si garanci (pa interes). Depozitimi bëhet me xhirim në llogari dhe jo në *cash*.
- 2.3. Banka e Shqipërisë përcakton ndryshimin e shumës së kapitalit fillestar minimal të paguar për kontributin në para, e nevojshme dhe e domosdoshme për licencimin e një banke ose një dege të bankës së huaj dhe e publikon në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
- 2.4. Në mbështetje të nenit 26 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", shuma e kapitalit fillestar, të paguar (kontributi në para) përcakton veprimtarinë financiare të lejuara për bankën.
- 2.5. Burim për kapitalin fillestar për krijimin e bankës, nuk mund të jenë hua, kredi apo paradhënie nga subjekte të treta.
- 2.6. Pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve të bankës dhe të pajisjeve të punës nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal të paguar për kontributin në para.
- 2.7. Organizimi i kontabilitetit bëhet mbështetur në ligjin "Për kontabilitetin", në "Manualin e Kontabilitetit Bankar" miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.820, datë 30.12.1998 dhe në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

ENI 3

KËRKESA PËR MARRJEN E LICENCËS

- 3.1. Kërkesa për marrjen e licencës për të kryer veprimtari bankare, bëhet me shkrim dhe paraqitet në Bankën e Shqipërisë. Në përmbajtjen e kësaj kërkesë deklarohet angazhimi për zbatimin e legjislacionit shqiptar gjatë veprimtarisë së bankës së propozuar, emri i bankës së propozuar dhe motivi i këtij emërtimi.

- 3.2. Kërkesa për marjen e licencës për të kryer aktivitet bankar të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe atë sipas kësaj rregulloreje dhe formularëve bashkëlidhur. Kërkesa si më sipër të jetë e nënshkruar nga aksionerët direktë të bankës së propozuar.
- 3.3. Dokumentacioni në gjuhën shqipe paraqitet në origjinal dhe në fotokopjen e noteruar të tij. Dokumentacioni në gjuhë të huaj paraqitet në origjinal ose në fotokopjen e noteruar të tij, e vërtetuar nga autoritetet shtetërore kompetente të vendit ku është lëshuar dokumenti ose të vendit të origjinës së kërkuarit, që e kanë njohur këtë dokument. Ky dokumentacion të jetë i shoqëruar nga përkthimi në gjuhën shqipe i noteruar.
- 3.4. Kërkuar pasi paraqet kërkesën, së bashku me dokumentacionin përkatës, ka për detyrë të publikojë një njoftim në një nga gazetatat me tirazh të madh lidhur me kërkesën e paraqitur prej tij për të marrë licencë për të kryer aktivitet bankar. Njoftimi bëhet sipas modelit në vijim, formulari nr. 2.

NENI 4

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

- 4.1. Për burimin e kapitalit:
 - a. Dokumentimin e burimit të kapitalit.
Kapitali aksioner i bankës së propozuar, kur ka si burim:
 - të ardhurat e individit, vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve të tilla si librezë kursimi, çertifikatë depozite, akt trashëgimie etj. të shoqëruara me dokumentacionin që vërteton pagimin e detyrimeve fiskale (tatim-taksave) mbi këto të ardhura;
 - të ardhurat nga veprimtaria e personit fizik tregtar ose personit juridik, vërtetohet me paraqitjen e bilanceve kontabël të çertifikuara, të shoqëruara me dokumentacionin që vërteton pagimin e detyrimeve fiskale (tatim-taksave) mbi këto të ardhura.
 - b. Deklaratën notoriale të aksionerëve direkt, se burimi për kapitalin fillestar të bankës nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme për të dalë qartë burimi i krijimit të parave që do të shërbejnë si kapital i bankës.
- 4.2. Për aksionerët direktë (themeluesit) të bankës:
 - a) akt-marrëveshja e krijimit të kësaj shoqërie dhe objekti i veprimtarisë së saj;
 - b) projektstatuti i bankës së propozuar;
 - c) lista e themeluesve të bankës, numri i aksioneve të propozuara për çdo aksioner direkt;
 - d) struktura e aksionerëve të bankës, duke përfshirë aksionerët direktë dhe indirektë të saj;
 - e) lista e anëtarëve të këshillit drejtues të bankës së propozuar.
- 4.2.1 Kur aksionerët direktë janë persona juridikë:
 - a) Vendimi i regjistrimit në gjykatë, akti i themelimit dhe statuti i personit juridik, duke përfshirë të dhënat për adresën e saktë të selisë, përshkrimin e veprimtarisë, shumën e kapitalit, listën e aksionerëve/ortakëve dhe pjesëmarrjen e tyre në kapital, si dhe pjesëmarrjet e tyre influencuese në shoqëri të tjera; çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

- b) të dhënat për veprimtarinë tregtare për 7 vitet e fundit të çdo personi, që propozon të zotërojë, vetë ose së bashku me personat juridikë të lidhur, pjesëmarrje influencuese në bankën e propozuar, shumën e propozuar për zotërim si dhe bilancet kontabël, pasqyrat e të ardhurave dhe të shpenzimeve të shoqërisë dhe gjendjen e *cash flow-t* për aktivitetet e biznesit të tyre në 3 vitet e fundit. Dokumentet e mësipërme të jenë të vërtetuara nga ekspertët kontabël të autorizuar që kanë bërë kontrollin e shoqërisë;
- c) të dhëna për reputacionin e aksionerëve direktë dhe të aksionerëve indirektë të bankës, si dhe lidhjet midis tyre;
- d) vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim- taksave nga aksionerët direktë për 3 vitet e fundit të aktivitetit të tyre;
- h) deklaratë personale për shlyerje të detyrimeve dhe për shlyerje të rregullta të kredive (në qoftë se ka).

4.2.2. Kur aksionerët direktë janë persona fizikë tregtarë ose individë:

- a) -Për personat fizikë tregtarë: të dhëna për bizneset, ku ata kanë pjesëmarrje influencuese, dhe për çdo pjesëmarrje: përqindja e aksioneve/kuotave që disponojnë, akti i regjistrimit të shoqërisë, çertifikata e regjistrimit në organin tatimor, të dhëna mbi ndonjë rast falimentimi të tyre;
për individët të dhëna personale: emër, mbiemër, adresa, kombësia, shtetësia, edukimi, punësimi aktual dhe i shkuar, dhe interesat pasurorë apo të biznesit, dëshmi penaliteti për tre vitet e fundit.
- b) të dhëna për pjesëmarrjen e tyre në këshillat drejtues, në këshillat mbikëqyrës dhe në organet drejtuese të shoqërive të tjera ose të organizatave të biznesit;
- c) të dhëna për lidhjet që mendohet të ketë midis aktivitetit të tyre dhe bankës së propozuar;
- d) të dhëna mbi llogaritë bankare të tyre (referenca në lidhje me to);
- e) të dhëna për veprimtarinë tregtare ose profesionale për 7 vitet e fundit të çdo personi fizik tregtar ose individ, që propozon të zotërojë pjesëmarrjen influencuese të bankës së propozuar, si dhe për secilën shoqëri ku ai ka pjesëmarrje influencuese paraqiten bilancet kontabël, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe gjendja e *cash flow-t* të tyre për 3 vitet e fundit;
- f) të dhëna për reputacionin e personit fizik tregtar ose të individit , si dhe të dhëna për lidhje familiare midis tyre;
- g) vërtetim, nga autoritetet përkatëse, për shlyerjen e detyrimeve të tatim-taksave nga personi fizik tregtar ose individ për 3 vitet e fundit;
- h) deklaratë personale të personit fizik tregtar ose e individit lidhur me shlyerjen e detyrimeve dhe shlyerje të rregullta të kredive(në qoftë se ka) .

4.2.3 Kur aksioneri direkt është një bankë e huaj:

1. Banka e huaj që kërkon të marrë licencë për të kryer veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet një filiali apo një dege të saj, i dërgon Bankës së Shqipërisë një kërkesë me shkrim të shoqëruar, me dokumentacionin e përmendur në paragrafin 4.2.1. të këtij neni. Përveç sa më sipër do të paraqitet dhe dokumentacioni i mëposhtëm në lidhje me bankën mëmë:
 - a) leja e ushtrimit të veprimtarisë bankare e dhënë nga autoriteti licencues i vendit ku ndodhet selia e saj;
 - b) skema e organizimit dhe e drejtimit të bankës dhe administratorët e saj;
 - c) pëlqimi për hapjen e filialit apo të degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë, i dhënë nga autoriteti licencues dhe mbikëqyrës i vendit ku banka ka selinë e saj;
 - d) vendimi i këshillit drejtues të bankës-mëmë ku është përcaktuar shuma e kapitalit fillestar minimal e dhuruar dhe e paguar (kontributi në para) e cila nuk mund të jetë më pak se ajo e përcaktuar në nenin 1 pika 1.6.;
 - e) vendimi i këshillit drejtues të bankës-mëmë për emërimin e të paktën dy

administratorëve rezidentë për drejtimin e degës së bankës së huaj. Me administratorë të huaj rezidentë do të kuptojmë shtetasin e huaj i cili disponon leje qëndrimi lëshuar sipas ligjit "Për të huajt" nga autoritetet e imigracionit;

- f) rregullat dhe marrëdhëniet reciproke midis bankës-mëmë dhe degës së bankës apo filialit të saj.
- 2. Veprimtaritë bankare dhe financiare që do të kryejë filiali apo dega e bankës së huaj përcaktohen në mbështetje të nenit 26 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" mbi bazën e kapitalit të dhuruar e të paguar për kontributin në para nga banka e huaj.
- 3. Degës së bankës së huaj të licencuar nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarisë bankare, që nuk kryhet nga banka-mëmë.
- 4. Banka e huaj, e cila kërkon të hapë një filial apo një degë në Shqipëri deklaron se është e gatshme t'i sigurojë Bankës së Shqipërisë:
 - a. çdo lloj informacioni lidhur me gjendjen e saj financiare të konsoliduar, për qëllime të mbikëqyrjes bankare;
 - b. një informacion për zhvillimet ekonomike aktuale dhe perspektive të vendit të origjinës;
 - c. informacion lidhur me klasifikimin e bankës sipas shoqërive ndërkombëtare të pavarura të specializuara për vlerësimin e bankave dhe të institucioneve financiare (International Rating Agency);
 - d. informacion lidhur me çdo ndryshim të rëndësishëm në administrimin, strategjinë, strukturën e pronësisë, gjendjen financiare të bankës.
- 5. Banka e huaj, që propozon të zotërojë më shumë se 10 për qind të kapitalit të nënshkruar të një banke, të jetë e autorizuar nga autoritetet përkatëse në vendin e saj për të kryer veprime të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave në para ose në fonde të tjera të ripagueshme në vendin ku drejtorja e saj qendrore ka selinë.

4.3. Për administratorët e bankës.

Në Bankën e Shqipërisë paraqitet lista e administratorëve të propozuar të -bankës duke përcaktuar:

- anëtarët e këshillit drejtues,
- anëtarët e komitetit të kontrollit,
- dy drejtuesit kryesorë ekzekutivë.

Për secilin prej këtyre administratorëve paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) lista e bizneseve ku ata kanë pjesëmarrje, duke përfshirë si ato biznese ku zotërojnë aksione/kuota ashtu edhe ato me të cilët kanë lidhje të tjera, e shoqëruar me informacionin përkatës me të dhënat për veprimtarinë e tyre tregtare ose profesionale për 7 vitet e fundit;
- b) lista e bizneseve ku ata kryejnë funksione drejtuese;
- c) raportet financiare aktuale të bizneseve ku kanë pjesëmarrje influencuese apo në të cilat ata kanë funksione drejtuese;
- d) kopje të vendimit të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve për zgjedhjen e administratorëve;

Përveç të dhënave të mësipërme, për administratorët e bankës do të mbahen parasysh të gjitha kërkesat e parashtruara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja".

4.4. Planbiznesi i bankës së propozuar.

Aksionerët direktë të bankës së propozuar do të paraqesin planin e veprimtarisë bankare për 3 vitet e para të saj ku të përfshihen:

- a) vlerësimi i sistemit bankar, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;

- b) strategjia e bankës së propozuar, objektivat dhe pozicioni i saj në treg;
- c) veprimtaritë bankare dhe financiare që propozon të kryejë dhe objektivat për të ardhmen;
- d) struktura e organizimit të bankës së propozuar. Ajo të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos pengojë mbikëqyrjen e bankës nga Banka e Shqipërisë, në mënyrë të vetme ose të konsoliduar, dhe që mbikëqyrësi të ketë mundësi të marrë informacionin e duhur;
- e) parashikimi i gjendjes financiare të bankës së propozuar, për 3 vitet e para të aktivitetit të saj (bilancet kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, *cash flow*, plani i amortizimit të shpenzimeve paraoperacionale, plani i shpërndarjes së fitimit ose i mbulimit të humbjeve etj.).

Në planbiznesin dhe në llogaritjen e treguesve të biznesit duhet të mbahen parasysh kërkesat e neneve nr. 30 dhe 31 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.98, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

ENI 5

VERIFIKIMI I DOKUMENTEVE DHE AFATET

- 5.1. Banka e Shqipërisë bën verifikimin e plotësimit të dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
- 5.2. Data e pranimit të kërkesës për licencë, konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim, nga Departamenti i Mbikëqyrjes, kërkuetit dhe që nga ky moment fillon llogaritja e afatit tremujor të përcaktuar në nenin 10, pika 1 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 5.3. Banka e Shqipërisë, brenda tre muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, jep ose refuzon miratimin paraprak për licencë dhe njofton me shkrim kërkuetin për vendimin e saj.
- 5.4. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, nuk përmbush kërkesat e ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë do të dërgojë një njoftim për mangësitë, për konfliktet me ligjin si dhe do të kërkojë informacion shtesë.
- 5.5. Mangësitë dhe vërejtjet e tjera të konstatuara në dokumentacionin e paraqitur sipas kësaj rregulloreje, të mënjanohen brenda një muaji nga data e njoftimit të tyre. Në rast të kundërt, dokumentet e paraqitura i kthehen personit që ka paraqitur kërkesën.
- 5.6. Banka e Shqipërisë, publikon një njoftim për kërkesën e paraqitur për të marrë licencë për të kryer aktivitetet bankar, së bashku me emrat e aksionerëve dhe të administratorëve kryesorë të bankës.

ENI 6

MIRATIMI PARAPRAK APO REFUZIMI I KËRKESËS PËR LICENCË

- 6.1. Departamenti i Mbikëqyrjes përgatit informacionin dhe jep opinionet për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, lidhur me kërkesën e paraqitur, pasi:
 - a) ka analizuar të gjithë informacionin e siguruar nëpërmjet materialit të paraqitur, duke

- b) bërë dhe verifikime;
- b) ka organizuar takime me administratorët e propozuar të bankës për të diskutuar objektivat e kësaj banke në treg, planbiznesin e paraqitur, kapitalizimin e propozuar të bankës, organizimin e bankës, projektet financiare të bankës për tre vitet e ardhshme, politikat kryesore të propozuara etj.;
- c) ka vlerësuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur duke konsideruar edhe takimin e organizuar dhe sigurohet që plotësohet kualifikimi i nevojshëm i administratorëve të bankës;
- d) ka vlerësuar transparencën e strukturës së kapitalit aksioner të bankës;
- e) ka vlerësuar në bazë të planbiznesit të paraqitur të renë që do të sjellë banka në treg si dhe parashikimin e mbijetesës së saj në kushtet e ekzistencës së konkurrencës së lirë në treg;
- f) ka vlerësuar burimin e krijimit të kapitalit dhe strukturën e tij. Në qoftë se nuk krijon bindjen se kapitali rrjedh nga një veprimtari i ligjshme, kjo do të ishte një arsye për të rekomanduar refuzimin e kërkesës;
- g) ka vlerësuar strukturën organizative të bankës së propozuar;
- h) ka vlerësuar planbiznesin e paraqitur, nëse ai është real dhe bindës; në rast të kundërt, kjo përbën një arsye për të rekomanduar refuzimin e kërkesës;
- i) ka analizuar të ardhurat e parashikuara të bankës, duke synuar që banka të jetë me fitim të programuar brenda periudhës trevjeçare;
- j) ka vlerësuar rrezikun që parashikon të ndërmarrë banka për periudhën trevjeçare, sipas planbiznesit të paraqitur, për të krijuar bindjen nëse banka do të zhvillojë një aktivitet të sigurt dhe të suksesshëm;
- k) ka vlerësuar dhe ka verifikuar opinionet e dhëna nga publiku për kërkesën e paraqitur;
- l) ka vlerësuar cilësinë e komitetit drejtues dhe të stafit ekzekutiv të propozuar;
- m) ka vlerësuar mundësinë e aksionerëve të propozuar të bankës për të shtuar kapitalin, në qoftë se do të jetë i nevojshëm për të mbuluar humbjet që mund të rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë bankare.

Departamenti i Mbikëqyrjes këkon ndryshimin e emërimit të bankës së propozuar kur ky krijon një konfuzion në publik ose midis bankave ekzistuese.

- 6.2. Departamenti i Mbikëqyrjes në informacionin dhe në opinionet për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, për kërkesën e një banke të huaj për të hapur degë apo filial në Republikën e Shqipërisë, përveç kërkesave të pikës 6.1., përfshin edhe të dhënat e mëposhtme për vendin e origjinës:
 - a) kushtet ekonomike dhe politike;
 - b) sistemin financiar dhe pozicionin në treg të kësaj banke;
 - c) skemën e mbikëqyrjes bankare dhe aftësinë e autoritetit të mbikëqyrjes bankare për ushtrimin e këtij funksioni;
 - d) praktikat e kontabilitetit që zbatohen.
- 6.3. Vendimi për dhënien ose për refuzimin e miratimit paraprak për licencë merret nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 10, pika 2 e ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 6.4. Dhënia e miratimit paraprak të licencës ose refuzimi për ta dhënë atë, së bashku me arsyet e këtij refuzimi, i bëhet e njohur me shkrim kërkuarit nga Banka e Shqipërisë brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune, pas marrjes së vendimit përkatës.
- 6.5. Në vendimin e miratimit paraprak për licencë, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përcaktojë kërkesa dhe kushte të arsyetuara shtesë, që duhet të plotësojë banka për të marrë licencën për fillimin e veprimtarisë së saj.

ENI 7

DHËNIA E LICENCËS

- 7.1. Banka ose dega e bankës së huaj të cilës i është dhënë miratimi paraprak, brenda intervalit kohor njëvjeçar, që fillon nga data e dhënies së miratimit paraprak do t'i kërkojë me shkrim, Bankës së Shqipërisë dhënien e licencës përfundimtare, duke paraqitur edhe dokumentacionin e mëposhtëm :
 - 7.1.1. dokumentin bankar që vërteton pagimin e shumës së kapitalit fillestar për kontributin në para apo për transferimin efektiv të shumës së kapitalit fillestar për kontributin në para të dhuruar degës së bankës së huaj;
 - 7.1.2. aktin e regjistrimit si person juridik të bankës ose të degës së bankës së huaj;
 - 7.1.3. statutin e bankës, aktin e themelimit, shoqëruar me politikat, me procedurat dhe me rregulloret e brendshme të miratuara nga këshilli drejtues i bankës, të cilat duhet të jenë në përputhje me statutin e saj dhe me rregulloret e nxjerra nga Banka e Shqipërisë;
 - 7.1.4. kopje të vendimit të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve dhe të këshillit drejtues të bankës për marrjen në punë të administratorëve të saj, dhe një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tyre së bashku me specimenet dhe me limitet e nënshkrimit për secilin prej tyre;
 - 7.1.5. aktin e pronësisë ose kontratën e qirasë, për lokalet ku do të kryhen operacionet bankare;
 - 7.1.6. dokumentet e blerjes ose kontratat e qirasë dhe të dhëna të detajuara për pajisjet që do të përdoren për kryerjen e operacioneve bankare (kompjutera, programe, swift, telekse, telefona, fakse etj.), për shkallën e automatizimit të proceseve të veprimtarisë, për mundësinë e kontrollit dhe standardizimi i informacionit që i jepet drejtuesve të bankës dhe Bankës së Shqipërisë për operacionet e bankës;
 - 7.1.7. vendimi i këshillit drejtues të bankës ose të degës së bankës së huaj për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar dhe kontrata e lidhur me të si dhe të dhëna për emrin, mbiemrin, emërtimin e shoqërisë, adresën, numrin dhe datën e licencës si dhe për organin ligjor që e ka lëshuar;
 - 7.1.8. dokumente të tjera të lëshuara nga organet kompetente, ku të tregohet nëse lokalet e bankës i plotësojnë kërkesat për siguri dhe mbrojtje, si dhe lehtësi të tjera komunikuese dhe mbrojtjeje;
 - 7.1.9. një vërtetim mbi sigurimin nga zjarri të lokaleve të bankës, të lëshuar nga organet kompetente për parandalimin e zjarreve.
- 7.2. Për filialin ose për degën e një banke të huaj, banka-mëmë nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit midis bankës-mëmë dhe Bankës së Shqipërisë, lidhur me dërgimin e informacionit periodik për gjendjen financiare të bankës-mëmë, për qëllime të mbikëqyrjes bankare të konsoliduar. Paraqitet memorandum i nënshkruar.
- 7.3. Banka e Shqipërisë, para dhënies së licencës organizon një verifikim në vend të kushteve në të cilat banka do të zhvillojë aktivitetin, për të përcaktuar nëse janë kryer përgatitjet e nevojshme për fillimin e aktivitetit. Verifikimi ka për qëllim të vlerësojë nëse banka ose dega e bankës së huaj ka krijuar kushte për ruajtjen e fondeve, disponon materialet e printuara të nevojshme për kryerjen e aktivitetit bankar si dhe nëse janë krijuar kushte për shërbimin ndaj klientit, e të tjera.
- 7.4. Nëse banka, brenda një viti nga data e marrjes të vendimit për miratimin paraprak të kërkesës për licencë, nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 7.1 për marrjen e licencës, miratimi paraprak i kërkesës për licencë bëhet i pavlefshëm, me përjashtim të rasteve kur ky afat është shtyrë me vendim të Bankës së Shqipërisë. Në rast se banka edhe pas shtyrjes së afatit nuk i plotëson kërkesat e mësipërme humbet të drejtën për marrjen e licencës.
- 7.5. Nëse kushtet e përcaktuara në pikën 7.1 të kësaj rregulloreje plotësohen dhe nëse nga verifikimi në vend, Banka e Shqipërisë bindet se ekzistojnë kushte për të ushtruar veprimtarinë bankare, atëherë me vendim të Këshillit Mbikëqyrës jep licencën për të vepruar si bankë.

NENI 8

PUBLIKIMI

Dhënia e licencës, për të vepruar si bankë, publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në një ose më shumë nga gazetatat kryesore të vendit me tirazh më të madh.

NENI 9

INFORMACION PËR FAKTE TË TJERA

- 9.1. Faktet e reja e rrethanat e konstatuara pas dhënies së miratimit paraprak si dhe ndryshimet që ato sjellin në dokumentet e paraqitura të cilat kanë shërbyer si bazë për miratimin paraprak do t'i njoftohen me shkrim Bankës së Shqipërisë.
- 9.2. Njoftimi sipas paragrafit 9.1 do të bëhet brenda 15 ditëve, pas ndodhjes së faktit ose konstatimit të rrethanave përkatëse.

NENI 10

REVOKIMI I LICENCËS

- 10.1. Licenca e bankës ose e degës së bankës revokohet vetëm me vendim të Bankës së Shqipërisë kur:
 - a) kërkohet nga vetë banka e licencuar ose nga banka-mëmë për degët e bankave të huaja;
 - b) ka shkelje të nenit 44, pika 2 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
 - c) vëtetohen rastet e parashikuara në paragrafin 2 dhe në pikën 3 të nenit 13, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
 - d) vëtetohen rastet e parashikuara në paragrafin 1 të nenit 51 dhe në paragrafin 1/a të nenit 56, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 10.2. Banka e Shqipërisë vendos revokimin e licencës së bankës ose të degës së bankës sipas pikës 10.1. shkronja a, brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës me shkrim nga banka ose nga dega e bankës së huaj.
- 10.3. Vendimi për revokimin e licencës i komunikohet menjëherë, me shkrim, bankës përkatëse ose degës së bankës së huaj, duke parashtruar edhe arsyet e revokimit.
- 10.4. Vendimi për revokimin e licencës publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në një ose më shumë nga gazetatat kryesore të vendit me tirazh më të madh. Vendimi i revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
- 10.5. Banka ndalohet të angazhohet në veprimtari bankare e financiare pas hyrjes në fuqi të vendimit të revokimit të licencës dhe detyrohet të likuidojë, sa më parë që të jetë e mundur, aktivet e saj, të zgjidhë marrëdhëniet kontraktore mbi depozitat pa afat dhe të shlyejë detyrimet e saj. Gjatë kësaj kohe banka vazhdon të jetë subjekt i ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", njësoj sikur të ishte e licencuar.

NENI 11

REGJISTRIMI NË BANKËN E SHQIPËRISË

- 11.1. Në mbështetje të nenit 12 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë mban një regjistër për konsultim nga publiku, ku regjistrohen të gjitha licencat bankare të dhëna sipas kësaj rregulloreje.
- 11.2. Në këtë regjistër regjistrohen emri, adresat e selisë dhe të degëve, duke përfshirë emrat dhe adresat e administratorëve dhe të aksionerëve me pjesëmarrje influencuese, si dhe kopjet aktuale të dokumenteve të renditura në nenin 18 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 11.3. Një kopje e këtij regjistri mbahet për konsultim publik në çdo degë të Bankës së Shqipërisë.
- 11.4. Me revokimin e licencës bëhet dhe çregjistrimi nga regjistri i bankës ose i degës së bankës. Një listë e licencave të revokuara mbahet në një fletë të veçantë.

NENI 12

KËRKESAT PËR ZGJERIMIN OSE PËR PAKËSIMIN E RRJETIT TË BANKËS BRENDA TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- 12.1. Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", banka ka të drejtë të hapë degë, agjenci ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Për këtë, banka duhet t'i paraqesë një njoftim me shkrim Bankës së Shqipërisë, duke e shoqëruar me këto të dhëna:
 - a) vendndodhja dhe zona e veprimtarisë së degës, të agjencisë ose të zyrës së përfaqësimit të propozuar;
 - b) një kopje të rregullores së degës, të agjencisë ose të zyrës së përfaqësimit të propozuar për funksionet, për detyrat dhe për llojet e operacioneve bankare që do të kryhen;
 - c) një përshkrim të shkurtër të kompetencave të drejtuesit kryesor;
 - d) planin e veprimtarisë së degës, të agjencisë ose të zyrës bankare, duke pasqyruar në mënyrë të veçantë parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, bilancin kontabël dhe *cash flow-n* për vitin në vazhdim dhe për dy vitet e ardhshme.
- 12.2. Banka e Shqipërisë, pasi njoftohet për zgjerimin ose për pakësimin e numrit të degëve, të agjencive dhe të zyrave të përfaqësimit të bankës në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtë të kundërshtojë këtë veprim brenda një muaji pas marrjes së njoftimit, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë sipas pikës 12.1.
- 12.3. Vendimi për refuzimin e kërkesës për zgjerimin e numrit të degëve, të agjencive e të zyrave të përfaqësimit të bankës, merret nga administratorët e Bankës së Shqipërisë kur ky zgjerim kërcënon pozitën organizative, financiare dhe mbikëqyrjen e bankës apo strukturën e tregut sipas parimit të konkurrencës.
- 12.4. Në qoftë se Banka e Shqipërisë nuk paraqet kundërshtim, për zgjerimin e rrjetit të bankës, brenda një muaji pas marrjes së njoftimit dhe plotësimit të dokumentacionit sipas pikës 12.1, organizon një inspektim në vend për të verifikuar krijimin e kushteve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit bankar. Mosplotësimi i këtyre kushteve është një arsye për refuzimin e kërkesës.

NENI 13

KËRKESAT PËR ZGJERIMIN OSE PËR PAKËSIMIN E RRJETIT TË BANKËS JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- 13.1. Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", banka ka të drejtë të hapë filiale, degë, agjenci ose zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me miratim të Bankës së Shqipërisë. Për këtë, banka duhet t'i paraqesë një kërkesë me shkrim Bankës së Shqipërisë, duke e shoqëruar kërkesën me këto të dhëna:
- 13.1.1. Për hapjen e një dege të bankës:
- a) vendimin e organit vendimmarrës të bankës për kryerjen e këtij investimi jashtë Republikës së Shqipërisë;
 - b) vendndodhjen dhe zonën e veprimtarisë të degës, të agjencisë ose të zyrës së përfaqësimit të propozuar;
 - c) një kopje të rregullores së degës, të agjencisë ose të zyrës së përfaqësimit të propozuar për funksionet, për detyrat dhe për llojet e operacioneve bankare që do të kryhen;
 - d) një përshkrim të shkurtër të kompetencave të drejtuesit kryesor;
 - e) parashikimin, nga ana e bankës, të rezultatit financiar të saj, si pasojë e kësaj shtrirjeje dhe ndikimin e tij në gjendjen financiare të bankës;
 - f) informacionin për personin e propozuar si drejtues të degës, sipas rregullores "Për kriteret që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja" dhe numrin e punonjësve të propozuar;
 - g) kohëzgjatjen e parashikuar të veprimtarisë së degës;
 - h) emërtimin, e propozuar për t'u përdorur nga dega, që duhet të korrespondojë me emërtimin e bankës-mëmë, duke shtuar shprehjen degë e kësaj banke në vendin përkatës.
- 13.1.2. Për hapjen e një filiali:
- a) vendimin e organit vendimmarrës të bankës për kryerjen e këtij investimi jashtë Republikës së Shqipërisë;
 - b) vendndodhjen dhe zonën e veprimtarisë së filialit të propozuar;
 - c) parashikimin, nga ana e bankës, të rezultatit financiar të saj, si pasojë e kësaj shtrirjeje dhe ndikimin e tij në gjendjen financiare të bankës.
 - d) planbiznesin e filialit të bankës për tre vitet e para të aktivitetit të tij;
 - e) informacion për dy administratorët kryesorë të filialit sipas rregullores "Për kriteret, që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja";
 - f) shumën e kapitalit për t'u investuar jashtë vendit;
 - g) informacion për emrin, vendqëndrimin ose selinë dhe të dhënat tregtare të vitit të fundit të çdo personi, që do të zotërojë pjesëmarrje influencuese në filial;
 - h) veprimtaritë financiare, që filiali parashikon të kryejë.
- 13.2. Banka e Shqipërisë jep miratimin, brenda 2 muajve pas marrjes së kërkesës, për kryerjen e investimit nga ana e bankës jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm kur pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotësuar sipas pikës 13.1.1 apo 13.1.2. sipas rastit, krijon bindjen se:
- a) kapitali bazë i bankës (sipas përcaktimit të bërë në Rregulloren " Për kapitalin rregullator") është jo më i vogël se shuma e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për hapjen e një banke në Republikën e Shqipërisë, të publikuar nga Banka e Shqipërisë në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë;
 - b) gjendja financiare e bankës, që ushtron aktivitetin bankar në Shqipëri, është e kënaqshme (klasifikimi 1 ose 2 sipas sistemit "CAMELS");
 - c) niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës, pas investimit jashtë vendit, nuk bie nën 12 për qind;

- d) banka edhe pas këtij investimi angazhohet se do të vazhdojë të jetë rentabël, mbështetur në planbiznesin për tre vitet e para pas investimit;
 - e) banka ka një nivel të tillë drejtimi dhe administrimi që të monitorojë edhe këtë rezik që ndërmerr me investimin (klasifikimi i administrimit të jetë 1 ose 2 sipas sistemit ("CAMELS").
- 13.3 Në rastet kur, Banka e Shqipërisë refuzon kërkesën e bërë nga banka për të investuar jashtë Shqipërisë, e shoqëron atë me arsyet përkatëse, duke u bazuar në kriteret e parashikuara në pikën 13.2 të kësaj rregulloreje.
- 13.4. Kufizimet.
- a) Degët e bankave, që lejohet të hapen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë l e johen të kryejnë vetëm ato veprimtari që janë njohur në aneksin e licencës së bankës-mëmë.
 - b) Bankat, që kanë të hapura degë dhe filiale jashtë vendit paraqesin në Bankën e Shqipërisë raporte të konsoliduara, sipas të gjitha parimeve standarde të njohura dhe të pranuara.
 - c) Degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare në Shqipëri, nuk kanë të drejtë të hapin njësi të tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 13.5. Degët e bankave, që lejohet të hapen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë janë subjekt i sistemit rregullator të mbikëqyrjes bankare nga Banka e Shqipërisë.
- 13.6. Në rast se banka investon jashtë Shqipërisë pa miratimin e Bankës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë vepron ndaj saj në përputhje me nenin 44 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

NENI 14

KOMISIONET

Banka e Shqipërisë në mbështetje të nenit 11, pika 4 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" vendos komisionet e mëposhtme:

- 14.1. Në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencë, kërkuesi paguan në Bankën e Shqipërisë një komision prej 300.000 lekësh.
- 14.2. Në momentin e dhënies së licencës kërkuesi paguan në Bankën e Shqipërisë një komision, prej 200.000 lekësh.
- 14.3. Këto komisione janë të parimbursueshme.

NENI 15

BASHKIMI, SHKRIRJA, NDARJA DHE SHITJA E AKTIVEVE TË BANKËS

- 15.1. Në rast se një bankë kërkon të bashkojë, të shkrijë, të ndajë ose të shesë aktivet e saj duhet t'i drejttojë një kërkesë me shkrim Bankës së Shqipërisë ku të sqarohen arsyet e bashkimit, të shkrirjes, të ndarjes ose të shitjes. Vetëm pas marrjes së këtij pëlqimi nga Banka e Shqipërisë, banka lejohet të fillojë procedurat për të marrë vendimet e nevojshme lidhur me bashkimin, me shkrirjen, me ndarjen ose me shitjen.

- 15.2. Vendimi i marrë për bashkimin, për shkrirjen, për ndarjen dhe për shitjen në një masë të konsiderueshme (10 për qind) të aktiveve të bankës, hyn në fuqi pas miratimit nga Banka e Shqipërisë. Vendimi bazohet në kriteret e parashikuara në nenet 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, si në rastin e një licencimi të ri.
- 15.3. Kërkesa që paraqitet në Bankën e Shqipërisë për marrjen e miratimit të mësipërm shoqërohet me:
- marrëveshjen (kontratën) e bashkimit, të shkrirjes, të ndarjes dhe të shitjes së aktiveve të bankës;
 - raportin e ekspertit kontabël lidhur me vendimin për bashkimin, për shkrirjen, për ndarjen dhe për shitjen e aktiveve të bankës, si dhe për zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar për këtë qëllim;
 - përshkrimin e përparësive të organizimit të ri me theks të veçantë në rezultatet e aktivitetit.
- 15.4. Për rastet kur bashkimet, ndarjet dhe shkrirjet çojnë në krijimin edhe të një banke të re, kjo e fundit do t'i nënshtrohet të gjitha rregullave për licencimin si e tillë në bazë të neneve 9 dhe 10 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të dispozitave përkatëse të kësaj rregulloreje.
- 15.5. Banka e Shqipërisë, pas marrjes së kërkesës publikon njoftimin për kërkesën e paraqitur nga ana e bankës për bashkimim, për ndarjen, për shkrirjen apo për shitjen e aksioneve të bankës apo të aktiveve të saj.
- 15.6. Banka e Shqipërisë miraton ato bashkime, shkrirje, ndarje dhe shitje në një masë të konsiderueshme të aktiveve të bankës, që veç të tjerash, nuk vendosin strukturat monopoliste të tregut bankar dhe nuk rrezikojnë pozicionin e depozituesit.
- 15.7. Afati maksimal, për shqyrtimin e dokumentacionit dhe për miratimin ose për refuzimin e bashkimit, të shkrirjes, të ndarjes dhe të shitjes në një masë të konsiderueshme të aktiveve të bankës, është tre muaj nga plotësimi i dokumentacionit.

NENI 16

KËRKESAT PËR LICENCË PËR ZYRË PËRFAQËSIMI

- 16.1. Bankat e huaja, që duan të hapin zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë, do të marrin paraprakisht një miratim nga Banka e Shqipërisë. Për të hapur një zyrë përfaqësimi, kërkuuesi duhet të paraqesë në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:
- lejen e ushtrimit të veprimtarisë bankare të dhënë nga autoritetet përkatëse të vendin ku ndodhet selia e bankës;
 - aktin e themelimit dhe statutin e bankës me ndryshimet përkatëse, duke përfshirë të dhënat për adresën e saktë të selisë, përshkrimin e veprimtarisë, dokumentin ligjor që vërteton shumën e fundit të kapitalit, listën e aksionerëve dhe shpërndarjen e aksioneve, formën e drejtimit të bankës dhe administratorët e saj, raportin vjetor më të fundit të bankës;
 - kohëzgjatjen e parashikuar të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë, emërtimin e zyrës që do të hapet, adresën e saj dhe numrin e telefonit;
 - ç) qëllimin e krijimit të saj;
 - d) emrat e personave të propozuar për drejtues të zyrës së përfaqësimit dhe *curriculum vitae* të tyre (arsimin, profesionin, eksperiencën etj.) dhe numrin e punonjësve të zyrës;
 - e) aktin e regjistrimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë;
 - f) vendimin e organit kompetent të bankës për hapjen e një zyre përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë.

- 16.2. Emërtimi i përdorur nga zyra e përfaqësimit e një banke të huaj duhet të korrespondojë me emrin e bankës mëmë duke shtuar fjalët "zyrë përfaqësimi në Shqipëri".
- 16.3. Afati maksimal i shqyrtimit të këtij dokumentacioni dhe dhënia e miratimit ose jo nga Banka e Shqipërisë do të jetë brenda dy muajve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe plotësimit të dokumentacionit konform pikës 16.1 të këtij neni.
- 16.4. Zyra e përfaqësimit duhet të paraqesë në Bankën e Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes) informacion mbi çdo ndryshim në karakteristikat e saj kryesore, si dhe në çdo fund viti një raport të saj vjetor duke përfshirë aktivitetin e kryer dhe ndryshimet në stafin e zyrës.

NENI 17

TRANSFERIMI I PRONËSISË MBI AKSIONET NË MASËN NË OSE MBI 10 PËR QIND TË KAPITALIT TË NJË BANKE

- 17.1. Transferimi i pronësisë mbi aksionet në masën në ose mbi 10 për qind të kapitalit të një banke në Republikën e Shqipërisë, bëhet vetëm pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë.
- 17.2. Banka, e cila kërkon të bëjë ndryshime në strukturën e aksionerëve të saj, pas miratimit të këtij ndryshimi nga asambleja e aksionerëve, i drejtohet Bankës së Shqipërisë për të marrë miratimin paraprak.
- 17.3. Kërkesa e paraqitur në Bankën e Shqipërisë shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar në pikat 4.2.1., 4.2.2. dhe 4.2.3. të kësaj rregulloreje.
- 17.4. Aksioneri i ri i propozuar duhet të deklarojë se do të ruajë interesat e klientëve të bankës dhe fondet e destinuar për blerjen e aksioneve nuk burojnë nga hua, nga kredi dhe nga paradhënie prej burimeve të tjera.
- 17.5. Pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, Banka e Shqipërisë, publikon njoftimin për kërkesën e paraqitur për ndryshimin në listën e aksionerëve të bankës.
- 17.6. Banka e Shqipërisë jep miratimin ose refuzon transferimin e pronësisë mbi aksionet e bankës jo më vonë se dy muaj nga data kur dokumentacioni është paraqitur i plotë.

NENI 18

DISPOZITA TRANZITORE

Për kërkesat, e paraqitura në Bankën e Shqipërisë për marrjen e licencës për të ushtruar veprimtari bankare nga subjekte të ndryshme, përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe që u është komunikuar me shkrim nga Banka e Shqipërisë se kanë plotësuar të gjithë dokumentacionin sipas kërkesave të rregullores "Për dhënie e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë", të miratuar me vendimin nr.173, datë 02.12.1998 të Këshillit Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë nuk do të zbatohet rregullorja e re, por do të vazhdojë zbatimin e rregullores së miratuar me vendimin nr.173, datë 02.12.1998.

NENI 19

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 19.1. Pjesë e pandarë e kësaj rregulloreje janë formularët bashkëlidhur.

- 19.2. Rregullorja "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" e miratuar me vendimin nr.173, datë 02.12.1998, ndryshuar me vendimin nr. 43, datë 31.03.1998, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.
- 19.3. Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.71, datë 11.09.2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

***KRYETARI
KËSHILLIT MBIKËQYRËS***

SHKËLQIM CANI

KËRKESE

PËR
BANKËN E SHQIPËRISË
LIDHUR ME AUTORITETIN PËR TE DHËNË LICENCË
PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE
NË MBËSHTETJE TË NENIT 10, LIGJI NR. 8365 DATË 2.07.1998
"PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Emri i bankës së propozuar

Banka : _____

(Vendndodhje e propozuar : Adresa)

_____, Shqipëri
(Qyteti) (Rrethi)

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë angazhohemi për zbatimin e ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe legjislacionin shqiptar.

Bankën e propozuar mendojmë ta emërtojmë si më sipër pasi

Kërkuesit

Ps. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme :

Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Sheshi Skënderbej Nr. 1
Tiranë, Shqipëri.

**VENDIMI
I KËSHILLIT DREJTUES
PËR CAKTIMIN E KORRESPONDENTËVE**

Këshilli drejtues i propozuar vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, këshilli drejtues i propozuar emëron dhe përcakton si korrespondentë :

| | | |
|---------------------|---------------------------|-----------|
| (Emri) | (Atësia) | (Mbiemri) |
| Adresa: _____ | | |
| (Rruga, Numri) | (Qyteti) | (Shteti) |
| (Numri i telefonit) | (Numri i faksit/teleksit) | |

Korrespondenti i mësipërm është i autorizuar të përfaqësojë bankën e propozuar dhe të paraqitet të nënshkruajë para Bankës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë, do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e këshillit drejtues. Korrespondenti është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbushë të gjitha synimet dhe qëllimet siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Banka e Shqipërisë .

Korrespondenti i emëruar mund të ndryshohet me rezolutë të pranuar nga pjesa më e madhe e nënshkruesve, rezolutë e cila do të vërtetohet në Bankën e Shqipërisë nga nënshkruesit që votojnë për të njëjtën gjë.

Datë _____,

(Emri mbiemri)

(Nënshkrimi)

| | |
|--|--|
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |

Shënim : Ky formular duhet të vërtetohet nga noteri.

NJOFTIM I APLIKIMIT
TË PARAQITUR NË BANKËN E SHQIPËRISË
PËR MARRJEN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI
BANKARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Aplikantët (emrat e personave)

| | |
|----------|--------------|
| 1. _____ | adresa _____ |
| 2. _____ | adresa _____ |
| 3. _____ | adresa _____ |
| 4. _____ | etj. |

Ne kemi qëllim të krijojmë së bashku një bankë, për këtë kemi paraqitur një kërkesë në Bankën e Shqipërisë për të marrë licencë për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

Bankës së Shqipërisë i është vënë në dispozicion dokumentacioni lidhur me reputacionin, me aktivitetin, me eksperiencën dhe me të dhënat lidhur me projektet që ne kemi në kryerjen e aktivitetit bankar.

Banka e Shqipërisë, për marrjen e vendimit të saj merr në konsideratë një numër faktorësh, ndër të cilët edhe nëse banka e propozuar do të plotësojë nevojat e komunitetit për kredi.

Ne ju ftojmë të paraqisni komentet tuaja për këtë aplikim, me shkrim duke u adresuar:

Bankës së Shqipërisë
Departamenti i Mbikëqyrjes
Sektori i Licencimit dhe Rregullimeve Bankare
Sheshi "Skënderbej" nr.1 Tiranë.

Banka e Shqipërisë është e interesuar të dijë opinionin tuaj dhe do të marrë në konsideratë çdo koment tuajin për këtë aplikim.

Dita e botimit

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. Emri i bankës së propozuar _____
2. Vendndodhja e bankës së propozuar _____

3. Ndarja e propozuar e kapitalit të nënshkruar dhe të autorizuar :
- Kapitali aksioner : (Vlera nominale në Lekë¹)
- Numri i aksioneve të autorizuar : _____
- Numri i aksioneve të emetuara që në çelje : _____
- Paguar më tepër : _____ Leke
- Shuma e kapitalit në çelje Lekë
- Çmimi i shitjes për aksion: _____ Lekë**

4. Këshilli drejtues i bankës (i propozuar):

| (Emër Mbiemër) | (Detyra /Profesioni) | (Qyteti / Shteti) |
|----------------|----------------------|--------------------|
| _____ | _____ | _____ |
| _____ | _____ | _____ |
| _____ | _____ | _____ |
| _____ | _____ | _____ |
| _____ | _____ | _____ |
| _____ | _____ | _____ |
| _____ | _____ | _____ |

5. Administratorët e propozuar të bankës :

EMRI MBIEMRI ADRESA : QYTETI/SHTETI PUNËSIMI AKTUAL

President/drejtor i përgjithshëm

Asistenti i drejtorit të përgjithshëm

**BILANCI I PARASHIKUAR I BANKËS
NË MOMENTIN E FILLIMIT TË AKTIVITETIT
(BILANCI KONTABEL I ÇELJES SË BANKËS)**

Emri i bankës së propozuar : _____

AKTIVET

Arka dhe detyrime nga bankat

Investime

Hua

Hua afatshkurtra

Hua afatmesme

Hua afatgjata

Aktive fikse *

Pajisje të ndryshme *

Aktive të tjera *

TOTALI I AKTIVEVE_____ **LEKË****PASIVET**

Depozitat :

*Depozita pa afat**Depozita me afat***TOTALI I DEPOZITAVE**_____ **LEKË**

Pasive të tjera

LLOGARITË E KAPITALIT

Kapitali i paguar

Fitimet e pashpërndara

TOTALI I LLOGARIVE TË KAPITALIT_____ **LEKË****TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT**_____ **LEKË**

* Për zërat " Aktivet fikse" , "Pajisje të ndryshme" dhe "Aktive të tjera" të paraqiten në mënyrë analitike në pasqyra të veçanta .

BILANCI I PARASHIKUAR I BANKËS
PËR FUNDIN E VITIT _____

KJO DUHET TË PARAQITET PËR TRE VITET E PARA TË AKTIVITETIT

Emri i bankës së propozuar : _____

AKTIVET

Arka dhe detyrime nga bankat

Investime

Hua

Hua afatshkurtra

Hua afatmesme

Hua afatgjata

Aktive fikse *

Pajisje të ndryshme *

Aktive të tjera *

TOTALI I AKTIVEVE _____ **LEKË**

PASIVET

Depozitat :

Depozita pa afat

Depozita me afat

TOTALI I DEPOZITAVE _____ **LEKË**

Pasive të tjera

LLOGARITË E KAPITALIT

Kapitali i paguar

Fitimet e pashpërndara

TOTALI I LLOGARIVE TË KAPITALIT _____ **LEKË**

TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT _____ **LEKË**

* Për zërat " Aktivet fikse" , "Pajisje të ndryshme" dhe "Aktive të tjera" të paraqiten në mënyrë analitike në pasqyra të veçanta .

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE

KJO DUHET TË PARAQITET PËR TRE VITET E PARA TË AKTIVITETIT

Emri i bankës së propozuar: _____

TË ARDHURAT

Të ardhura nga interesat *

Huatë

Investimet

Të ardhura nga jointeresat (Shërbime komisione etj.)

TOTALI I TË ARDHURAVE_____ **LEKË****SHPENZIMET**

Shpenzime për interesa : *

Komisione dhe përfitime
për punonjësit *

Shpenzime neto të tjera *

Shpenzime për pajisje të ndryshme *

Provigjone për humbjet nga huatë

Shpenzime të tjera *

TOTALI I SHPENZIMEVE_____ **LEKË****TË ARDHURAT NETO PARA TAKSAVE**_____ **LEKË**

SHËNIM : Zërat e shënuar me (*) duhet të paraqiten në mënyrë analitike në fletë të veçanta. Paraqitni nivelin e interesave për huatë dhe për depozitat që do të zbatoni.

GJENDJA E FONDEVE KAPITALE

PËR TRE VITET E PARA TË AKTIVITETIT

në lekë

| PËRSHKRIMI | FUNDI I VITIT TË PARË |
|---|--------------------------------------|
| Fondet në dispozicion për fillimin e veprimtarisë | |
| Minus : Shpenzimet e nisjes dhe të organizimit | |
| Fondet neto të kapitalit në fillim të periudhës | |
| Të ardhurat (humbjet) neto | |
| Minus: Dividentët e paguar pronarëve/ aksionerëve | |
| FONDET KAPITALE NË FUND TË PERIUdhËS | |

STRUKTURA E KAPITALIT

Emri i bankës së propozuar: _____

1. STRUKTURA E PROPOZUAR E KAPITALIT TË PAGUAR

| PËRSHKRIMI |
|---|
| Fondet në dispozicion për fillim të veprimtarisë |
| Minus : Shpenzimet e nisjes dhe të organizimit |
| Fondet neto të kapitalit në fillim të periudhës * |
| Ndarja e propozuar e fondit neto të kapitalit |
| Aksionet (Vlera nominale: _____ lekë) (_____ aksione të ar (_____ Aksione të nxjerra) |
| Paguar më tepër (të paktën 20% e kapitalit në lekë) |
| Fitimet e pashpërndara (të paktën 5% të kapitalit në lekë) të tjera të |
| TOTALI I LLOGARIVE TË FONDIT TË KAPITALIT NË DITËN E HAP. |

* Nuk duhet të jetë më pak se shumata minimale e kapitalit fillestar të kërkuar.

2. Arsyeja që aksionet e autorizuara nuk janë nxjerrë.

| | Numri i aksioneve parashikuar për t'u shpërndarë | Pesha Specifike (%) |
|---|---|------------------------|
| 3. Shpërndarja e kapitalit të pronarëve (e propozuar): | | |
| A. Këshillit drejtues të propozuar të drejtorëve dhe të administratorëve. | _____ | _____ |
| B. Interesat e këshillit drejtues dhe të administratorëve. | _____ | _____ |
| C. Nënshkrues individë të tjerë të parashikuar me 10 për qind ose më shumë të kapitalit. | _____ | _____ |
| D. Shoqëritë e regjistruara (ose të propozuara). | _____ | _____ |
| E. Teprica e kapitalit që u është ofruar të tjerëve. | _____ | _____ |
| TOTALI | _____ | 100 |

4. Përkrahja e bërë nga kërkuesi për gjetjen e tregut për shitjen e aksioneve, në qoftë se do të jepet miratimi paraprak nga Banka e Shqipërisë.

STRUKTURA KAPITALIT (vazhdim)

5. Në qoftë se shoqëria e regjistruar, do të nënshkruajë 10 për qind ose më shumë të kapitalit, paraqit sa më poshtë

- A. Emrin dhe adresën e shoqërisë .
- B. Shoqëria është e regjistruar ose shoqëri e propozuar.
- C. Kopje e raporteve vjetore për tre vitet e fundit dhe kushtet jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para datës së aplikimit për të qenë një shoqëri e regjistruar dhe parashikimi i gjendjes që nga dita e hapjes së bankës, për një shoqëri të propozuar.

6. Plotësoni këtë pasqyrë me të gjitha shpenzimet e parashikuara të kryhen për organizimin e bankës. Lista duhet të përfshijë investimet për tokën, për ndërtesën ose përmirësimet e saj.

| Përshkrimi | Shuma (në Lekë) |
|---|-----------------|
| Komision juridik : | |
| _____ | _____ |
| _____ | _____ |
| Komision konsulencë: | |
| _____ | _____ |
| _____ | _____ |
| Shpenzime të vlerësimit | _____ |
| Pagat | _____ |
| Komisionet për aplikimin, për shqyrtimin dhe për regjistrimin | _____ |
| Qira ose taksa të mundshme | _____ |
| Udhëtimet dhe konfortet | _____ |
| Shpenzime zyre e administrative | _____ |
| Shpenzime në lidhje me miratimin nga Banka e Shqipërisë | _____ |
| Shpenzime të tjera (të përshkruara në detaje për shuma mbi 70 mijë lekë) | _____ |
| Llogari të pagueshme në hapje (të përshkruara në detaje për shuma mbi 70 mijë lekë) | _____ |
| Shpenzime të mëvonshme për fillimin (Të përshkruara në detaje për shuma mbi 70 mijë lekë) | _____ |
| TOTALI I SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT | _____ |
| Minus: të ardhurat para hapjes. | (_____) |
| Minus: shpenzimet e lejueshme për kapitalizimin sipas planit unik kontabël | (_____) |
| SHPENZIMET NETO TË ORGANIZIMIT | _____ |

Përshkruaj burimet e të ardhurave para hapjes:

* Paraqit planin e amortizimit për shpenzimet e nisjes.

STRUKTURA E KAPITALIT (vazhdim)

7. Në rast se një person kërkon të jetë nënshkruar i kapitalit aksioner nëpërmjet një oferte publike ose private, kërkuesi duhet të paraqesë një kopje të dokumenteve që do të publikojë si letërqarkore ose si shënim në Departamentin e Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë. Kërkuesi është përgjegjës për përcaktimin e procedurave që do të ndjekë në lidhje me shitjen e aksioneve mbështetur në ligjin "Mbi letrat me vlerë" dhe/ose në ligjin " Për shoqëritë tregtare", që mund të zbatohen.

Përfshihet këtu sigla

_____ (Data kur do të zbatohet).

SHËNIME TË VEÇANTA :

Kërkuesi nuk mund të ofrojë aksionet e tij për t'i shitur ose të kërkojë nënshkrime për aksionet e tij derisa Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë të rishikojë këto materiale.

Banka e Shqipërisë përcakton se materialet duhet të ofrohen nga persona që kanë eksperiencë në këtë fushë. Si pasojë, Banka e Shqipërisë nuk përshkruan një format-tip të një letërqarkoreje. Sidoqoftë, një dokument i tillë minimalisht duhet :

- (a) të jetë në përputhje me ligjin "Mbi letrat me vlerë" dhe/ose me ligjin "Për shoqëritë tregtare";
- (b) të shoqërohet me një kopje të marrëveshjes për nënshkrimin e aksioneve;
- (c) të shoqërohet me materiale të tjera prezantuese në lidhje me faktorët e tjerë të rrezikut ose ndonjë informacion tjetër që gjykohet i nevojshëm dhe që lidhet me ofertën e propozuar;

ADMINISTRATORËT

1.Këshilli i drejtues i propozuar:

| Emri dhe adresa | Detyra |
|------------------------|---------------|
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| TOTALI | |

* Në qoftë se zotëron.

2.Komiteti i administrimit të aktiveve dhe të pasiveve (Presidenti i propozuar /Drejtori i përgjithshëm, në qoftë se dihen). Anëtarë të tjerë të komitetit të administrimit të propozuar mund të jenë të listuar si:

| Emri adresa dhe pozicioni i propozuar | Detyra |
|--|---------------|
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| TOTALI | |

ADMINISTRATORËT (vazhdim)

3. Lista e kualifikimeve për çdo administrator të propozuar që premtojnë se do të administrojnë bankën me sukses. Specifikoni dhe identifikoni çdo eksperiencë si një oficer ose drejtor i një institucioni financiar (duke përfshirë emrin e institucionin titullin, datën e shërbimit etj.) brenda 7 viteve nga data e aplikimit.

4. Është ndonjë nga administratorët i lidhur me ndonjë bankë ose institucion financiar (duke përfshirë çdo institucion tjetër të propozuar) në Shqipëri nëpërmjet punësimit, drejtimit ose pronësisë? Në qoftë se po, përshkruaj në detaje , marrëdhënie të tilla dhe komente për plane të individëve për të vazhduar këto marrëdhënie.

5. Përcakto në qoftë se ndonjë nga administratorët e propozuar të këshillit drejtues është zgjedhur ose është emëruar në sektorin publik. Në qoftë se kështu, përshkruaj këtë pozicion dhe përcakto afatin zyrtar.

6. Paraqit informacion biografik dhe financiar, si të zbatueshëm, për çdo anëtar të propozuar të bordit dhe për presidentin/drejtorin e përgjithshëm të bankës, dhe për çdo person që nënshkruan 10 për qind ose më shumë të aksioneve, në formularët e Bankës së Shqipërisë .

SHËNIM: Informacioni financiar duhet të jetë për një periudhë jo më shumë se 6 muaj më parë se data e këtij aplikimi.

7. A janë dhënë shpërblime, kompensime për administratorët ose për drejtorët, ose plane të tilla të ngjashme a janë propozuar? Në qoftë se PO jep një kopje të këtyre planeve.

Kopje e paraqitur

Nuk zbatohet

PROJEKTSTATUTI I BANKËS

1. Bashkëlidhur një kopje e projektstatutit të bankës së propozuar.

PARA PARAQITJES SË KËTIJ APLIKIMI

1. Rikontrollo të gjitha përgjigjet për të parë në qoftë se ato janë komplet të detajuara dhe nëse janë sigluar siç janë parashikuar.
2. Formularët e ndarë dhe materialet shtesë duhet të mbajnë numrat dhe gërma për të specifikuar formularin, tabelën ose numër të njëjtë në të. Të gjithë formularët e ndarë ose materialet shtesë që kërkojnë siglim duhet të siglohen në çdo fletë. **SIGLA E FOTOKOPJUAR NUK DO TË PRANOHET.**
3. Rikontrollo përmbajtjen e këtij aplikimi kundrejt raporteve të tjera (biografike, financiare etj.) për të parë nëse përputhen.

SHËNIME TË VEÇANTA: Aplikanti është përgjegjës për mosnjohimin e Bankës së Shqipërisë për ndonjë ndryshim që mund të ndodhë gjatë periudhës kur aplikohet, i cili mund të sjellë pas ndryshime, përmirësime ose anulimin e propozimit të aplikantit për t'u paraqitur në Bankën e Shqipërisë (për shembull, ndryshime të kapitalit, të vendndodhjes së bankës, të drejtorëve dhe të administratorëve të saj.)

STATUTI I BANKËS
(Shembull i një statuti)

NËNSHKRUESIT duke vepruar si drejtorë me qëllimin për të formuar një bankë në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë të zbatuar në këtë statut.

NENI 1

Emri i bankës do të jetë _____ dhe vendi fillestar i biznesit do të jetë në _____ në qytetin _____ në rrethin _____ në Shqipëri.

NENI 2

Natyra kryesore e biznesit që do të kryejë kjo bankë do të jetë: Ajo e një pjesëtari të sistemit bankar tregtar të biznesit me të gjitha të drejtat, fuqitë dhe drejtimet e një institucioni bankar.

NENI 3

Numri total i aksioneve të autorizuara për t'u emetuar nga banka do të jetë _____. Të tilla aksione do të jenë të një klase të vetme dhe me një vlerë nominale _____ lekë për aksion. Banka do të fillojë biznesin me të paktën _____ lekë kapital të paguar që do të jetë i ndarë në _____ aksione. Shuma e tepicës me të cilën banka do të fillojë biznesin nuk do të jetë më pak se _____ lekë dhe shuma e fitimeve të pashpërndara jo më pak se _____ lekë.

E gjitha do të jetë paguar në *cash* (kapitali aksioner, teprica dhe fitimi i pashpërndarë).

Çdo aksioner i bankës do të ketë të drejtën të blejë, të nënshkruajë ose të marrë një të drejtë ose të drejta për të blerë ose për të nënshkruar, me çmimin e nënshkrimit të ofruar për publikun, për një pjesë të paracaktuar të çdo aksioni apo të çdo klase që banka mund të emetojë ose të shesë.

NENI 4

Afati për të cilin banka do të ekzistojë është i pakufizuar sipas ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

NENI 5

Numri i anëtarëve të bordit nuk mund të jetë më pak se 3 tre vetë, duke përfshirë ndërprerjet e bëra nga vdekjet, nga paaftësia, nga dorëheqja ose nga pensioni. Drejtorët janë zgjedhur me afate një, dy, ose 3-vjeçare për vazhdim eksperience dhe mund të rizgjidhen. Këshilli drejtues do të zgjedhë një kryetar, i cili do të drejtojë në mbledhje dhe një zëvendës, që do ta zëvendësojë atë kur mungon.

NENI 6

Këshilli drejtues mundet, në qoftë se një veprim i tillë është i autorizuar, në mbledhjet vjetore të aksionerëve, të rrisë numrin e anëtarëve të bordit dhe të emërojnë persona të tjerë në vendin e atyre që mungojnë.

RAPORTI FINANCIAR PERSONAL SEKRET *

DO TË PLOTËSOHET NGA ÇDO THEMELUES I BANKËS DHE ÇDO NËNSHKRUES ME
10 për qind OSE MË SHUMË TË KAPITALIT AKSIONER.

GJENDJA FINANCIARE MË _____
(Datë)

Depozituar nga :

1. Për personat fizikë shënohet: emri, atësia, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, nënshtetësia dhe adresa e vendbanimit.

Për

DEPARTAMENTIN E MBIKËQYRJES
TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në lidhje me:

(Arsyet e veçanta të paraqitjes së këtij raporti)

INSTRUKSIONE:

Shtypni ose printoni këtë raport. Përgjigjuni të gjitha pyetjeve plotësisht. Në qoftë se përgjigjia është "Jo", ose "Asnjë" ose "E pazbatueshme", lutemi paraqiteni këtë . Në qoftë se hapësira është e pamjaftueshme, i bashkëlidhni një pasqyrë të veçantë këtij formulari. Informacioni në pasqyrën e veçantë duhet të shënohet me numra dhe me gërma për t'iu përshtatur këtij formulari dhe të gjitha pasqyrat duhet të nënshkruhen dhe të datohen.

Një raport i pasaktë dhe jo i plotë nuk pranohet dhe është shkak për të refuzuar kërkesën për licencë.

Çdo faqe e informacionit në RAPORTIN FINANCIAR PERSONAL SEKRET duhet të nënshkruhet, të datohet nga individi që e plotëson atë dhe të noterohet tek një noter publik.

Për të sqaruar ndonjë pyetje në lidhje me këtë RAPORT personi që e ka plotësuar do të kontaktojë direkt me Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes.

* TË GJITHA TË DHËNAT TË JEPEN NË LEK SHQIPTAR. PËRSHKRUI METODËN E PËRDORUR NË KËMBIMIN E MONEDHËS DHE SHËNONI KURSIN E KËMBIMIT.

GJENDJA E TË ARDHURAVE

| | | |
|--|-----------|-----------|
| TË ARDHURA | | 200____ |
| Pagat, pagesat dhe kompensimet për punonjësit | 200____ | |
| Dividenti dhe të ardhurat nga interesat | _____lekë | _____lekë |
| Të ardhurat neto nga qira dhe investime. | _____ | _____ |
| Të ardhura të tjera | _____ | _____ |
| TOTALI I TË ARDHURAVE* ZBRITJE | _____ | _____ |
| Zbritje dhe rregullime | _____ | _____ |
| Taksat për të ardhurat | _____ | _____ |
| TOTAL I ZBRITJEVE | _____ | _____ |
| TË ARDHURAT NETO (Totali i të ardhurave minus zbritjet) | _____ | _____lekë |
| * Shpjego raste të veçanta për vitin e parë | _____lekë | |

Në qoftë se një nga arsyet për të plotësuar këtë raport është përfshirja në blerjen e aksioneve, plotëso informacionin që vjen pas :

Shuma e aksioneve të blera Vlera nominale Çmimi i blerjes/aksion Vlera totale e blerjes

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | | |
|--|--|--|--|

Përshkruaj mënyrën e pagesës. Në qoftë se mjetet do të jenë likuide për të financuar blerjen , lutemi jepni detaje për këtë :

Në qoftë se është marrë kredi për blerjen e aksioneve, jep detajet e mëposhtme . Në qoftë se kredi nuk është marrë lutemi bëjeni të qartë.

| Emri i huadhënësit | Niveli i interesit | Shuma | Sig |
|--------------------|--------------------|-------|-----|
| | | | |
| | | | |

RAPORTI FINANCIAR

| AKTIVET | | |
|--|--|-------------------------|
| | | 7) Pasive kc |
| | | 8) Pasive ki |
| 1) Paraja në dorë dhe në banka _____ | | 9) Pasive afa |
| 2) Dëftesa, hua dhe llogari të tjera të arkëtueshme të konsideruara të rregullta dhe të mbledhshme _____ | | 10) Pasive af |
| 3) Pronë e patundshme e zotëruar _____ | | taksa për t'u |
| 4) Letra me vlerë të tregtueshme _____ | | dhe detyrime |
| 5)Interesa pronare _____ | | TOTALI I PA |
| 6) Aktive të tjera _____ | | |
| TOTALI I AKTIVEVE _____ | | 13)Pa totalin e pasi |
| | | DHE PASUR |

PASIVE TË PASIGURUARA

Përveç detyrimeve dhe pasiveve të shënuara më sipër, unë kam nënshkruar, garantuar ose nga ana tjetër unë jam indirekt ose rastësisht përgjegjës për detyrimet e të tjerëve si më poshtë :

| Emri e adresa e debitorit | Emri e adresa e kreditorit | Përshkrimi i kolateralit | Vlera aktuale kolaterali |
|---------------------------|----------------------------|--------------------------|--------------------------|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

DETYRIMET AFATSHKURTRA

Paraqitni informacionin e kërkuar në lidhje me të gjitha detyrimet prej 500.000 lekësh ose më shumë për të cilat ju jeni përgjegjës dhe të cilave u ka ardhur koha e pagimit ose do të paguhen për një vit ose më pak. (Pjesa e detyrimeve afatgjata nuk duhet përfshirë në këtë formular.)

| Emri dhe adresa e kreditorit | Kontrollo nqs është e siguruar | Siguruar nga | Norma e interesit |
|--|--------------------------------|--------------|-------------------|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| Bartur nga zëri (7) i raportit financiar | | | |
| TOTALI i detyrimeve të pasiguruara (| | | |
| Bartur nga zëri (8) i raportit financiar | | | |
| TOTALI i detyrimeve të siguruara (në | | | |
| TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA | | | |

DETYRIMET AFATGJATA

Paraqitni informacionin e kërkuar në lidhje me të gjitha detyrimet për 500,000 lekë ose më shumë për të cilat ju jeni përgjegjës dhe të cilat do të paguhen për një vit ose më shumë.

| Emri dhe adresa e kreditorit | Kontrollo nqs është e siguruar | Siguruar nga | Norma e interesit |
|--|--------------------------------|--------------|-------------------|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| Bartur nga zëri (9) i raportit financiar | | | |
| TOTALI i detyrimeve të pasiguar: | | | |
| Bartur nga zëri (10) i raportit financiar | | | |
| TOTALI i detyrimeve të siguruara (| | | |
| TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA | | | |

BORXHE DHE PASIVE TË TJERA

| Përshkrimi | Data e detyrimit |
|--|------------------|
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| Mbartur nga zëri (12) i raportit financiar TOTALI (në lekë) | |

ÇERTIFIKATË

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se informacioni i paraqitur këtu me sa di dhe besoj është i vërtetë dhe i saktë , ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë pjesëmarrjen time në kërkesë dhe në atë shkallë që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim kjo mund të shërbejë si shkak për mohimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar , unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(nënshkrimi i plotë)

(Data)

Në qoftë se është i zbatueshëm:

(nënshkrimi i përgatitësit)

TITULLI: _____

ADRESA: _____

Betuar dhe nënshkruar nga në këtë ditë _____

të _____, 20_____.

(Nënshkrimi i noterit publik)
Komisionet e shërbimit:

AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL
(autorizimi plotësohet në dy ekzemplarë në origjinal)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË :

Unë , _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj për qëllime të inspektimit ose kopjimit të tyre në zbatim të legjislacionit shqiptar.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë _____

Data data /muaji/viti)

Nënshkrimi

Betuar dhe nënshkruar në praninë time
_____ data _____, 20_____

KY DOKUMENT ËSHTË I VLEFSHËM PËR 6 MUAJ _____

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

BANKA E SHOIPËRISË
DEPARTMENTI I MBIKËQYRJES

RAPORT BIOGRAFIK

Plotësuar nga :

| | | | |
|-----------|--------|----------|-------------------------|
| (Mbiemri) | (Emri) | (Atësia) | (Mbiemri para martesës) |
|-----------|--------|----------|-------------------------|

| | | | |
|------------------|----------|----------|----------|
| (Adresa e plotë) | (Qyteti) | (Komuna) | (Shteti) |
|------------------|----------|----------|----------|

(Numri i telefonit)

DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES
NË LIDHJE ME :

Ekzistues

Plotësues

(Emri i institucionit financiar)

| | | |
|-------------------|--------|---------------------|
| Drejtör kapitalit | Blerës | 10% ose më shumë të |
|-------------------|--------|---------------------|

Administrator i bankës (Shëno titullin) : _____

Tjetër (Shëno): _____

INSTRUKSIONE

Shtype ose printoje këtë raport. Të gjitha përgjigjet të jepen të plota. Në qoftë se përgjigjja është "jo", "asnjë" ose "e pazbatueshme", lutemi paraqiteni të tillë. Në qoftë se një pikë e informacionit të kërkuar është e panjohur për ju, lutemi paraqiteni të tillë. Në qoftë se hapësira e dhënë është e pamjaftueshme, bashkëlidhni një listë të veçantë të këtij formulari. Informacioni mbi listën e veçantë duhet t'i përshtatet me numër ose me gërmë, pyetjes në këtë formular dhe të gjitha këto lista duhet të nënshkruhen me firmën origjinale dhe të datohen.

LUTEMI KINI PARASYSH SE INFORMACIONI I DHËNË DO TË VERIFIKOHET, DHE SE NJË RAPORT JO I SAKTË OSE JO I PLOTË, MUND TË JETË SHKAK QË BANKA E SHOIPËRISË TË REFUZOJË KËRKESËN E PJESËMARRJES SUAJ PËR TË CILËN KY RAPORT ËSHTË DORËZUAR.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Data e lindjes : _____ Vendlindja : _____
 (Data/Muaji/Viti) (Qyteti) (Rajoni) (Shteti)

Shtetësia: _____ Numri social i sigurimit (n.q.s. aplikohet) ____/____/____

Numri i pasaportës: _____ Vendi ku është lëshuar: _____

Letra e identifikimit e vendit të tyre : _____ Kombësia _____

Gjendja civile : _____ Emri i plotë i bashkëshortit _____

Emrat e plotë të anëtarëve të familjes : _____

EDUKIMI DHE BESUESHMËRIA PROFESIONALE

1) Tregoni nivelin më të lartë të shkollës së kryer, listën e të gjitha gradimeve dhe të pjesëmarrjeve në shkollat e formimit bankar (në qoftë se ka). Tregoni emrin dhe vendin e shkollës ,datën e ndjekjes , hapësirën më të madhe të përqendrimit ose të specializimit.

PUNËSIMI AKTUAL DHE I SHKUAR

KY INFORMACION ËSHTË I DETYRUESHËM DHE NUK MUND TË LIHET PAS DORE OSE TË PËRJASHTOHET.

2) Tregoni si më poshtë lidhur me punësimin ose me vetëpunësimin tuaj në rend kronologjik për 7 vitet e shkuara për secilin pozicion të mbajtur. Listën vazhduese që nga punësimi fillestar. Përfshi të gjitha periudhat e papunësisë dhe shkaqet e ndërprerjes së punës së mëparshme.

Emri i punëdhënësit: _____

Adresa: _____
 (Rruga) (Qyteti) (Rajoni/shteti) (Vendi) (Kodi postar)

Emri i eprorit / Pronarit/ Drejtorit: _____

Titulli i eprorit/ Pronarit/ Drejtorit: _____

Numri i telefonit/faksit: _____

Data e punësimit: nga _____ deri _____

Natyrë e punës (të lutem shpjego): _____

3.) TITULLI I DETYRËS, PËRSHKRIMI I PUNËS, DETYRAT PARËSORE. (Në qoftë se ju jeni propozuar si oficer i një banke , jepni hollësi të plota mbi eksperiencën tuaj. Jepni informacion mbi detyrat e mbajtura në bankë, mbi numrin e punonjësve që drejtoni, mbi kompetencat për të dhënë hua etj.. Përdorni faqet shtesë, në qoftë se e shihni të nevojshme.)

4.) Shkaqet e ndërprerjes së punës.

RAPORT BIOGRAFIK (vazhdim)

5) Në qoftë se keni qenë shkarkuar ose kërkuar të jepni dorëheqje nga ndonjë punë e shkuar, lutemi tregojeni. Përfshi emrin, adresën dhe numrin e telefonit të punëdhënësit, detyrën nga e cila ju ishit shkarkuar, datën e ndodhjes dhe një shpjegim të situatës.

KUNDRAVAJTJET KRIMINALE DHE MASAT DISIPLINORE

6) A keni qenë ndonjëherë i arrestuar, i paditur dhe/ose i dënuar për një kundravajtje kriminale ?

Në qoftë se PO - Jepni një kopje të ankesës për çështjen dhe për çdo çështje në proces, dhe jepni si më poshtë për të gjitha çështjet në proces dhe të mëparshmet: Emrin dhe adresën e agjencisë së ngarkuar me zbatimin e ligjit, adresën e vendndodhjes së gjykatës, numrin e dosjes së çështjes, natyrën e dënimit, datën e përmbushjes së dënimit, statusin e çështjes, dispozitën.

Në qoftë se JO- Jepni një certifikatë lëshuar nga autoritetet e ngarkuara me zbatimin e ligjit ku të tregohet se ju nuk keni qenë arrestuar, paditur dhe/ose dënuar për kundravajtje kriminale.

7) A jeni paditur ose dënuar për shmangie ndaj taksave?

Në qoftë se PO- Jepni hollësi të veçanta që i përkasin kësaj procedure dhe gjobot e ngarkuara.

Në qoftë se JO- Jepni një certifikatë lëshuar nga organet e tatim-taksave që të tregojë se ju nuk keni qenë paditur ose dënuar për shmangie takse.

8) A jeni të lidhur me ndonjë tregti ose ndërmarrje si zyrtar, drejtor ose pronar i 10 për qind ose më shumë të aksioneve në qarkullim, të paditur ndonjëherë për shkelje kriminale ose që të ketë falimentuar apo punuar jashtë marrëveshjes me kreditorët ?

Në qoftë se PO - Tregoni emrin e biznesit ose të ndërmarrjes, interesin tuaj në këtë biznes, vendndodhjen e gjykatës dhe numrin e dosjes, datën e përmbushjes së dënimit, natyrën e dënimit, statusin e çështjes dhe dispozitën.

INFORMACION I NDRYSHËM

9) Listën e ndonjë biznesi (koorporatë, pjesëmarrje ose ndërmarrje të përbashkët) me të cilën ju jeni lidhur si nëpunës, drejtor, administrator ose pronar , që zotëron 10 për qind ose më shumë të aksioneve në qarkullim. Duke përfshirë emrin dhe vendndodhjen e çdo biznesi, natyrën e biznesit, lidhjet tuaja me të, përqindjen e aksioneve në qarkullim që ju zotëroni, në qoftë se zotëroni të tilla dhe datën e krijimit të lidhjes tuaj.

10) Jepni raporte financiare për bizneset e shënuara në pikën 9 .

LOKALET E BANKËS DHE VENDNDODHJA E SAJ **

- 1) Kapitali i propozuar për t'u investuar në mjete fikse, tipi i zotërimit :
 - vendet e përhershme marrë me qira;
 - vendet e përhershme pronë vetiake;
 - vendet e përkohshme.
- 2) Përshkrimi i lokaleve :
 - A) përshkrime të ambjenteve të brendshme të ndërtesës (duke shprehur sipërfaqen e shfrytëzueshme, të gjitha lehtësitë për nëpunësit dhe përmasat e hapësirës së hollit);
 - B) përmasat e truallit; përmasat e ndërtesës, numri i kateve etj.;
 - C) tipi i konstruksionit të ndërtesës (beton, skelet druri, metal etj.me përshkrim tregues).
- 3) Lokalet e marra me qira
 - A) emri dhe adresa e pronarit, kostoja vjetore e qirasë së bankës;
 - B) përshkrimi i riparimeve dhe i përmirësimeve të ndërtesës së marrë.
- 4) Lokalet në pronësi :
 - A) emri dhe adresa e shitësit, data e përfundimit të ndërtimit, kostoja e blerjes së bankës;
 - B) kostoja dhe përshkrimi i riparimeve të nevojshme, riparime dhe ndryshime të ndërtesës dhe të ambjentit rrethues.
- 5) Vendet e përkohshme :
 - A) vendndodhja e vendeve të përkohshme;
 - B) detaje lidhur me vendet e përkohshme, duke përfshirë përmasat e tyre, tipin e konstruksionit, lehtësitë më kryesore që do të vendosen në ndërtesë;
 - C) në qoftë se vendet e përkohshme do të blihen, parashikoni koston, vlerën e përafërt të rishitjes, një kopje të formularit-tip të kontratës së blerjes;
 - D) në qoftë se vendet e përkohshme do të merren me qira, jepni identitetin e qiramarrësit, qiranë mujore, nëse paguhet një qira minimum.
- 6) Tregoni investimin e propozuar në mobilje, pajisje dhe një përshkrim të sendeve.

** Siguroni sa më shumë të jetë e mundur nga ky informacion në kohën e paraqitjes së kërkesës. Pjesa tjetër e informacionit të dorëzohet në Bankën e Shqipërisë para marrjes së licencës përfundimtare.

LISTA E GJENDJES SË AKSIONERËVE TË BANKËS

Jepni informacionin e mëposhtëm për secilin person i cili propozon të zotërojë ekuivalencën e 10 për qind ose më shumë të çdo klase të aksionit me të drejtë vote të bankës së propozuar dhe shumën e propozuar.

*** NË NJË LISTË TË VEÇANTË, JEPNI HISTORIKUN E PUNËS OSE PROFESIONAL PËR 7 VITET E SHKUARA PËR SECILIN INDIVID.**

PRINTONI OSE SHTYPNI

| EMRI I PLOTË (Mbiemri, Emri/Atësia) | VENDQËNDRIMI (Adresa e rrugës ,qyteti ,vendi) |
|--|--|
| 1) _____ | _____ |
| 2) _____ | _____ |
| 3) _____ | _____ |
| 4) _____ | _____ |
| 5) _____ | _____ |
| 6) _____ | _____ |
| 7) _____ | _____ |
| 8) _____ | _____ |
| 9) _____ | _____ |
| 10) _____ | _____ |
| 11) _____ | _____ |
| 12) _____ | _____ |
| 13) _____ | _____ |
| 14) _____ | _____ |
| 15) _____ | _____ |
| 16) etj..... | |

Përdorni shtesë fletësh nëse është e nevojshme.

INFORMACION PËR THEMELUESIT E BANKËS

| Emri, atësia, mbiemri | Adresa e plotë (Rruga, Qyteti, S |
|------------------------------|---|
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |

PLANI I VEPRIMTARISË SË BANKËS SË PROPOZUAR

Plani i veprimtarisë duhet të përcaktojë qëllimin, objektivat dhe filozofinë e biznesit të bankës. Banka e Shqipërisë do të rishikojë vazhdimisht, gjatë tre viteve të para të veprimtarisë, planin e propozuar të veprimtarisë, që nga miratimi për të gjykuar nëse operacionet e bankës kryhen në përputhje me planin fillestar të dhënë të veprimtarisë, veçanërisht përsa i përket rritjes së aktiveve dhe detyrimeve . Çdo ndryshim i rëndësishëm i planit fillestar të paraqitur mund të bëhet shkak për revokimin e licencës. Për këtë arsye, duhet patur kujdes për përgatitjen e planit të veprimtarisë .

Në planin e veprimtarisë :

1. Përshkruaj politikat dhe veprimtarinë e huadhënies së bankës së propozuar gjatë tre viteve të para të veprimtarisë.
2. Përshkruaj burimet kryesore të huasë, si dhe metodat e ndryshme se si banka do t'i shfrytëzojë për të dhënë hua. Tregoni deri në çfarë shkalle banka do të japë hua ose do të marrë pjesë në hua jashtë zonës kryesore ku kryen shërbimet bankare.
3. Përshkruaj burimet kryesore (kursimeve në formën e depozitave paafat, të depozitat me afat si dhe burime të tjera përdorimi), dhe të metodave për sigurimin e tyre etj..
4. Përshkruaj plotësisht llojet e shërbimeve që banka do të ofrojë.
5. Përshkruaj aktivitetet dhe shumat e investimeve në filiale për tre vitet të para të veprimtarisë.
6. Përshkruaj plotësisht, çdo investim të propozuar të pronarëve të patundshëm, përveç atyre që përdoren për zyra ose për qëllime të tjera të afërta.
7. Këshilli drejtues i propozuar duhet të shqyrtojë , të diskutojë dhe të miratojë kushtet e planit të biznesit. Plani i biznesit mendohet të jetë një paraqitje e planeve dhe e parashikimeve të menduara prej këshillit për të qenë të arritshme dhe Banka e Shqipërisë mund të mbështetet në të gjatë shqyrtimit për miratimin ose jo të kërkesës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BANKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI MBIKËQYRËS

RREGULLORE

PËR LICENCIMIN E SUBJEKTEVE JOBANKA

ENI 1

Dispozita të përgjithshme

- 1.1 Në këtë rregullore përcaktohen:
- kushtet, afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të ushtruar veprimtari nga subjektet jobanka,
 - kushtet, afatet dhe procedurat e revokimit të licencës për ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet jobanka,
 - procedurat në rast të kërkesave për shtimin e veprimtarisë nga subjektet jobanka.
- 1.2 Bazën ligjore të kësaj rregulloreje e përbëjnë: ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë; ligji nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë ", neni 1 pika 3; ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.
- 1.3 Banka e Shqipërisë është autoriteti licencues dhe mbikëqyrës i subjekteve jobanka, për aktivitetet për të cilat ajo i licenccon.
- 1.4 Subjekte jobanka do të quhen të gjitha subjektet që kryejnë veprimtari të parashikuara në këtë rregullore. Në përputhje me licencën e marrë subjekti jobankë ka të drejtë:
- a) të japë kredi;
 - b) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
 - c) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
 - ç) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare; (duke përfshirë valutat)
 - d) të ushtrojë qiranë financiare;
 - dh) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
 - e) të ofrojë garanci të tjera (që cilat nuk emërtohen garanci bankare);
 - ë) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë").
- 1.5 Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje termat e përdorur në të kanë të njëjtin kuptim si ata të shprehur në nenin 2, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- Ndërsa termat vijues të kësaj rregulloreje kanë këto domethënie:
- a) "kapitali fillestar minimal", përfaqëson shumën minimale të kapitalit të kërkuar nga Banka e Shqipërisë për t'u paguar si kontribut në para nga subjekti jobankë, për marrjen e licencës për të ushtruar veprimtari të parashikuara në pikën 1.4 të kësaj rregulloreje;
 - b) "kapitali fillestar i paguar", përfaqëson kapitalin që ka paguar subjekti jobankë për të filluar veprimtarinë për të cilën licencohet.
- 1.6. Subjektet jobanka ndalohen të kryejnë veprimtari të pranimit dhe të grumbullimit të depozitave.
- 1.7 Subjektet e kësaj rregulloreje janë të detyruara të zbatojnë aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë si dhe të raportojnë në bazë të këtyre kërkesave.

NENI 2

Kapitali fillestar dhe burimet e tij

- 2.1 Në bazë të llojit të veprimtarive që subjekti jobankë kërkon të kryejë, shumën e kapitalit fillestar minimal, të jetë si më poshtë:
- a) të japë kredi 100 milionë lekë;
 - b) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve.....30 milionë lekë;
 - c) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave..... 100 milionë lekë;
 - ç) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare; (duke përfshirë valutat) 10 milionë lekë;
 - d) të ushtrojë qiranë financiare.....100 milionë lekë;
 - dh) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit..... 30 milionë lekë;
 - e) të ofrojë garanci të tjera (të cilat nuk emërtohen garanci bankare..... 100 milionë lekë;
 - ë) të shërbejë si agjente ose këshilltore financiare (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë)..... 10 milionë lekë.
- 2.2 Pagesa e shumës së kapitalit fillestar minimal mund të bëhet në monedhën shqiptare (Lekë), në dollarë amerikanë ose në monedhën europiane Euro, që përbëjnë kundravleftën e kapitalit në lekë, sipas pikës 2.1 të kësaj rregulloreje, vlerësuar me kursin mesatar ditor, të llogaritur nga Banka e Shqipërisë në ditën e pagesës së kapitalit .
- 2.3 Kapitali fillestar minimal për subjektet jobanka, që kërkojnë të kryejnë dy ose më shumë veprimtari të përcaktuara në pikën 1.4, të jetë jo më i vogël se më i madhi ndërmjet kapitaleve të kërkuara në respektim të pikës 2.1, për secilën nga veprimtaritë për të cilat subjekti jobankë kërkon të licencohet.
- 2.4 Pagesa e kapitalit fillestar minimal kryhet në një llogari garancie, në një nga bankat e nivelit të dytë të licencuara në Republikën e Shqipërisë, dhe bllokohet deri në marrjen e licencës. Pagesa bëhet me xhirim në llogari, brenda 5 ditëve nga njoftimi i bankës së Shqipërisë për derdhjen e kapitalit.
- 2.5 Ndryshimin e shumës së kapitalit fillestar minimal për licencimin e një subjekti jobankë e përcakton Banka e Shqipërisë dhe e publikon këtë në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
- 2.6 Burimi i kapitalit të paguar nuk mund të jetë hua, kredi apo paradhënie nga subjekte të treta.
- 2.7 Pagesat dhe/ose shpenzimet për blerjen ose për marrjen me qira të lokaleve të subjektit jobankë dhe të pajisjeve të punës nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal.
- 2.8 Kontabiliteti organizohet në mbështetje të ligjit "Për kontabilitetin" dhe në përshtatje me "Manualin e Kontabilitetit Bankar", miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 820, datë 30.12.1998 dhe në respektim të akteve rregullative të miratuara nga Banka Shqipërisë, për këtë qëllim.

NENI 3

Kërkesa për marrjen e licencës

- 3.1 Kërkesa për marrjen e licencës për të kryer një ose disa nga veprimtaritë e pikës 1.4 të kësaj rregulloreje, bëhet me shkrim dhe paraqitet në Bankën e Shqipërisë. Në përmbajtjen e kësaj kërkesë deklarohet angazhimi për zbatimin e legjislacionit shqiptar dhe të kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë.
- 3.2 Kërkesa për marrjen e licencës të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë rregullore dhe me formularët bashkëlidhur. Kërkesa si më sipër të jetë e nënshkruar nga themeluesit ose personat e autorizuar prej tyre.
- 3.3 Dokumentacioni në gjuhën shqipe paraqitet në origjinal dhe/ose në fotokopjen e notuar të tij. Dokumentacioni në gjuhë të huaj paraqitet në origjinal ose në fotokopjen e notuar të tij, e vërtetuar nga autoritetet shtetërore kompetente të vendit ku është lëshuar dokumenti ose të vendit të origjinës së kërkuarit, që e kanë njohur këtë dokument. Ky dokumentacion të jetë i shoqëruar nga përkthimi në gjuhën shqipe dhe i notuar.

ENI 4

Dokumentacioni i kërkuar

- 4.1 Për kapitalin dhe burimin e tij:
- a) Deklaratën noteriale të themeluesve, se burimi i kapitalit të paguar të subjektit jobankë nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta.
 - b) Deklaratën noteriale të themeluesve mbi burimin e kapitalit të paguar.
 - c) Dokumentin që verteton pagesën e kapitalit fillestar.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë që të kërkojë, në rrugë institucionale, sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme për të dalë qartë burimi i krijimit të parave që do të shërbejnë si kapital i subjektit jobankë.

- 4.2 Për themeluesit:
- a) aktmarrëveshja e krijimit të shoqërisë (në se ka të tillë);
 - b) vendimi i regjistrimit si person juridik në gjykatë si dhe çdo ndryshim i tij;
 - c) akti i themelimit të personit juridik dhe statuti i shoqërisë;
 - d) lista e themeluesve dhe pjesëmarrja e tyre në kapitalin e shoqërisë;
 - e) struktura e organizimit dhe lista e administratorëve të shoqërisë.

Veprimtaria për të cilën kërkohet licenca duhet të jetë e përfshirë në vendimin e regjistrimit në gjykatë.

4.2.1 Kur themeluesit janë persona juridikë:

- a) Vendimi i regjistrimit në gjykatë, akti i themelimit dhe statuti i personit juridik dhe certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;
- b) vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim- taksave nga themeluesit për vitin e fundit financiar (për personat juridikë të huaj - në varësi të legjislacionit përkatës të vendit të huaj, në rast të kundërt deklaratën personale);
- c) deklarata noteriale për detyrimet ndaj të tretëve dhe për shlyerje të rregullta të tyre (në qoftë se ka);
- d) në rastin e pjesëmarrjes influencuese në subjektin jobankë dokumentacioni plotësohet me të dhënat për veprimtarinë tregtare për vitin e fundit, pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e fundit, të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar;
- e) vendimin e organit vendimmarrës të shoqërisë për pjesëmarrjen në kapitalin e subjektit jobankë.

4.2.2 Kur themelues janë persona fizikë tregtarë ose individë:

- a) - Për personat fizikë tregtarë: akti i regjistrimit të shoqërisë, certifikata e regjistrimit në organin tatim-taksave dhe vërtetim nga organet e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve ndaj tyre;
- për individët: emër, mbiemër, adresa, kombësia, shtetësia, edukimi, punësimi aktual dhe i shkuar dhe dëshmi penaliteti.
- b) vërtetime nga gjykata dhe prokuroria se ndaj këtyre shtetasve nuk është hapur proces gjyqësor dhe nuk janë në ndjekje penale si dhe dëshmi penaliteti lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (për shtetasit e huaj në varësi të legjislacionit përkatës);
- c) deklarata noteriale për detyrimet ndaj të tretëve dhe për shlyerje të rregullta të tyre (në qoftë se ka);
- d) lista e bizneseve në të cilat themeluesi i subjektit financiar jobankë ka pjesëmarrje influencuese, si dhe përqindja e kapitalit që disponon, akti i regjistrimit, numri në regjistrin tregtar, numri i identifikimit të personit në lidhje me pagimin e tatim-taksave, të dhëna mbi ndonjë rast falimentimi të tyre, në qoftë se ka patur biznes.

4.3 Për administratorët:

Në Bankën e Shqipërisë paraqitet lista e administratorëve të shoqërisë.

Për secilin prej këtyre paraqiten:

- a) kopje të vendimit të organeve vendimmarrëse të shoqërisë për emërimin e administratorëve;

- b) CV-ja e firmosur e çdo administratori;
- c) vërtetime nga gjykata dhe prokuroria se ndaj këtyre shtetasve nuk është hapur proces gjyqësor dhe nuk janë në ndjekje penale si dhe dëshmi penaliteti lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (për shtetasit e huaj në varësi të legjislacionit përkatës).

4.4 Planbiznesi i propozuar.

Themeluesit paraqesin planin e veprimtarisë së subjektit për vitin e parë të veprimtarisë ku minimalisht të përfshihen:

- a) veprimtaritë që propozon të kryejë dhe objektivat për të ardhmen;
- b) vlerësimi i tregut, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;
- c) politika e subjektit për veprimtaritë që kërkon të kryejë, objektivat dhe pozicioni i tij në treg;
- d) struktura e organizimit të shoqërisë;
- e) parashikimi i gjendjes financiare të subjektit për vitin e parë të veprimtarisë së tij, pasqyrat financiare.

ENI 5

Verifikimi dhe afatet

- 5.1 Banka e Shqipërisë bën verifikimin e plotësimit të dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
- 5.2 Data e pranimit të kërkesës për licencë, konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim, nga Banka e Shqipërisë, kërkuetit dhe që nga ky moment fillon llogaritja e afatit dymujor të përcaktuar për marrjen e vendimit.
- 5.3 Banka e Shqipërisë, brenda dy muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, miraton ose refuzon kërkesën për licencë dhe njofton me shkrim kërkuetin për vendimin e saj.
- 5.4 Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë do të dërgojë një njoftim për mangësitë, për konfliktet me ligjin si dhe kërkesa për informacion shtesë.
- 5.5 Mangësitë dhe vërejtjet e tjera të konstatuara në dokumentacionin e paraqitur sipas kësaj rregulloreje, të mënjanohen brenda një muaji nga data e njoftimit të tyre. Në rast të kundërt, Banka e Shqipërisë ndërpret shqyrtimin e kërkesës dhe për këtë njofton kërkuetin.

ENI 6

Kushtet që duhen plotësuar për marrjen e licencës

- 6. Subjekti jobankë që kërkon të licencohet duhet të plotësojë këto kushte:
 - 6.1 dokumentacioni i paraqitur të jetë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;
 - 6.2. dokumentin që vërteton se kapitali fillestar minimal është depozituar në një llogari garancie;
 - 6.3. procedurat kontabile të jenë hartuar në përputhje me detyrimet e pikës 2.8 të kësaj rregulloreje;
 - 6.4. aktet e brendshme rregullative të jenë miratuar nga organet vendimmarrëse;
 - 6.5. subjektet e kësaj rregulloreje që do të kryejnë veprimtaritë e përcaktuara në pikën 1.4 me rrjet shërbimi, të paraqesin kontratat-tip, që do të lidhin me të tretët, ku shprehimisht të cilësohet se subjekti jobankë është përgjegjës për shërbimet që do të kryhen;
 - 6.6. për ambientet e punës të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e qirasë, dokumente të tjera (kontrata, vërtetime etj) të lëshuara nga organet përkatëse, ku të tregohet nëse ambientet e punës i plotësojnë kërkesat për siguri dhe mbrojtje, lehtësi komunikuese dhe sigurimin nga zjarri;
 - 6.7. për pajisjet e punës (komputera, programe, telekse, telefona, fakte etj.) të paraqitet lista e tyre. Këto pajisje të jenë të përshtatshme për veprimtarinë e subjektit dhe të instaluara;
 - 6.8. të paraqesë vërtetim se ka të hapur, të paktën pranë një banke të licencuar në Republikën e Shqipërisë, llogari në lekë ose në valutë.

ENI 7

Miratimi apo refuzimi i kërkesës për licencë

- 7.1 Departamenti i Mbikëqyrjes përgatit informacionin dhe jep opinionet lidhur me kërkesën e paraqitur, pasi:
- a) ka analizuar dokumentacionin e paraqitur, duke bërë dhe verifikime;
 - b) ka organizuar takime me administratorët e propozuar të subjektit jobankë për të diskutuar planbiznesin e paraqitur dhe probleme të tjera të lidhura me veprimtarinë e propozuar të subjektit etj.;
 - c) ka vlerësuar aftësinë profesionale të administratorëve;
 - d) ka verifikuar në vend kushtet në të cilat subjekti do të zhvillojë veprimtarinë.
- 7.2. Vendimi për dhënien ose për refuzimin e miratimit paraprak për licencë merret nga administratori i Bankës së Shqipërisë kur plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.
- 7.3. Dhënia e licencës ose refuzimi për ta dhënë atë, së bashku me arsyet e këtij refuzimi, i bëhet e njohur me shkrim kërkuarit nga Banka e Shqipërisë brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune, pas marrjes së vendimit përkatës.

ENI 8

Publikimi

Dhënia e licencës, për të vepruar si subjekt jobankë, publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

ENI 9

Informacion për fakte të tjera

- 9.1 Faktet e reja e rrethanat e konstatuara pas dhënies së licencës si dhe ndryshimet që ato sjellin në dokumentet e paraqitura, të cilat kanë shërbyer si bazë për dhënien e licencës do t'i njoftohen me shkrim Bankës së Shqipërisë.
- 9.2 Njoftimi sipas paragrafit 9.1 do të bëhet brenda 15 ditëve, pas ndodhjes së faktit ose konstatimit të rrethanave përkatëse.

ENI 10

Revokimi i licencës

- 10.1 Licenca e subjektit jobankë revokohet me vendim të administratorit përkatës të Bankës së Shqipërisë kur:
- a) kërkohet nga vetë subjekti i licencuar;
 - b) licenca është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë, pavarësisht nëse është dhënë nga kërkuari apo ka të bëjë me kërkuarin, duke përfshirë të dhënat për kualifikimet, përvojën ose reputacionin e administratorëve dhe të themeluesve me pjesëmarrje influencuese të propozuar, ose parregullsi të tjera materiale të shkaktuara në lidhje me kërkesën për licencë;
 - c) subjekti financiar jobankë nuk ka filluar veprimtarinë ose ka ndërprerë këtë veprimtari për më shumë se 6 muaj ;
 - d) zotëruesit e kuotave të subjektit jobankë kanë vendosur të shpërndajnë a të likuidojnë subjektin ose subjekti ka pushuar së ekzistuari;
 - e) në zbatim të nenit 45 pika 3 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 10.2. Vendimi për revokimin e licencës i komunikohet menjëherë, me shkrim, subjektit, ku jepen dhe arsyet.
- 10.3. Vendimi për revokimin e licencës publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në një ose më shumë nga gazetatat kryesore të vendit me tirazh më të madh. Vendimi i revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
- 10.4. Subjekti ndalohet të angazhohet në veprimtari të përcaktuara në pikën 1.4 të kësaj rregulloreje pas hyrjes në fuqi të vendimit të revokimit të licencës.

ENI 11

Regjistrimi në Bankën e Shqipërisë

- 11.1. Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë mban një regjistër për konsultim nga publiku, ku regjistrohen të gjitha licencat e dhëna sipas kësaj rregulloreje.
- 11.2. Në këtë regjistër regjistrohen emri, adresa e selisë, emrat e themeluesve dhe të administratorëve, dhe veprimtaritë për të cilat subjekti është licencuar.
- 11.3. Një kopje e këtij regjistri mbahet për konsultim publik në çdo përfaqësi rajonale të Bankës së Shqipërisë.
- 11.4. Me revokimin e licencës bëhet dhe çregjistrimi nga regjistri i bankës ose i degës së bankës. Një listë e licencave të revokuara mbahet në një fletë të veçantë.

ENI 12

Komisionet

- 12.1. Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit, kërkuesi paguan në Bankën e Shqipërisë një komision prej 20.000 lekësh. Ky komision nuk rimburohet, pavarësisht nëse miratohet ose jo kërkesa për dhënie licence.

ENI 13

Të tjera

- 13.1. Të gjitha shoqëritë tregtare që kërkojnë të zgjerojnë veprimtarinë e tyre, duke kryer edhe një ose disa nga veprimtaritë e përshkruara në pikën 1.4 të kësaj rregulloreje, kanë të drejtë të paraqesin në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin përkatës të kërkesës për licencim.
- 13.2. Për shoqëritë e përcaktuara në pikën 13.1, shuma e kapitalit fillestar minimal, për veprimtaritë e pikës 1.4 që subjekti parashikon të kryejë, të konsiderohet kapitali i llogaritur sipas kërkesave të pikës 1.4 të rregullores " Për normat e mbikëqyrjes të subjekteve jobanka", me të dhënat e çertifikuara nga eksperti kontabël i autorizuar.
- 13.3. Të gjitha subjektet jobanka, që kërkojnë të licencohen për veprimtari shtesë të përcaktuara në nenin 1.4, janë të detyruara të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
 - a. kërkesën për të kryer veprimtarinë ose veprimtaritë shtesë, të parashikuara në pikën 1.4;
 - b. pagimin e shtesës së shumës të kapitalit fillestar minimal, në qoftë se kapitali i llogaritur sipas pikës 13.2 si më sipër, nuk plotëson kërkesën për kapital për veprimtarinë që kërkon të kryejë ky subjekt;
 - c. plotësimin e kushteve teknike për kryerjen e veprimtarisë shtesë.
- 13.4. Të gjitha subjektet e licencuara që kërkojnë të kryejnë veprimtari shtesë, për plotësimin e kërkesave sipas pikës 13.3, nuk paguajnë komision.
- 13.5. Subjektet jobanka të licencuara, në rast të ndryshimit të ambjenteve të kryerjes së veprimtarive, njoftojnë brenda 15 ditëve Bankën e Shqipërisë, e cila bën inspektimin për verifikimin e plotësimin të kushteve të përcaktuara në pikat 6.5 dhe 6.6 të kësaj rregulloreje.

ENI 14

Dispozita përfundimtare

- 14.1 Pjesë e pandarë e kësaj rregulloreje janë formularët bashkëlidhur.
- 14.2 Rregullorja "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë" e miratuar me vendimin nr.26, datë 18.03.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.
- 14.3 Kjo rregullore u miratua me vendimin nr. 96, datë 26.11.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim Cani

KËRKESE
PËR
BANKËN E SHQIPËRISË
LIDHUR ME AUTORITETIN PËR TE DHËNË LICENCË
PËR SUBJEKT JOBANKË

Emri i subjektit : _____
Vendndodhje e propozuar : Adresa _____, Shqipëri
(Qyteti) (Rrethi)

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari si subjekt jobankë.

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë angazhohemi për zbatimin e ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të legjislacionit shqiptar.

Kërkuesit

Ps. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme:

Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" Nr. 1
Tiranë, Shqipëri.

FORMULARI NR.1

VENDIMI
I KËSHILLIT DREJTUES
PËR CAKTIMIN E KORRESPONDENTËVE

Këshilli drejtues i propozuar vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, këshilli drejtues i propozuar emëron dhe përcakton si korrespondentë :

(Emri)

(Atësia)

(Mbiemri)

Adresa: _____

(Rruga, Numri)

(Qyteti)

(Shteti)

(Numri i telefonit)

(Numri i faksit/teleksit)

Korrespondenti i mësipërm është i autorizuar të përfaqësojë subjektin dhe të paraqitet të nënshkruajë para Bankës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë, do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e këshillit drejtues. Korrespondenti është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përbushë të gjitha synimet dhe qëllimet siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari, nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Banka e Shqipërisë .

Datë _____,

(Emri mbiemri)

(Nënshkrimi)

Shënim : Ky formular duhet të vërtetohet nga noteri.

FORMULARI NR.2

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(të realizuara nga veprimtaria financiare)

KJO DUHET TË PARAQITET PËR VITIN E PARË TË AKTIVITETIT

TË ARDHURAT

TOTALI I TË ARDHURAVE

_____ Lekë ose Usd/Eur

SHPENZIMET

TOTALI I SHPENZIMEVE

_____ Lekë ose Usd/Eur

TË ARDHURAT NETO PARA TAKSAVE

_____ Lekë ose Usd/Eur

FORMULARI NR.4

ÇERTIFIKATË

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se informacioni i paraqitur këtu, me sa di dhe besoj, është i vërtetë dhe i saktë. Ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport, mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë pjesëmarrjen time në kërkesë dhe në atë shkallë që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve, pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim, kjo mund të shërbejë si shkak për mohimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Data)

(nënshkrimi i plotë)

Në qoftë se është i zbatueshëm:

(nënshkrimi i përgatitësit)

Nënshkruar në këtë ditë _____

të _____, 20_____.

(Nënshkrimi i noterit publik)

Shënim: Do të plotësohet nga çdo themelues.

FORMULARI NR.5

AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Të plotësohet secili prej të dy formularëve të autorizimit në original!)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të ligjeve të Shqipërisë.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data /muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time
_____ data _____, 20 _____

**KY DOKUMENT ËSHTË I
VLEFSHËM PËR 6 MUAJ**

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të ligjeve të Shqipërisë.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data/muaji/viti)
Nënshkruar në praninë time
_____ data _____, 20 _____

Nënshkrimi

**KY DOKUMENT ËSHTË I
VLEFSHËM PËR 6 MUAJ**

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

Shënim: Do të plotësohet nga çdo themelues.

FORMULARI NR.6

LOKALET E SUBJEKTIT JOBANKAR DHE VENDNDODHJA E TIJ **

- 1) Kapitali i propozuar për t'u investuar në mjete fikse, tipi i zotërimit:
 - Vendet e përhershme marrë me qira.
 - Vendet e përhershme pronë vetiake.
 - Vendet e përkohshme.
- 2) Përshkrimi i lokaleve:
- 3) Lokalet e marra me qira:
 - A) Emri dhe adresa e pronarit, kostoja vjetore e qirasë së subjektit financiar jobankë.
 - B) Përshkrimi i riparimeve dhe i përmirësimeve të ndërtesës së marrë.
- 4) Lokalet në pronësi:
 - A) Emri dhe adresa e shitësit, data e përfundimit të ndërtimit, kostoja e blerjes së lokalit (objektit).
 - B) Kostoja dhe përshkrimi i riparimeve të nevojshme, riparime dhe ndryshime të ndërtesës dhe të ambientit rrethues.
- 5) Vendet e përkohshme:
 - A) Vendndodhja e ambienteve të përkohshme.
 - B) Detaje lidhur me ambientet e përkohshme, duke përfshirë përmasat e tyre, tipin e konstruksionit, lehtësitë më kryesore që do të vendosen në ndërtesë.
 - C) Në qoftë se ambientet e përkohshme do të blihen, parashikoni koston, vlerën e përafërt të rishitjes, një kopje të formularit-tip të kontratës së blerjes.
 - D) Në qoftë se ambientet e përkohshme do të merren me qira, jepni identitetin e qiramarrësit, qiranë mujore, nëse paguhet një qira minimum.
- 6) Tregoni investimin e propozuar në mobilje, në pajisje dhe një përshkrim të sendeve.

** Siguroni sa më shumë të jetë e mundur nga ky informacion në kohën e paraqitjes së kërkesës. Pjesa tjetër e informacionit të dorëzohet në Bankën e Shqipërisë para marrjes së licencës përfundimtare.

FORMULARI NR. 7

INFORMACION PËR THEMELUESIT E SHOQËRISË

| Emri, Atësia Mbiemri | Adresa e plotë (Rruga, Q, Shteti) |
|----------------------|-----------------------------------|
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |

FORMULARI NR.8

PLANI I VEPRIMTARISË SË PROPOZUAR

Plani i veprimtarisë duhet të përcaktojë qëllimin, objektivat dhe filozofinë e biznesit të subjektit jobankë. Banka e Shqipërisë do të rishikojë vazhdimisht gjatë vitit të parë të veprimtarisë, planin e propozuar të veprimtarisë, që nga miratimi për të gjykuar nëse operacionet e subjektit financiar jobankë kryhen në përputhje me planin fillestar të dhënë të veprimtarisë, veçanërisht për sa i përket rritjes së aktiveve dhe detyrimeve. Çdo ndryshim i rëndësishëm i planit fillestar të paraqitur mund të bëhet shkak për revokimin e licencës. Për këtë arsye, duhet patur kujdes për përgatitjen e planit të veprimtarisë.

Në planin e veprimtarisë:

1. Përshkruaj politikat sipas llojit dhe numrit të veprimtarive financiare që subjekti jobankë propozon të kryejë gjatë vitit të parë të veprimtarisë.
2. Përshkruaj burimet kryesore të huasë, si dhe metodat e ndryshme që subjekti jobankë do të shfrytëzojë për të dhënë hua. Tregoni deri në çfarë shkalle subjekti jobankë do të japë hua ose do të marrë pjesë në hua, jashtë zonës kryesore ku kryen shërbimet financiare.
3. Përshkruaj plotësisht llojet e shërbimeve që subjekti jobankë do të ofrojë.
4. Këshilli drejtues i propozuar duhet të shqyrtojë, të diskutojë dhe të miratojë kushtet e planit që mendohet të jetë me leverdi. Plani i biznesit mendohet të jetë një paraqitje e planeve dhe e parashikimeve të menduara prej këshillit, për të qenë të arritshme dhe Banka e Shqipërisë mund të mbështetet në të gjatë shqyrtimit për miratimin ose jo të kërkesës.



BANKA E SHQIPËRISË

RREGULLORE PER LICENCIMIN E ZYRAVE TE KEMBIMIT VALUTOR

Miratur me vendimin nr.65, datë 30.07.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në baze dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Keshilli Mbikëqyrës i Bankes se Shqiperise miraton "Rregulloren per licencimin e zyrave të kembimit valutor".

Zyra e këmbimit valutor është një nga operatorët e tregut të këmbimeve valutore, e cila për llogari të saj blen dhe shet valutë dhe çeqe udhëtarësh.

Licencimi i zyrës së këmbimit valutor bëhet nga Banka e Shqipërisë sipas kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore.

I. KËRKESA TË PËRGJITHSHME

1. Për subjektet, që kërkojnë të kryejnë veprimtarinë e këmbimeve valutore, shuma minimale e kapitalit fillestar të kërkuar, të regjistruar (në gjykatë) dhe të paguar si kontribut në para, është 2.500.000 lekë. Subjektet duhet të depozitojnë shumën e kapitalit minimal prej 2.500.000 lekësh ose ekuivalenten e saj në çdo monedhë tjetër, llogaritur me kursin e bankës në ditën e depozitimit, në një llogari të bllokuar, pranë një banke ose dege banke të huaj në Republikën e Shqipërisë, që zhbllkohet vetëm me marrjen e licencës së zyrës së këmbimit valutor nga Banka e Shqipërisë. Në rast të refuzimit të dhënies së licencës, Banka e Shqipërisë lëshon një dokument për zhbllokimin e llogarisë përkatëse.
2. Subjektet e interesuara paraqesin në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) kërkesën për licencimin e zyrës së këmbimeve valutore, personat që do të ushtrojnë këtë aktivitet, kualifikimin e tyre dhe adresën e saktë të zyrës ose të zyrave të këmbimit valutor, në rastet kur veprimtaria e këmbimeve valutore do të kryhet në disa degë të saj; kualifikimin e administratorit të shoqërisë (dokumentin që vërteton se të paktën ka përfunduar shkollën e mesme);
 - b) vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik, statutin si dhe aktin e themelimit të shoqërisë tregtare, ku të jetë regjistruar veprimtaria e këmbimeve valutore.

Në rast se shoqëria ka ndryshime në personin juridik që nga regjistrimi fillestar, të paraqiten dokumentet, që vërtetojnë ndryshimet e bëra;

- c) çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor të rrethit, për vitin ushtrimor, për kryerjen e veprimtarisë së këmbimeve valutore;
- d) vërtetimet nga gjykata, prokuroria e rrethit dhe Ministria e Drejtësisë, se personi ose personat, që do të ushtrojnë veprimtarinë e këmbimeve valutore nuk kanë kryer ndonjë vepër penale ose nuk janë në gjykim ose ndjekje penale;
- e) dokumentin, që vërteton pronësinë ose marrjen me qira të lokalit, ku do të kryhet veprimtaria e këmbimeve valutore;
- f) deklaratën noteriale të subjektit, se nuk ka detyrime ndaj bankave, ndaj degëve të bankave të huaja dhe ndaj institucioneve të tjera kredihënëse;
- g) vërtetimin, nga një bankë ose degë banke e huaj, se subjekti ka llogari rrjedhëse në valutë dhe në lekë, pranë saj;

- h) vërtetimin nga një bankë ose degë banke e huaj, se subjekti ka depozituar në një llogari, të marrë si garanci, shumën minimale të kapitalit të kërkuar sipas pikës 1 të këtij udhëzimi;
 - i) dy fotografi për çdo punonjës të caktuar për kryerjen e veprimtarisë së këmbimeve valutore;
 - k) deklaratën noteriale të shoqërisë, se dokumentacioni i paraqitur është i vërtetë.
3. Dokumentacioni të jetë në origjinal ose në kopje të noteruar dhe në gjuhën shqipe, si për vendasit dhe për të huajt.
 4. Dokumentacioni i plotë të dorëzohet, në zarf të mbyllur ose të postohet në adresën e mëposhtme:

Banka e Shqipërisë
 Departamenti i Mbikëqyrjes
 Sektori i Licencimit dhe Rregullimeve Bankare
 Sheshi "Skënderbej" Nr.1
 Tiranë.

II. VERIFIKIMI I DOKUMENTACIONIT DHE AFATET

1. Banka e Shqipërisë organizon verifikimin e dokumentacionit të paraqitur, dhe nëse ai nuk është i plotë dhe nuk përmbush kërkesat e këtij udhëzimi, njofton kërkuar brenda 15 ditëve pas paraqitjes së tij.
Po brenda këtij afati, Banka e Shqipërisë, nëse e gjykon të nevojshme, ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë.
2. Mangësitë në dokumentacionin e paraqitur të mënjanohen brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga Banka e Shqipërisë. Në qoftë se dokumentacioni nuk plotësohet pas kalimit të këtij afati Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës.
3. Pas verifikimit të dokumentacionit, Banka e Shqipërisë inspekton ambientet ku është caktuar të zhvillohet veprimtaria e këmbimeve valutore. Nëse kushtet teknike janë të përshtatshme për kryerjen normale të veprimtarisë së këmbimeve valutore, merret vendimi përfundimtar për dhënien ose jo të licencës. Për vlerësimin e kushteve teknike të zyrës së këmbimeve valutore në inspektim merr pjesë një specialist i Sektorit të Sigurimit të Bankës së Shqipërisë.
4. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon licencën për zyrë të këmbimeve valutore, brenda 30 ditëve kalendrike pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë.
5. Banka e Shqipërisë së bashku me licencën jep edhe kartën e identifikimit për çdo kambist të licencuar që do të punojë në zyrën e këmbimit valutor.
6. Banka e Shqipërisë, brenda tre ditëve pune pas marrjes së vendimit nga administratorët e Bankës së Shqipërisë, i dorëzon licencën kërkuar apo njofton me shkrim për refuzimin e kërkesës për licencë. Në rast refuzimi të kërkesës, kërkuar ka të drejtë ankimi tek Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.
7. Licencimi jepet i pakufizuar në kohë dhe nuk është i transferueshëm.
8. Brenda datës 31 mars të çdo viti, zyrat e këmbimeve valutore, paraqesin në Bankën e Shqipërisë, dokumentet e përcaktuara në pikën I.2. b, në rast se ka ndryshime, dhe I.2.c.
9. Brenda 15 ditëve pune pas paraqitjes së dokumentacionit sipas pikës 8, Banka e Shqipërisë, bën njoftimin për vlefshmërinë ose jo të licencës së dhënë për vitin në vazhdim. Nëse dokumentat e kërkuar sipas pikës 8, mësipër, nuk janë dorëzuar në Bankën e Shqipërisë brenda datës 31 mars të çdo viti, licenca e dhënë zyrës së këmbimit valutor bëhet e pavlefshme dhe Banka e Shqipërisë njofton revokimin e saj.

III. DETYRIMET E ZYRËS SË KËMBIMEVE VALUTORE

1. Zyra e këmbimeve valutore duhet të fillojë veprimtarinë e saj brenda 30 ditëve kalendrike nga marrja e licencës.
2. Të gjithë punonjësit, që kanë kontakt të vazhdueshëm me klientët, duhet të mbajnë në vend të

- dukshëm kartën e tyre të identifikimit.
Ndryshimet e personelit të zyrës së këmbimeve valutore, i njoftohen Bankës së Shqipërisë brenda 15 ditëve pune për pajisjen e tyre me kartë identifikimi. Për personat e larguar dorëzohet karta e identifikimit.
3. Të njoftojë menjëherë Bankën e Shqipërisë për ndryshimin e adresës së zyrës së këmbimeve valutore të licencuar.
 4. Të afishojë në vend të dukshëm kursin ditor të këmbimeve valutore, në blerje dhe në shitje, për çdo valutë.
 5. Për çdo këmbim valutë, të lëshohet dokumenti i veprimit të kryer dhe të mbahet një kopje e tij.
 6. Të raportojë, çdo ditë në Bankën e Shqipërisë, për veprimet e këmbimeve valutore të kryera, sipas udhëzimit 4 të kësaj rregulloreje.
 7. Të organizojë kontabilitetin në përputhje me ligjin nr. 7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin".

IV REVOKIMI I LICENCËS

Përveç rasteve të shkeljes së kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë ka të drejtën e revokimit të licencës edhe kur:

1. provohet se një prej dokumenteve kryesore të paraqitura për marrjen e licencës është fals;
2. zyra e këmbimeve valutore ose e ka ndërprerë veprimtarinë për një periudhë më të gjatë se 30 ditë kalendarike, pa njoftuar më parë me shkrim, Bankën e Shqipërisë;
3. gjatë kryerjes së veprimtarisë, konstatohen sjellje të pandershme ose mashtrime;
4. vërtetohen shkelje në mbajtjen e kontabilitetit.

Brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit për revokimin e licencës nga Administratorët e Bankës së Shqipërisë, zyra e këmbimeve valutore, të dorëzojë dokumentin e licencës në Bankën e Shqipërisë.

V. KOMISIONET

Pagesa paraprake për marrjen e licencës është 2500 lekë.

Pagesa për kartën e identifikimit, për çdo person të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë së këmbimeve valutore është 500 lekë.

Këto pagesa kryhen në Bankën e Shqipërisë.

VI. DISPOZITA E FUNDIT

Kjo rregullore u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 65, datë 30.07.2003 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KESHILLIT MBIKËQYRES
Shkëlqim Cani



BANKA E SHQIPËRISË

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PUNËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Miratuar me vendimin nr.103 datë 29.12.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton "Kushtet e Përgjithshme të Punës në Bankën e Shqipërisë".

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1 OBJEKTI

Objekti i "Kushteve të Përgjithshme të Punës" të Bankës së Shqipërisë është rregullimi i marrëdhënieve kontraktore ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe klientëve të saj.

NENI 2 QËLLIMI

Nëpërmjet "Kushteve të Përgjithshme të Punës" synohet të unifikohen dhe racionalizohen marrëdhëniet që lindin midis Bankës së Shqipërisë dhe klientëve të saj, sipas vullnetit të lirë të tyre dhe brenda kufijve të përcaktuar nga ligji.

NENI 3 PËRKUFIZIMET

Kudo ku janë përdorur në këto rregullore, termat vijues kanë këte kuptim:

- a) **"Bankë"**: nënkupton Bankën e Shqipërisë.
- b) **"Kushte të Punës të Bankës së Shqipërisë"**: nënkuptohet tërësia e "Kushteve të Përgjithshme të Punës" dhe "Kushteve Specifike të Punës", dhe e afateve të cilat rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe klientit.
- c) **"Operacionet"**: nënkuptohen të gjitha veprimet juridike që kryen Banka me klientët të cilat janë objekt i veprimtarisë së Bankës, përcaktuar në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë".
- d) **"Klientët"**: nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe subjektet e tjerë të parashikuar në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".
- e) **"Përgjegjësitë"**: nënkupton detyrimin e palëve për të kryer veprime të ligjshme dhe për të përballuar pasojat e veprimeve jo të ligjshme.

NENI 4
FUSHA E ZBATIMIT

- 4.1 Operacionet që kryhen në Bankën e Shqipërisë rregullohen nga “Kushtet e Punës”, që është tëresia e “Kushteve të Përgjithshme të Punës” dhe e “Kushteve Specifike të Punës”. Në bazë dhe për zbatim të “Kushteve të Përgjithshme të Punës”, një ose disa operacione specifike të bankës rregullohen në mënyrë të veçantë nga “Kushtet Specifike të Punës”.
- 4.2 “Kushtet e Përgjithshme të Punës” nuk kanë për qëllim të krijojnë, ndryshojnë apo të shuajnë ndonjë marrëdhënie të bankës me klientin në kryerjen e operacioneve në bankë. Në bazë dhe për zbatim të Kushteve të Përgjithshme të Punës, banka përcakton kufijtë e pjesmarrjes së saj në disa operacione, me një numër të kufizuar klientësh, si dhe përcakton klientët me të cilët nuk kryen operacione. Interpretimi në mënyrë të zgjeruar i dispozitave mbi përmbajtjen e “Kushteve të Përgjithshme të Punës”, të “Kushteve Specifike të Punës” dhe procedurave të zbatimit të tyre, bëhet nga Banka në përputhje me dispozitat detyruese të Kodit Civil.
- 4.3 “Kushtet e Përgjithshme të Punës” të bankës vazhdojnë të zbatohen edhe me përfundimin e marrëdhënieve të përgjithshme me klientet deri në përmbushjen e plotë të së drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga operacionet e bankës.

NENI 5
NDRYSHIMET

- 5.1 Ndryshimet e “Kushteve të Përgjithshme të Punës” së bankës publikohet në Buletinin Zyrtar të bankës. Ndryshimet hyjnë në fuqi dhe i shtrinë efektet juridike për klientin 30 ditë kalendarike pas publikimit, përveç rastit kur një datë tjetër e mëvonshme është parashikuar ndryshe në mënyrë të veçantë ndërmjet bankës dhe klientit.
- 5.2 Banka njofton me shkrim klientin për çdo amendament në Kushtet e Përgjithshme të Punës të bankës. Ndryshimet publikohen në Buletinin Zyrtar të bankës dhe shpallet në ambientet publike të saj.
- 5.3 Ndryshimet prezumohen të pranuar nga subjekti në rast se banka nuk njoftohet me shkrim prej tij për kundërshtitë brenda 30 ditëve kalendarike nga momenti i njoftimit.

KREU II

KOMPETENCA E NËNSHKRIMIT

NENI 6
NJOFTIMI I TË DREJTËS SË PËRFAQËSIMIT, NËNSHKRIMET E AUTORIZUARA

- 6.1.1 Nivelet e përfaqësimit të bankës në marrëdhënie me klientët si dhe specimentet e nënshkrimeve të personave të autorizuar të bankës, tregohen në Librin e Nënshkrimeve të Autorizuara të bankës (nënshkrimet e autorizuar).
- 6.2 E drejta e nënshkrimit të autorizuar në bankë dhe çdo ndryshim në këtë të drejtë, delegohen nga administratorët tek personat e autorizuar, sipas akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim.
- 6.3 Për çdo ndryshim në delegimin e së drejtës për të përdorur nënshkrimin e autorizuar, për çdo rast të pasqyrimit të specimenteve të reja, revokimi apo akti i heqjes së të drejtës për nënshkrim vendoset në Librin e Nënshkrimeve të Autorizuara, përveç kur ky veprim kryhet me njoftim të veçantë për këtë qëllim.
- 6.4 Çdo nënshkrim i autorizuar i klientit është i vlefshëm për sa kohë nuk ka ndonjë njoftim me shkrim për ndryshime në këto nënshkrime.

NENI 7
NËNSHKRIMET E AUTORIZUARA

Nënshkrimet e autorizuara përdoren për të gjitha operacionet e bankës. Nënshkrimi i autorizuar mund të kufizohet për përdorim sipas operacioneve specifike të bankës. Specimenet e nënshkrimeve të autorizuar, për rastet e kufizimit të përdorimit për një ose disa operacione specifike të bankës, vendosen në një faqe të veçantë të Librit të Nënshkrimeve të Autorizuara.

KREU III
EKZEKUTIMI I OPERACIONEVE

NENI 8
LËSHIMI I URDHRAVE

Operacionet ekzekutohen mbi bazën e urdhrit të dhënë nga klienti. Urdhri përcakton në mënyrë të qartë natyrën e operacionit që rregullohet prej tij. Amendamentet ose ndryshimet në urdhër, lëshohen në të njëjtën mënyrë si dhe vetë urdhri.

NENI 9
DOKUMENTIMI I PAGESAVE TË KODIFIKUARA

- 9.1 **Banka vepron mbi bazën e dokumenteve të pagesave të kodifikuara të paraqitura për ekzekutim nga klientët duke përdorur vetëm informacionin e dhënë në linjat e kodifikimit. Tërësia e dokumenteve dhe e mesazheve të përdorura për pagesat elektronike në përshtatje të veprimit automatik, konsiderohet si dokumentacion i pagesave.**
- 9.2 Klienti që ka dokumentuar në mënyrë të pasaktë pagesat dhe i shkakton dëm bankës, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar për atë kohë sa ai ka përdorur kodin.

NENI 10
URDHRAT NËPËRMJET TELEKOMUNIKACIONIT

- 10.1 Urdhrit të transmetuar me mjete të telekomunikacionit i kushtohet vëmendje deri në atë shkallë dhe në atë mënyrë siç parashikohet nga "Kushtet e Përgjithshme të Punës" ose "Kushtet Specifike të Punës" të bankës.
- 10.2 Urdhrat e transmetuara me mjete të telekomunikacionit vërtetohen menjëherë me shkrim dhe bëhen të zbatueshëm (ekzekutueshëm) pas marrjes së vërtetimit me shkrim.

NENI 11
EKZEKUTIMI I URDHRAVE

Në rast se banka urdhërohet për ekzekutimin e urdhrit nëpërmjet një letre ose mjeteve të tjera të telekomunikacionit, ajo nuk duhet të devijojë nga urdhri pa u këshilluar paraprakisht me klientin.

NENI 12
KOMISIONET

Banka zbaton komisionet në përputhje me listën e komisioneve të shpallura në ambjentet e saj.

NENI 13
SHPENZIMET DHE KOSTOT

Klienti përballon të gjitha shpenzimet dhe kostot, të cilat i shkaktohen bankës nga zbatimi i urdhrimit të personit të tretë. Banka ka të drejtë të zbatojë nivele të fiksuara për përballimin e shpenzimeve dhe të kostove.

NENI 14
NJOFTIMET NGA BANKA

- 14.1 Faturat, transfertat debiti, gjëndjet e llogarisë bankare, gjëndja e llogarisë kasë sigurimi, gjëndja e llogarisë likuiduese, raportimet për ekzekutimin e operacioneve dhe njoftimet e tjera të bankës verifikohen nga marrësi për saktësi dhe për plotësim.
- 14.2 Të gjitha kundërshtitë për njoftimet nga banka paraqiten menjëherë, përveç kur parashikohet ndryshe nga Kushtet e Punës ose Kushtet Specifike të Punës së bankës. Kundërshtitë e paraqitura nëpërmjet mjeteve të telekomunikacionit konfirmohen me shkrim.
- 14.3 Klienti detyrohet të kthejë menjëherë çdo njoftim të bankës që nuk i përket atij.
- 14.4 Klienti njofton menjëherë bankën për pamundësinë e marrjes së njoftimit të pritur prej bankës, në rast se normalisht ai duhet të kishte mbërritur nëpërmjet shërbimit postar.

KREU IV
PËRGJEGJËSITË DHE DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA SHKAKTIMI I DËMIT

NENI 15
PËRJASHTIMI I BANKËS NGA PËRGJEGJËSIA

Banka nuk është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara nga forcat madhore, gjëndjet e jashtëzakonshme, luftërat, grevat, demonstratat dhe turbullirat e tjera civile apo fatkeqësitë natyrore si dhe për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të bankës.

NENI 16
PËRGJEGJËSITË NDAJ KLIENTEVE

- 16.1 Në rast se banka në ekzekutimin e operacioneve në mënyrë të paligjshme dhe me faj shkel detyrimet kontraktuale, atëherë banka është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara dhe detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.
- 16.2 Përgjegjësia e bankës për dëmet e shkaktuara me faj shpërblehet sipas vlerës së operacionit, kufizuar deri në humbjen konkrete.

NENI 17
PËRGJEGJËSITË NDAJ PERSONAVE TË TRETË

- 17.1 Në zbatim të porosisë së klientit, banka autorizon personat e tretë për të vepruar në emër të saj dhe për të kryer plotësisht ose pjesërisht, deri në atë shkallë sa është e nevojshme për ekzekutimin e porosisë ose sipas zakonit bankar. Banka është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara pjesërisht deri në ushtrimin e kujdesit të duhur për zgjedhjen e personit të tretë.
- 17.2 Banka nuk është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara në rast se banka zbaton udhëzimet e klientit në zgjedhjen e personit të tretë. Pavarësisht nga dispozita e mësipërme banka, me kërkesë të klientit, ka të drejtë të transferojë pretendimet e personit të tretë te ky i fundit. Pretendimet e personit të tretë kundrejt bankës konsiderohen të vërtetuara kur i transferohen klientit.

- 17.3 Banka është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara ndaj personave të tretë, në rast se banka vepron si përfaqësues për veprime të veçanta, sipas nenit 16.
- 17.4 Për disa operacione të veçanta, kushtet e përgjithshme dhe specifike të bankës mund të parashikojnë dispozita të veçanta për përgjigjësinë ndaj personave të tretë.

NENI 18

GABIMET NË TRANSMETIMIN E MESAZHEVE

Banka nuk është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara nga difektet në sistemin e transmetimit të mesazheve, për gabimet ose për keqkuptimet në shkëmbimin e mesazheve nëpërmjet mjeteve të telekomunikacionit.

NENI 19

PAMUNDËSIA E NJOHJES ME KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PUNËS

- 19.1 Çdo dëm i shkaktuar nga mosnjohja e klientit me kushtet e përgjithshme ose specifike të punës së bankës, ose nga plotësimi i dokumentacionit të bankës në mënyrë jo të plotë, jo të saktë, me gabime ose në çfarëdo lloj mënyre tjetër të gabuar, shpërblehet nga vetë klienti. Klienti detyrohet të shpërblejë çdo dëm që i shkaktohet bankës ose personave të tretë.
- 19.2 Detyrimi i klientit për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara zbatohet edhe për keqpërdorimin, për falsifikimin ose për fabrikimin mashtrues të çeqeve dhe të instrumenteve të tjera të pagesave, prej tij.

KREU V TË NDRYSHME

NENI 20

VEPRIMET E BANKËS TË TRANSMETUARA ME MJETE TË TELEKOMUNIKACIONIT

- 20.1 Veprimet e bankës të transmetuara nëpërmjet mjeteve të telekomunikacionit shoqërohen patjetër me konfirmime të shkruara, përveç kur kushtet e përgjithshme ose specifike të bankës parashikojnë ndryshe për raste të veçanta.
- 20.2 Klienti njofton menjëherë bankën në rast se konfirmimet e shkruara të bankës nuk arrijnë në destinacion ose ndryshojnë nga veprimet e kryera, në rast se normalisht ai duhet të kishte mbërritur nëpërmjet mjeteve të telekomunikacionit.

NENI 21

NJOFTIMET ME SHKRIM TË BANKËS

Njoftimet me shkrim të bankës konsiderohen të kryera me përfundimin e afatit normal të shpërndarjes së postës duke konsideruar si adresë të saktë adresën e fundit që disponon banka. Kjo dispozitë nuk zbatohet për veprimet me rëndësi të veçantë.

NENI 22

PRETENDIMET E BANKËS, REFUZIMI I KRYERJES SË OPERACIONIT, KOMPENSIMI DHE BASHKIMI I CILËSIVE TË KREDITORIT DHE DEBITORIT TË BANKËS.

- 22.1 Tepricat kreditore dhe depozita në kasat e sigurimit të vendosura pranë bankës, si dhe kolaterali në bankë për operacionet e politikës monetare dhe të operacioneve të tjera, përdoren si mjete për sigurimin e detyrimit kundrejt pretendimeve kreditore të momentit ose të së ardhmes të bankës.
- 22.2 Banka dhe klienti kanë të drejtë të bashkojnë cilësinë e kreditorit dhe debitorit në një të vetme

- dhe të kompensojnë detyrimet kundrejt pretendimeve të saj edhe në rast se detyrimet dhe pretendimet janë në monedha të ndryshme ose në nënfisha të monedhave.
- 22.3 Pretendimet e bankës ndaj klientëve konsiderohen në afat me fillimin e procedurave të likuidimit ose të moratoriumit të detyrimeve sipas ligjit për bankat në Republikën e Shqipërisë. Banka dhe klientët përfundojnë marrëveshje paraprake për bashkimin e pretendimeve kreditore dhe debitore.

NENI 23

TRANSFERIMI I TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE DHE I BARRËVE SIGURUESE

Pretendimet kundrejt bankës nuk transferohen ose nuk vendosen si barrë siguruese. Kjo dispozitë nuk zbatohet për pretendimet e ngritura për dëmet e shkaktuara nga marrëveshjet ndërbankare në të cilat banka është palë.

NENI 24

KOMPENSIMI I DETYRIMEVE NËPËRMJET BASHKIMIT TË KREDIVE DHE DEBIVE NGA KLIENTI

Klientët kanë të drejtë të kompensojnë detyrimet nëpërmjet bashkimit të kredive dhe debive të bankës vetëm në rast se pretendimet e tyre janë të padiskutuara dhe të përcaktuara përpara ligjit.

NENI 25

INTRUMENTET ME SHKRIM

Për qëllime sigurie, tekstet, shënimet dhe nënshkrimet në dokumente, veçanërisht në instrumentet e pagesave të bankës, duhet të shkruhen në mënyrë dhe me mjete të përshtatshme.

NENI 26

LIGJI SHQIPTAR, VENDI I PËRMBUSHJES, JURIDIKSIONI

- 26.1 Marrëdhëniet ndërmjet bankës dhe klientit rregullohen nga legjislacioni shqiptar.
- 26.2 Vendi i përmbushjes së detyrimeve për të dyja palët është si rregull ambjenti i bankës në të cilën përfundohen operacionet, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakort ndryshe mes palëve.

NENI 27

DITA E PUNËS

Dita e punës, e përcaktuar nga "Kushtet e Përgjithshme të Punës" është çdo ditë nga e hëna deri në të premte përveç kur ditët midis të hënës dhe të premtes janë ditë pushimi për arsye të festave zyrtare. Pavarësisht nga kjo dispozitë, banka përcakton ditët dhe orët e punës për operacione të veçanta.

NENI 28

PËRFUNDIMI

- 28.1 Përveç kur është parashikuar ndryshe midis palëve, klienti ka të drejtë të përfundojë marrëdhëniet e përgjithshme ose të veçanta në çdo kohë pa njoftuar.
- 28.2 Banka mund të përfundojë pjesërisht ose tërësisht marrëdhënien juridike ose kryerjen e operacioneve të veçanta me klientin pasi të ketë respektuar afatet e njoftimit.
- 28.3 Banka mund të përfundojë marrëdhënien me klientin pa njoftuar paraprakisht në rast se ka rrethana thelbësore që e detyrojnë të përfundojnë marrëdhënien.
- 28.4 Në rastet e përfundimit të marrëdhënies pa njoftuar brenda kohës së parashikuar, një periudhë

kohe i lejon palët të rivendosin detyrime dhe të drejta. Për rastet e operacioneve të politikës monetare efektet shtrihen menjëherë duke marrë parasysh natyrën e operacionit.

NENI 29
HYRJA NË FUQI

“Kushtet e Përgjithshme të Punës” hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim CANI



BANKA E SHQIPËRISË

KUSHTET E VEÇANTA TË PUNËS SË BANKËS SË SHQIPËRISË

Miratur me vendimin nr.17 datë 26.02. 2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton "Kushtet e Veçanta të Punës në Bankën e Shqipërisë".

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

ENI 1 OBJEKTI

- 1.1 Objekti i "Kushteve të veçanta të punës" së Bankës së Shqipërisë është rregullimi i një ose disa veprimeve (operacioneve) të punës së Bankës së Shqipërisë lidhur me klientët e saj.
- 1.2 Kushtet e veçanta të punës dalin në bazë dhe për zbatim të "Kushteve të përgjithshme të Bankës së Shqipërisë" miratur me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ENI 2 QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

- 2.1 Nëpërmjet "Kushteve të veçanta të punës" synohet të njësohen veprimet (operacionet) që Banka e Shqipërisë kryen me klientët e saj gjatë aktivitetit të saj, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji "Për Bankën e Shqipërisë"¹.
- 2.3 Fushat që prekin "Kushtet e veçanta të punës" janë të lidhura kryesisht me:
 - a- mbajtjen dhe administrimin e llogarisë nga Banka e Shqipërisë për klientët e saj;
 - b- veprimet (operacionet) e kryera nga Banka e Shqipërisë.

ENI 3 PËRKUFIZIME

Kudo ku janë përdorur në këtë rregullore termat vijues kanë këtë kuptim:

"Bankë" nënkupton Bankën e Shqipërisë.

"Veprimet (operacionet)" nënkupton të gjitha veprimet juridike që kryen Banka brenda vitit financiar, dhe të cilat janë objekt i veprimtarisë së Bankës të përcaktuar në ligj.

"Klientët" nënkuptojnë bankat e nivelit të dytë dhe degët e bankave të huaja të licencuara në Republikën e Shqipërisë dhe sipas rastit, Qeverinë e Republikës së Shqipërisë" si dhe klientë të tjerë me status të veçantë.

¹ Ligji nr.8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"

KREU II MBAJTJA DHE ADMINISTRIMI I LLOGARISË

ENI 4 HAPJA E LLOGARISË

- 4.1 Banka hap llogari për klientët në librat e saj, vetëm kundrejt dorëzimit të dokumenteve që vërtetojnë identitetin e klientit.
- 4.1.1 Për bankat e nivelit të dytë, llogaria hapet automatikisht, me marrjen e licencës dhe aktivizohet me kërkesën e bankës.
- 4.1.2 Në rastin e një subjekti juridik shqiptar, Banka kërkon :
- a- kopje autentike të dokumenteve të themelimit të shoqërisë (statutin e shoqërisë dhe vendimin e gjykatës, që themelon shoqërinë);
 - b- specimene të nënshkrimeve të autorizuara;
 - c- kopje autentike të dokumenteve të regjistrimit në Regjistrin Tregtar, në Organet Tatimore, në Institutin e Statistikës dhe në organe të tjera të kërkuara; si dhe
 - d- prokurën përkatëse për personin që përfaqëson shoqërinë.
- 4.1.3. Në rastin e një subjekti juridik të huaj, Banka kërkon :
- a- kopje autentike të dokumenteve të themelimit;
 - b- kopje origjinale ose të notuar të specimeneve të nënshkrimeve të autorizuara.
- Klienti duhet të paraqesë prova të mjaftueshme, që ka fituar të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në vendin e rezidencës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
- 4.1.4. Në rastin e një individi, Banka kërkon kopje autentike të dokumenteve të identifikimit.
- 4.1.5. Banka mund të kërkojë konfirmim për autenticitetin e dokumenteve, të përcaktuara në pikat 4.1.2, 4.1.3 dhe 4.1.4 të këtyre kushteve.
- 4.2 Për Qeverinë llogaria hapet në Bankë në bazë të drejtës së përcaktuar nga ligji "Për Bankën e Shqipërisë", dhe aktivizohet në bazë të kërkesës përkatëse nga Ministria e Financave.
- 4.3 Klienti njofton Bankën për emrat dhe për firmat e personave të autorizuar për të vepruar në llogari, në emër të tij.
- 4.3.1. Çdo kompetencë ose përfaqësim konsiderohet i vlefshëm deri sa të revokohet me shkrim nga personi i autorizuar për ta bërë këtë. Klienti është përgjegjës për të njoftuar menjëherë Bankën për çdo ndryshim lidhur me personat e autorizuar.
- 4.3.2. Në rast se ka mosmarrëveshje ligjore në lidhje me personat e autorizuar midis aksionerëve apo drejtuesve të shoqërisë, dhe njëri prej tyre njofton bankën për këtë mosmarrëveshje, Banka ka të drejtë të pezullojë të gjitha operacionet derisa të vendoset ndryshe nga palët e interesuara dhe, Banka të njoftohet për arritjen e marrëveshjes.
- 4.4. Llogaria hapet në bazë të një kërkesë me shkrim nga Klienti dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes "Për llogarinë rrjedhëse".

ENI 5 MONEDHA DHE INTERESI

- 5.1 Llogaritë mbahen në Lekë ose në raste të veçanta, në valutë.
- 5.2 Si rregull, për llogaritë rrjedhëse, në Bankë nuk paguhet përqindje interesi.

ENI 6 LLOGARIA NË LEKË

- 6.1 Bankat e nivelit të dytë mbajnë pranë Bankës llogarinë në "lekë". Në këtë llogari mbahet

- rezerva e detyruar dhe rezervat e lira të bankave. Nëpërmjet saj shlyhen të gjitha detyrimet në lekë nga ana e bankave.
- 6.2 Qeveria mban pranë Bankës llogarinë në "lekë" që lidhet me të gjitha pagesat dhe me detyrimet që rrjedhin nga aktiviteti i Shtetit Shqiptar.
- 6.3 Llogaria në lekë përdoret për kryerjen e operacioneve të pagesave në *cash* ose me kalim në llogari.

NENI 7

LLOGARIA NË VALUTË

- 7.1 Bankat e nivelit të dytë mbajnë llogari rezervë në valutë pranë Bankës, në përputhje me ligjin dhe me aktet nënligjore përkatëse të nxjerra nga Banka e Shqipërisë. Llogaritë e valutës çelen pranë Bankës për të përmbushur detyrimin për rezervën e detyruar.
- 7.2 Llogaritë në valutë, që nuk përdoren për mbajtjen e rezervës së detyruar mund të përdoren, sipas vendimit të mbajtësit të llogarisë, si llogari garancie (escrow account) për disa operacione të parashikuara².
- 7.3 Qeveria mban pranë Bankës llogarinë në valutë³ lidhur me projekte të ndryshme që financohen nga organizma financiarë ndërkombëtarë.

NENI 8

MËNYRA E MBAJTJES SË LLOGARISË

- 8.1 Llogaria rrjedhëse ka vetëm tepricë kreditore. Banka nuk lejon tepricën debitore në llogari.
- 8.2 Teprica kreditore paguhet me kërkesën e klientit.
- 8.3 Klienti informohet mbi kreditimet në llogari dhe për gjendjen e llogarisë nëpërmjet njoftimeve bankare.
- 8.4 Banka ka të drejtë të llogarisë shpenzimet dhe komisionet për administrimin e llogarisë sipas tarifave të listuara.
- 8.5 Klientët, për të cilët llogaria rrjedhëse mban edhe shumën e rezervës së detyruar, kanë të drejtë të përdorin një pjesë të kësaj shume në përputhje me rregulloret përkatëse.
- 8.6 Banka e Shqipërisë mban dhe administron në librat e saj kontabël arin dhe metale të tjera të çmuara të Qeverisë.

NENI 9

NXJERRJA E LLOGARISË

- 9.1 Banka i siguron Klientit nxjerrjen periodike të gjendjes së llogarisë, në të cilën konfirmohet çdo debi dhe çdo kredi e ndodhur në llogarinë e tij si dhe tepricën e llogarisë. Në rastet kur Banka dhe Klienti bien dakort, Banka siguron nxjerrjen e llogarisë për çdo ditë në të cilën është prekur llogaria.
- 9.2 Nëse Klienti ka ankesa për tepricën ose për veprime të caktuara në llogari, ai duhet të njoftojë Bankën me shkrim, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së nxjerrjes përkatëse të llogarisë. Në mungesë të këtij njoftimi, Banka e konsideron nxjerrjen e llogarisë të konfirmuar dhe të pranuar në mënyrë të pakthyeshme nga Klienti.
- 9.3 Banka rezervon të drejtën që të korrigjojë, në çdo kohë, pa njoftuar paraprakisht Klientin, të gjitha gabimet që konstaton në debitimet/kreditimet e llogarisë së Klientit. Banka njofton në këtë rast Klientin me mjetet e saj të komunikimit.

NENI 10

DETYRIMI PËR INFORMACION

Klienti është i detyruar të informojë Bankën menjëherë për çdo fakt dhe informacion tjetër ligjor, që ndikon në marrëdhëniet e punës me Bankën.

² Në praktikë llogaria në valutë mund të përdoret nga Banka, duke e kredituar për nevoja pagese të vetë Bankës.

KREU III VEPRIMET ME LLOGARINË RRJEDHËSE

NENI 11 ***TË PËRGJITHSHME***

- 11.1 Përveç se kur është rënë dakort ndryshe, urdhrat pranohen nga Banka vetëm gjatë orarit zyrtar të punës. Në qoftë se urdhri mbërrin në Bankë pas orarit zyrtar ose pas kohës së përcaktuar në rregulloret e Bankës, këta urdhra do të konsiderohen se janë marrë ditën pasardhëse të punës. Në ekzekutimin e urdhrave, Banka kërkon që Klienti t'i japë të dhëna të sakta dhe korrekte, në mungesë të të cilave, ajo mund të refuzojë të ekzekutojë urdhrin. Përputhja e urdhrave me legjislacionin dhe me rregulloret në fuqi është përgjegjësi e vetë Klientit. Banka mund të refuzojë të ekzekutojë urdhrin në rast se kupton që Klienti ka shkelur ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe njofton për këtë Klientin.
- 11.2 Urdhrat e pagesës duhet të jepen me shkrim ose në formë elektronike, për të cilën është rënë dakort me marrëveshje. Banka do të pranojë vetëm urdhra, të cilët janë në përputhje me kërkesat e saj ose të cilët janë dhënë në një formular të veçantë të përdorur nga Banka për këtë qëllim. Urdhrat që shmangen nga kjo kërkesë mund të refuzohen prej saj duke e njoftuar klientin për refuzimin. Për pagesat e shpejta, Banka pranon urdhra vetëm me mjete elektronike të sigurta transmetimi (SWIFT), përveç se kur është rënë dakort ndryshe.
- 11.3 Nënshkrimet duhet të bëhen nga personat e autorizuar, nënshkrimet e të cilëve janë pranuar nga banka për kryerjen e operacioneve, në përgjithësi, ose të operacioneve në llogari rrjedhëse. Banka shqyrton udhëzimet me shkrim të Klientit lidhur me llogarinë e tij bankare dhe me operacione të tjera bankare për të vërtetuar që firmat janë identike me firmën e Klientit të depozituar në bankë. Banka refuzon të zbatojë instruksionet, të cilat nuk janë firmosur në përputhje me firmën e depozituar në bankë dhe njofton Klientin për këtë. Banka nuk është përgjegjëse për pasojat e ekzekutimit të udhëzimeve false ose mashtruese, natyra e rreme e të cilave nuk zbulohet edhe pasi është bërë kujdesi i duhur për shqyrtimin e tyre. Dëmet/humbjet dhe/ose kostot lidhur me to do të mbulohen vetëm nga Klienti. Në rastin e urdhrave elektronikë (SWIFT), kontrolli i zbatimit të procedurave për nënshkrimet e autorizuar, është përgjegjësi e vetë Klientit.
- 11.4 Datëvaluta është data e vlefshmërisë së veprimit. Si rregull, Banka ekzekuton veprimet sipas datëvalutës së përcaktuar nga Klienti, me kusht që kjo të jetë në përputhje me rregulloret e Bankës dhe me marrëveshjet dy/shumëpalëshe për lloje të caktuara veprimesh. Banka nuk ekzekuton veprime me datëvalutë të kaluar. Urdhrat e lëshuar nga Klienti me datëvalutë para datës së marrjes, refuzohen nga Banka. Në marrëveshje me Klientin, urdhri mund të ekzekutohet me datëvalutë, datën e marrjes.
- 11.5 Përveç se kur është rënë dakort ndryshe, Banka i ekzekuton urdhrat njëri pas tjetrit sipas kohës së mbërritjes së tyre. Në qoftë se urdhrat e pagesës nuk mund të ekzekutohen për shkak të pamjaftueshmërisë së gjendjes së llogarisë, Banka pezullon ekzekutimin, derisa të krijohet gjendja e mjaftueshme në llogari. Në rast se, deri në fund të ditës, nuk krijohet gjendja e mjaftueshme për ekzekutimin e urdhrave të mbetur pezull, Banka refuzon ekzekutimin e tyre.
- 11.6 Klienti mund të tërheqë ose të ndryshojë një urdhërpagese, vetëm në rast se kjo nuk është ekzekutuar ende nga Banka. Në të kundërt, Banka mund të anulojë ekzekutimin e veprimit vetëm nëse përfituesi i pagesës dërgon një urdher për kthimin e kreditimit.

NENI 12 ***VEPRIMET NË CASH***

- 12.1 Banka kryen veprime në *cash* në rast të nevojave të bankave të nivelit të dytë, si dhe në rastet e ndërhyrjes në treg.

³ Llogaritë speciale.

Gjithashtu, Banka kryen veprime në *cash* edhe me individët në sportelet e saj, për veprimet që lidhen me bonot e thesarit. Këtë shërbim, Banka e kryen si në qendër, ashtu edhe në degët e saj në rrethe.

- 12.2 Pagesat në *cash*, kryhen kundrejt një njoftimi paraprak në Bankë, minimalisht një ditë më parë.
- 12.3 Format i urdhërpagesës për pagesat *cash* është çeku⁴ i lëshuar nga Banka. Klienti që do të kryejë pagesa me çek, pajiset paraprakisht, me një bllok çekesh bankare të emetuara nga Banka. Ai është i detyruar të përdorë vetëm ato çekë që janë lëshuar në emër të tij dhe të njoftojë Bankën për çdo fletë çeku të humbur apo të dëmtuar. Çeku duhet të jetë lëshuar në emër të personit që do të kryejë tërheqjen si dhe të përmbajë nënshkrimet e personave të autorizuar sipas plotfuqishmërisë së nënshkrimeve të caktuara nga vetë Klienti.

Me paraqitjen e çekut në Bankë, Banka bën verifikimin e saktësisë formale të tij dhe kryen pagesën, vetëm në rast se Klienti ka gjendje të mjaftueshme në llogari.

Banka ka të drejtë të kontrollojë autorizimin e personit prezantues të çekut, si përfaqësues ligjor i Klientit, që kërkon kryerjen e veprimit të pagesës *cash* me çek.

Pagesat me çek, kryhen deri në 10 ditë pas datës së lëshimit të çekut.

- 12.4 Banka arkëton nga bankat e nivelit të dytë fondet në *cash*. Fondet në fjalë përpunohen sipas udhëzimit përkatës të miratuar nga Banka.⁵

NENI 13 ***PAGESAT NDËRBANKARE***

- 13.1 Pagesat ndërbankare kryhen në bazë të urdhrit të dërguar nga vetë Klienti.
- 13.2 Për pagesat ndërbankare Banka pranon instruksione pagese të formatit:
- a) SWIFT (MT200, MT202, MT203);
 - b) teleks me çels telegrafik;
 - c) kërkesë me shkrim nga Klienti.
- 13.3 Si rregull, Banka ekzekuton pagesat ndërbankare për instruksionet e mbërritura deri në orën 15:30 të datëvalutës. Banka mund të ekzekutojë instruksione të mbërritura pas kësaj ore, në rast se është e nevojshme për krijimin e gjendjes së mjaftueshme në llogari.
- 13.4 Ekzekutimi i pagesave ndërbankare kryhet në bazë bruto⁶. Çdo instruksion pagese shlyhet në llogari në mënyrë individuale; pagesat në hyrje dhe në dalje nuk kompensohen ndaj njëra-tjetrës.

KREU IV SHËRBIMI I KLERINGUT

NENI 14 ***TË PËRGJITHSHME***

- 14.1 Banka kryen shërbimin e kliringut me qëllim që të ndihmojë në mirëfunksionimin e sistemit të pagesave dhe në përsheptimin e tyre⁷.
- 14.2 E drejta e pjesëmarrjes në kliring u rezervohet vetëm Klientëve që janë ndërmjetës financiarë.

Banka ka të drejtë të refuzojë kërkesën e klientit ose të përjashtojë një anëtar nga shërbimi i kliringut, në rast se ky i fundit nuk jep garanci të mjaftueshme për të siguruar përmbushjen e pretendimeve të ngritura nga shlyerja e pagesave.

⁴ Në fushën e pagesës me çek në Shqipëri - zbatohet legjislati i fuqi : Dekreti nr. 3702, datë 08.07.1963 "Për çekun" dhe ligji nr. 7782 datë 26.01.1994 "Për disa shtesa dhe ndryshime në dekretin nr. 3702 datë 08.07.1963 "Për çekun".

⁵ Udhëzim " Për përpunimin e monedhave shqiptare ", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶ Parimi 'gross by gross'.

⁷ Kjo e drejtë i lind Bankës së Shqipërisë nga neni 21 pika 3 e ligjit nr.8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë.Për këtë qëllim është miratuar edhe rregullorja "Për organizimin e kliringut në Bankën e Shqipërisë" miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

- 14.3 NËPËRMJET SHËRBIMIT TË KLERINGUT, SHKËMBEHEN TË DHËNAT PËR KËTO INSTRUMENTE:
a- urdhërpagesa;
b- çeqe.
- 14.4 Banka llogarit pozicionin neto për secilin anëtar dhe kujdeset për rezultatin zero të seancës.
- 14.5 Banka ekzekuton në mënyrë të njëkohshme pozicionet neto të Klientëve-anëtarë të kliringut në llogaritë përkatëse.
- 14.6 Banka rezervon të drejtën të refuzojë ekzekutimin, shlyerjen e çdo rezultati në qoftë se ajo mëson se një anëtar ka mungesë fondesh, kur gjendja financiare e tij është e paqartë, kur klienti falimenton ose është në proces likuidimi.
- 14.7 Banka nuk është përgjegjëse në rastin kur një anëtar i kliringut pëson humbje, si rezultat i pjesëmarrjes në kliring, me përjashtim të rastit kur ajo neglizhon ose nuk drejton mirë.

NENI 15

KLIRINGU I URDHËRPAGESAVE

- 15.1 Për urdhërpagesat, anëtarët e kliringut nuk shkëmbejnë fizikisht dokumentet, por vetëm të dhënat për to.
- 15.2 Banka pranon urdhra për transferimin e fondeve nga anëtarët e Kliringut, në formatin:
- a) SWIFT (MT200, MT202, MT203);
b) teleks me çels telegrafik;
c) kërkesë me shkrim nga Klienti.
- 15.3 Anëtarët e kliringut paraqesin urdhrin për transferimin e fondeve, si rregull 1-2 ditë përpara datëvalutës së kërkuar. Banka mund t'i pranojë këta urdhra, maksimalisht deri në orën 12:00 të datëvalutës së kërkuar.
- 15.4 Banka grumbullon urdhrat e mbërritur nga të gjithë anëtarët dhe llogarit për secilin, pozicionin neto multilateral që rezulton nga kompensimi i shumave. Këto pozicione shlyhen në mënyrë të njëkohshme në llogaritë e anëtarëve të kliringut.

NENI 16

KLIRINGU I ÇEQEVE

- 16.1 Banka kryen shërbimin e kliringut të çeqeve dhe organizon në ambientet e saj seancën ditore të kliringut.
- 16.2 Si rregull, të gjithë klientët –anëtarë të kliringut përfaqësohen në seancën e kliringut.
- 16.3 Përfaqësuesit e anëtarëve të kliringut, shkëmbejnë në seancën e kliringut, këto instrumente:
a-çeqe bankare;
b- çeqe personale.
- 16.4 Banka merr pjesë në shkëmbimin e zarfeve të mbyllur që përmbajnë çeqet.
- 16.5 Çequet e marra janë nën përgjegjësinë e anëtarit dërgues deri sa ato të jenë kryer ose kthyer. Anëtari marrës mban çequet në mirëbesim për sa kohë të jenë bërë verifikimet e domosdoshme për kthim të tyre, në rastin e gabimeve.
- 16.6 Banka llogarit pozicionin neto për secilin anëtar dhe kujdeset për rezultatin zero të seancës.
- 16.7 Banka ekzekuton në mënyrë të njëkohshme pozicionet neto të Klientëve-anëtarë të kliringut në llogaritë përkatëse.

NENI 17

VEPRIMET LIDHUR ME TRANSMETIMET ELEKTRONIKE

- 17.1 Klientët mbajnë përgjegjësi për transmetimin e të dhënave elektronike. Në rastin e trasmetimit

- të urdhrit elektronik, Banka e konsideron të shmangur aksesin e personave të paautorizuar dhe të mirëqenë identifikimin e dërguesit. Sistemet e sigurta të trasmetimit elektronik e kanë në procedurën e punës së tyre mbrojtjen e të dhënave të transmetuara.
- 17.2 Çdo Klient ka për detyrë të ruajë të dhënat e transmetuara.
- 17.3 Rakordimi dhe kthimi i pagesave të adresuara gabim realizohet midis vetë Klientëve.
- 17.4 Banka nuk ofron asnjë garanci në rast të gabimeve të sistemit në rrjetin e trasmetimit të të dhënave. Në rast se ndodhin gabime të kësaj natyre ose në rast se Klienti nuk transmeton pagesat elektronike, Klienti i cënuar duhet të lajmërojë Bankën.
- 17.5 Në rast të gabimit të sistemit në Bankë ose të sistemit të klientit, pagesat mund të kërkohen nëpërmjet teleksit ose nëpërmjet dërgesës me shkresë zyrtare të protokolluar.
- Në rast të dërgesave me shkresë zyrtare, që ato të jenë ligjërish të pranueshme duhet që:
- të nënshkruhen nga një përfaqësues i autorizuar i klientit;
 - nënshkrimi të jetë i legalizuar në Bankë; dhe
 - përfaqësuesi i klientit të ketë të drejtën për të urdhëruar preken e llogarisë së klientit pranë Bankës.
- Në rast të kundërt shkresa nuk ka fuqi ligjore për t'u ekzekutuar nga Banka.

KREU V OPERACIONET MONETARE TË BANKËS

NENI 18 ***KLIENTËT DHE LLOJET E VEPRIMEVE***

- 18.1 Banka kryen veprime për efekt të politikës monetare vetëm me bankat e nivelit të dytë dhe me degët e bankave të huaja të licencuara në Republikën e Shqipërisë.
- 18.2 Për operacione të veçanta, Banka mund të kufizojë numrin e klientëve në bazë të disa kriterëve specifike. Në raste të përsëritura ose vazhduese të mospërbushjes së detyrimeve nga ana e Klientëve, ata mund të përjashtohen plotësisht apo pjesërisht si subjekte për kryerjen e operacioneve të politikës monetare.
- 18.3 Banka në bazë të së drejtës së dhënë nga ligji⁸ merr vendime lidhur me politikën monetare, dhe nxjerr akte nënligjore për :
- a- veprimet që lidhen me normat e interesit për depozitat në Bankë;
 - b- veprimet që lidhen me kufijtë e operacioneve në treg të hapur;
 - c- veprimet që lidhen me skontimet ose me huatë apo kreditë;
 - d- veprimet që lidhen me lehtësitë e përhershme dhe rezervën e detyruar.
- 18.4 Norma e interesit për marrëveshjet e riblerjeve, shpallet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës.

NENI 19 ***KRYERJA E VEPRIMEVE***

Veprimet (operacionet) kryhen në përputhje me aktet përkatëse nënligjore të politikës monetare, të miratuara nga Banka.

NENI 20 ***VEPRIMET ME LETRA ME VLERË TË QEVERISË***

- 20.1 Banka e Shqipërisë në emër dhe për llogari të Qeverisë organizon dhe realizon ankandin primar për emetimin e bonove të thesarit të Qeverisë, si dhe ankandin për emetimin e obligacioneve afatgjata të Qeverisë në formë regjistrimi.

⁸ E drejta e Bankës së Shqipërisë për të miratuar politikën monetare të Republikës së Shqipërisë është e përcaktuar në nenin 43 gërma (a) të ligjit nr.8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

- 20.2. Marrëveshjet midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave janë akte nënligjore që mbështesin aktivitetet e përcaktuara në pikën 20.1 të këtij neni.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 21

- 21.1 Ndryshimet e "Kushteve të veçanta të punës" së Bankës publikohen në Buletinin Zyrtar të Bankës. Ndryshimet hyjnë në fuqi dhe i shtrijnë efektet juridike për Klientin 30 ditë kalendarike pas publikimit, përveç rastit kur një datë tjetër e mëvonshme është parashikuar ndryshe, në mënyrë të veçantë, ndërmjet Bankës dhe Klientit.
- 21.2 Banka njofton me shkrim Klientin për çdo ndryshim në "Kushtet e veçanta të punës" së Bankës. Ndryshimet publikohen në Buletinin Zyrtar të Bankës dhe shpallen në ambientet publike të saj.
- 21.3 Ndryshimet prezumohen të pranuar nga Klienti në rast se Banka nuk njoftohet me shkrim prej tij për kundërshtitë, brenda 30 ditëve kalendarike nga momenti i njoftimit.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim Cani